



This Project is funded
by the European Union



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E FINANCAVE



RAPORT MBI FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK NË NJËSITË E QEVERISJES SË PËRGJITHSHME PËR VITIN 2015

Ky raport është përgatitur nga:
Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik
Ministria e Financave

IPA Project 2012
AL 12 IB FI 01





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCAVE

Raport
mbi Funksonimin e Sistemit
të Kontrollit të Brendshëm Financiar
Publik
në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme
për vitin 2015

Tiranë, Maj 2016

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	I
LISTA E SHKURTIMEVE	II
LISTA E TABELAVE	III
LISTA E GRAFIKËVE	IV
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1
KAPITULLI I- VLERËSIMI I MONITORIMIT TË PERFORMANCËS SË NJËSIVE TË QEVERISJES SË PËRGJITHSHME	5
1.1 ANALIZA PËR MINISTRITË E LINJËS:	8
1.2 ANALIZA PËR BASHKITË:	9
KAPITULLI II- MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI	10
2.1 ANALIZA E SISTEMIT SIPAS PESË KOMPONENTËVE TË MFK BAZUAR NË VETËVLERËSIMIN E NJËSIVE PUBLIKE	10
2.1.1. Mjedisi i kontrollit.....	10
2.1.2. Menaxhimi i Riskut.....	13
2.1.3. Aktivitetet e Kontrollit.....	14
2.1.4. Informimi dhe Komunikimi.....	16
2.1.5. Monitorimi	17
2.2. ANALIZA E PËRGJITHSHME E INSTITUCIONEVE TË PAVARURA PËR VITIN 2015	17
KAPITULLI III - IMPLEMENTIMI I KËRKESAVE TË MFK NË 7 INSTITUCIONE PILOT	20
3.1. IMPLEMENTIMI I MFK NË INSTITUCIONET PILOT PËR 2015	20
KAPITULLI IV – VEPRIMTARIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM	22
4.1 ANALIZA E STRUKTURAVE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM	22
4.2 VLERËSIMI I PERFORMANCËS	24
4.2.1 Plani dhe Realizimi i veprimtarisë.....	24
4.2.2. Vlerësimi i riskut	26
4.2.3. Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm	27
4.2.4. Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë.....	28
4.2.5. Gjetjet e auditimit të brendshëm	29
4.2.6. REKOMANDIMET E AB	30
4.3. VETËVLERËSIMI I NJËSIVE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM.....	31
KAPITULLI V- AKTIVITETET E DH/KBFP PËR VITIN 2015 DHE PLANI NË VIJIM	35
ANEKSI 1: METODOLOGJIA	45
ANEKSI 2. ANALIZA E DETAJUAR E MINISTRIVE DHE BASHKIVE	47
ANEKSI 3: KUADRI LIGJOR DHE NËNLIGJOR I KBFP	120
ANEKSI 4: PYETËSORI I VETVËLERËSIMIT TË MFK DHE AB	121

LISTA E SHKURTIMEVE

AB	Auditimi i Brendshëm
BE	Bashkimi European
KBFP	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik
KB	Kontrolli i Brendshëm
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NPA	Nëpunës i Parë Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
DH/AB	Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm
DH/MFK	Drejtoria e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin
NJQP	Njësi e Qeverisjes së Përgjithshme
NJQQ	Njësi e Qeverisjes Qendrore
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
GMS	Grupi për Menaxhimin Strategjik
NJAB	Njësi e Auditimit të Brendshëm
MFP	Menaxhimi i Financave Publike

LISTA E TABELAVE

TABELA 1. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE TË NJËSIVE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM.....	4
TABELA 2. INDIKATORËT DHE BURIMET E TË DHËNAVE SIPAS DREJTORIVE NË MF.....	5
TABELA 3. RANKIMI I MINISTRIVE TË MËDHA SIPAS INDIKATORËVE TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2015.....	6
TABELA 4. RANKIMI I MINISTRIVE TË VOGLA SIPAS INDIKATORËVE TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2015.....	6
TABELA 5. RANKIMI I BASHKIVE KRYESORE SIPAS INDIKATORËVE TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2015.....	6
TABELA 6. RANKIMI I MINISTRIVE TË LINJËS SIPAS INDIKATORËVE TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2014.....	7
TABELA 7. RANKIMI I BASHKIVE KRYESORE SIPAS INDIKATORËVE TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2014.....	7
TABELA 8. ECURIA E KRIJIMIT TË NJAB GJATË VITEVE 2012-2015.....	23
TABELA 9. TË DHËNA PËR AUDITUESIT E BRENDSHËM.....	23
TABELA 10. GJETJET SIPAS SISTEMEVE, VITI 2015.....	29
TABELA 11. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE PËR VITIN 2015.....	31
TABELA 12. TË DHËNAT E AUDITUESVE TË TRAJNUAR.....	39
TABELA 13. LIDHJA E STRATEGJISË SË MFP 2014-2020 ME PLANIN E AKTIVITETEVE TË MFK.....	41
TABELA 14. LIDHJA E STRATEGJISË SË MFP 2014-2020 ME PLANIN E AKTIVITETEVE TË AB.....	43
TABELA 15. VLERËSIMI I INDIKATORËVE PËR MMSR.....	47
TABELA 16. VLERËSIMI I INDIKATORËVE TË MF.....	50
TABELA 17. VLERËSIMI I INDIKATORËVE TË MB.....	53
TABELA 18. VLERËSIMI I INDIKATORËVE PËR MD.....	56
TABELA 19. VLERËSIMI I INDIKATORËVE TË MAS.....	59
TABELA 20. VLERËSIMI I INDIKATORËVE TË MTI.....	62
TABELA 21. VLERËSIMI I INDIKATORËVE PËR MBZHRAU.....	65
TABELA 22. VLERËSIMI I INDIKATORËVE PËR MSH.....	68
TABELA 23. VLERËSIMI I INDIKATORËVE PËR MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME.....	71
TABELA 24. VLERËSIMI I INDIKATORËVE PËR MZHETTS.....	75
TABELA 25. VLERËSIMI I INDIKATORËVE PËR MZHU.....	78
TABELA 26. VLERËSIMI I INDIKATORËVE PËR MM.....	81
TABELA 27. VLERËSIMI I INDIKATORËVE TË MM.....	84
TABELA 28. VLERËSIMI I INDIKATORËVE TË MK.....	87
TABELA 29. VLERËSIMI I INDIKATORËVE TË MEI.....	90
TABELA 30. VLERËSIMI I INDIKATORËVE TË MIE.....	93
TABELA 31. VLERËSIMI I INDIKATORËVE PËR BASHKINË DURRËS.....	96
TABELA 32. VLERËSIMI I INDIKATORËVE PËR BASHKINË SHKODËR.....	98
TABELA 33. VLERËSIMI I INDIKATORËVE PËR BASHKINË TIRANË.....	100
TABELA 34. VLERËSIMI I INDIKATORËVE PËR BASHKINË KORÇË.....	103
TABELA 35. VLERËSIMI I INDIKATORËVE PËR BASHKINË ELBASAN.....	105
TABELA 36. VLERËSIMI I INDIKATORËVE PËR BASHKINË KUKËS.....	107
TABELA 37. VLERËSIMI I INDIKATORËVE PËR BASHKINË VLORË.....	109
TABELA 38. VLERËSIMI I INDIKATORËVE PËR BASHKINË GJIROKASTËR.....	111
TABELA 39. VLERËSIMI I INDIKATORËVE PËR BASHKINË BERAT.....	113
TABELA 40. VLERËSIMI I INDIKATORËVE PËR BASHKINË FIER.....	115
TABELA 41. VLERËSIMI I INDIKATORËVE PËR BASHKINË BULQIZË.....	117

LISTA E GRAFIKËVE

GRAFIKU 1. VLERËSIMI I MJEDISIT TË KONTROLLIT SIPAS PYETËSORIT TË VETËVLERËSIMIT.....	10
GRAFIKU 2. ANALIZA E NËNKOMPONENTËVE TË MJEDISIT TË KONTROLLIT, 2015.....	12
GRAFIKU 3. VLERËSIMI I MENAXHIMIT TË RISKUT SIPAS PYETËSORIT TË VETËVLERËSIMIT.....	13
GRAFIKU 4. VLERËSIMI I AKTIVITETEVE TË KONTROLLIT SIPAS PYETËSORIT TË VETËVLERËSIMIT.....	14
GRAFIKU 5. VLERËSIMI I INFORMIMIT DHE KOMUNIKIMIT SIPAS PYETËSORIT TË VETËVLERËSIMIT.....	16
GRAFIKU 6. VLERËSIMI I MONITORIMIT SIPAS PYETËSORIT TË VETËVLERËSIMIT.....	17
GRAFIKU 7. TOTALI I VLERËSIMIT TË CILËSISË SË SISTEMIT TË MFK NË NJËSITË QENDRORE TË PAVARURA.....	18
GRAFIKU 8. VJETËRSIA E AB GJATË 4 VITEVE DHE NDARJA PROFESIONALE E AB E SHPREHUR NË%.....	24
GRAFIKU 9. REALIZIMI I MISIONEVE TË AB, 2012-2015.....	25
GRAFIKU 10. LLOJET E AB SIPAS REALIZIMIT.....	25
GRAFIKU 11. NIVELI I GJETJEVE NË KATËR VITET E FUNDIT.....	30
GRAFIKU 12. NIVELI I REKOMANDIMEVE 2012-2015 DHE ZBATIMI I REKOMANDIMEVE VITI 2015.....	31
GRAFIKU 13. FUNKSIONIMI I NJAB SIPAS AKTEVE LIGJORE.....	32
GRAFIKU 14. IDENTIFIKIMIN, VLERËSIMI DHE MENAXHIMI I RISQEVE.....	32
GRAFIKU 15. PLANI I VEPRIMIT DHE MONITORIMI I REKOMANDIMEVE.....	33
GRAFIKU 16. RAPORTIMI I VEPRIMTARISË AUDITUESE.....	34
GRAFIKU 17. NIVELI I RAPORTIMIT TË NJQP.....	46

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i konsoliduar për sistemet e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (KBFP) në Shqipëri, hartohet si një kërkesë ligjore duke ofruar një përmbledhje vjetore të aktiviteteve të njësive të qeverisjes së përgjithshme në fushën e KBFP, arritjet dhe mangësitë e evidentuara në vitin e mëparshëm duke sugjeruar dhe rekomandime për njësitë publike për përmirësime të mëtejshme. Në këtë raport janë marrë në konsideratë aktivitetet e parashikuara në shtyllën pesë të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike (MFP) 2014-2020, mbi reformat në fushën e kontrollit të brendshëm. Ky dokument strategjik ka për qëllim garantimin e një sistemi të financave publike që nxit transparencën, përgjegjshmërinë, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve të përmirësuara dhe zhvillimin ekonomik. Ky qëllim arrihet vetëm nëpërmjet një sistemi të shëndoshë të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë publike.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2015, në përputhje edhe me këtë dokument strategjik nga Ministria e Financave u ndërmorrën një sërë aktiviteteve për të përmirësuar cilësinë e kontrollit të brendshëm në sektorin publik.

Pjesa e parë e raportit fokusohet në rezultatet nga vlerësimi i monitorimit të performancës së njësive të qeverisjes së përgjithshme. Në pjesën e dytë trajtohet vlerësimi i sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në njësitë publike (16 ministri, 61 bashki dhe 24 institucione të pavarura), bazuar në analizën e pyetësorëve të vetëvlerësimit. Kapitulli i tretë pasqyron implementimin e kërkesave të MFK-së në 7 institucione pilot. Veprimtaria e auditimit të brendshëm në sektorin publik, gjetjet dhe rekomandimet kryesore të audituesve lidhur me mangësitë dhe përmirësimet e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqiten në kapitullin e katërt të këtij raporti dhe në kapitullin e fundit të tij përshkruhen aktivitetet e Drejtorisë së KBFP dhe plani i veprimit për zhvillimet e mëtejshme në periudhën afatmesme në sistemet e KB.

Konstatimet kryesore në fushën e KBFP për vitin 2015

Ky raport bazohet në pyetësorët e vetëvlerësimit, raportet vjetore, metodologjinë e monitorimit të performancës së njësive publike dhe në aktivitetet e zhvilluara nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (DPH/KBFP). Në lidhje me konstatimet e këtij viti, të paraqitura si krahasim me vitet e mëparshme, theksohet se ky krahasim kushtëzohet nga këta faktorë:

- reforma administrative-territoriale, e cila solli një zvogëlim të ndjeshëm të numrit të njësive vendore nga 384 njësi në 61 bashki;
- ndryshimi i metodologjisë për monitorimin e performancës së njësive publike;
- ristrukturimi i Pyetësorit të vetëvlerësimit, si dhe rritja e ndërgjegjësimit të nivelit menaxherial në lidhje me saktësinë dhe besueshmërinë në plotësimin e Pyetësorit të vetëvlerësimit, duke qenë më objektiv dhe më afër realitetit.

Mjedisi i kontrollit – nevojitet rritje e mëtejshme e fokusit në hartimin dhe monitorimin e planeve të veprimit, si dhe ndërgjegjësim mbi delegimin e detyrave

Si rezultat i reformës administrative-territoriale të implementuar në vitin 2015, kemi një përmirësim potencial të mjedisit të kontrollit në njësitë e qeverisjes vendore, si pasojë e shkrirjes së komunave, të cilat në të kaluarën kanë sjellë dhe problemet më të mëdha në këtë komponent.

Përsa i përket njësive publike në tërësi, fokusi në lidhje me rritjen e efektivitetit duhet të përqëndrohet, krahas përcaktimit të misionit dhe objektivave strategjike, në mënyrë të veçantë në hartimin dhe monitorimin e planeve konkrete të veprimit. Këto plane veprimi duhet të përmbajnë rezultate konkrete, afatet kohore si edhe personat përgjegjës për realizimin e aktiviteteve.

Ndërkohë, Grupi i Menaxhimit Strategjik, funksionon në shumicën e institucioneve qendrore dhe më pak në njësitë e qeverisjes vendore, por ky funksionim është i përqëndruar shumë pak në çështjet që kanë të bëjnë me MFK.

Një ndër elementet thelbësorë përbërës të mënyrës së menaxhimit është dhe delegimi i detyrave. Detajet mbi delegimin e detyrave duhet të përfshihen në rregulloret e brendshme të institucioneve publike dhe duhet të dokumentohet delegimi, duke theksuar qartë çfarë delegohet, kujt i delegohet, mënyra dhe frekuenca e raportimit në nivel hierarkik. Bazuar në konstatimet e njërive publike, vihet re se në shumicën e rasteve delegim nuk realizohet sipas kërkesave të neneve 9, 12 dhe 15 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar.

Menaxhimi i riskut - vërehet përmirësim në përgatitjen e regjistrave të riskut, por mbetet për t'u zhvilluar më tej sistemi i plotë për menaxhimin e tij

Koordinatori i riskut sipas ligjit të MFK është Nëpunësi i Autorizuar (NA) i institucionit. Në mënyrë që procesi i menaxhimit të riskut në institucion të jetë efektiv duhet të ngrihet sistemi për realizimin e tij. Për vitin 2015, mund të konkludojmë që ka përmirësime në drejtim të përgatitjes së Regjistrit të risqeve, e cila evidentohet nëpërmjet rritjes së numrit të institucioneve që e kanë përfunduar si dokument, por që nuk përdoret ende si një mjet që ndihmon menaxhimin në arritjen e objektivave. Gjithashtu, një element tjetër problematik i vërejtur, lidhet me faktin se risqet me impakt të lartë në institucionet përkatëse, nuk janë objekt i diskutimeve të Grupit të Menaxhimit Strategjik, por relatohet që ato janë objekt i vazhdueshëm diskutimi verbal dhe vlerësimi midis titullarëve dhe stafit për t'i minimizuar dhe për të bërë të mundur përmbushjen e objektivave.

Aktivitetet e kontrollit - manualët e proceseve të punës dhe gjurmët e auditimit nuk janë bërë praktika pune në institucionet publike si dhe nevojitet zhvillimi i sistemeve të Teknologjisë së Informacionit (TI) me qëllim përmirësimin e aktiviteteve të kontrollit parandalues

Aktivitetet e kontrollit janë kërkesa ligjore të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo institucion. Nga analiza e këtij viti, u konstatua se pjesa më e madhe e institucioneve i kanë aplikuar këto kërkesa, të tilla si: manualët e proceseve të punës, gjurma e auditimit, si dhe plani i kontrollit. Megjithatë evidentohet se këto aktivitete, nuk janë bërë praktikë e zakonshme e punës së gjithë njërive publike. Përmirësime të dukshme në këtë drejtim janë vërejtur në insitucionet pilot të projektit të binjakëzimit Austriako-Francez "Implementimi i një sistemi modern të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Inspektimit Financiar Publik në Shqipëri", financuar nga Bashkimi Evropian (BE).

Ndërkohë, vërehet se në praktikë ka një moskuptim të domosdoshmërisë së ekzistencës së përshkrimit të proceseve të punës, si dhe konfuzohet shpesh me përshkrimin e pozicionit të punës.

Në bazë të vlerësimeve të pyetësorëve, një pjesë shumë e vogël e institucioneve kanë sisteme të mirëfillta të TI dhe ruajtjes së të dhënave (back-up). Për këtë arsye, theksi në të ardhmen duhet të jetë tek zhvillimi i sistemeve të TI, me qëllim përmirësimin e aktiviteteve të kontrollit parandalues dhe back-up-ve për këto sisteme.

Informimi dhe Komunikimi - nevojitet raportim sistematik mbi performancën sipas niveleve hierarkike në funksion të arritjes së objektivave, si element i rëndësishëm i përgjegjshmërisë menaxheriale

Pavarësisht përgjigjeve pozitive të njërive publike, konstatohet se jo të gjitha njësitë kanë zhvilluar një sistem komunikimi dhe informacioni të përshtatshëm, gjë e cila pengon punën e përditshme dhe vendimmarrjen menaxheriale. Ekziston edhe një mungesë e të kuptuarit se si mund të përdoret informacioni financiar për të përmirësuar eficiencën dhe efektivitetin dhe kjo vjen për shkak të fokusimit në kontrollin tradicional financiar.

Raportimi sistematik është një kërkesë thelbësore e përgjegjshmërisë menaxheriale. Raportimi duhet të mbulojë çështjet e performancës, si dhe përdorimin e burimeve. Menaxherët duhet të

bëhen plotësisht të vetëdijshëm për përgjegjësitë që kanë dhe çfarë duhet të raportojnë lidhur me këto përgjegjësi. Për këtë arsye, fokusi në të ardhmen do të jetë ndërgjegjësimi i menaxherëve mbi domosdoshmërinë e informacionit dhe raportimit nëpërmjet përmirësimit të metodologjisë së informimit dhe raportimit dhe seminareve trajnuese dhe ndërgjegjësuere.

Në përgjithësi, çështjet e informimit dhe komunikimit trajtohen përciptas në rregulloret e brendshme të institucioneve. Çdo institucion ka veprimtarinë e tij specifike dhe kompleksitetin e tij, prandaj niveli i lartë drejtues duhet të marrë nismën për trajtimin e këtyre çështjeve nëpërmjet një rregulloreje specifike për komunikimin dhe informimin, i cili është shumë i rëndësishëm jo vetëm për vendimet brenda institucionit, por edhe në shkëmbimin e informacionit jashtë tij. Gjithashtu, theksojmë se nga ana e drejtuesve dhe stafit të institucioneve nuk është kuptuar qartë termi i sistemit të informacionit dhe komunikimit, i cili nuk përfshin vetëm sisteme TI apo elektronike, por një rrjet të brendshëm të strukturuar të marrjes dhe dhënies së informacionit ndërmjet niveleve të ndryshme hierarkike në funksion të arritjes së objektivave dhe menaxhimit të mirë të fondeve publike.

Monitorimi – nevojitet rritje e mëtejshme e cilësisë dhe objektivitetit

Konstatohet se frekuenca dhe mënyra e monitorimit në njësitë publike duhen përmirësuar, duke u fokusuar jo vetëm në monitorime të aspekteve me natyrë financiare, por edhe në monitorime të performancës në funksion të arritjes së objektivave. Gjithashtu, në lidhje me rolin e auditimit të brendshëm në këtë drejtim, siç detajohet dhe më tej në raport, vërehet se, mbetet ende progres për t'u bërë në rritjen e kapaciteteve dhe pavarësisë së këtij funksioni-me qëllim auditimin sa më objektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Nga monitorimi i kryer nga Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (DH/MFK) në vazhdimësi, konstatohet se plotësimi i Pyetësorit të vetëvlerësimit bëhet nga nëpunësi zbatues (NZ) dhe jo nga NA. Kjo bën, që pyetësori të plotësohet me mangësi, për faktin se në të përmbahen rubrika gjithëpërfshirëse për funksionimin e institucionit, si në qendër, ashtu edhe në bazë (kjo e bën të domosdoshme udhëheqjen/bashkëpunimin/përfshirjen e të gjithë drejtuesve të lartë të institucionit).

Plani i auditimit të brendshëm - 94% e auditimeve të planifikuara janë realizuar

Njësitë e auditimit të brendshëm (NJAB-të) kanë paraqitur rezultatet e veprimtarisë së tyre si dhe problemet e hasura gjatë vitit 2015. Gjatë këtij viti, këto njësi kanë realizuar 1,515 angazhime auditimi nga 1,609 angazhime të planifikuara, të cilat në përqindje konsistojnë rreth 94% të planit të miratuar për këtë periudhë. Realizimi i planit është i pranueshëm, por vihen re ndryshime të mëdha në mes të planit dhe realizimit, për lloje të ndryshme të auditimit, e ndikuar nga disa faktorë, si: kërkesat e menaxhimit për auditime të paplanifikuara dhe ndryshimet në vlerësimin e riskut për fusha specifike. Edhe pse numri i auditimeve të kryera në vitin 2015 është relativisht më i ulët se në vitet 2014 dhe 2013, vërehet një nivel më cilësor i angazhimeve të auditimit gjatë këtij viti.

Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm – audituesit e brendshëm raportojnë se këto sisteme kanë funksionuar më mirë gjatë 2015

Nga analiza e raporteve të auditimit vihet re se gjatë vitit 2015, audituesit janë përpjekur për të dhënë një vlerësim mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësitë publike. Gjatë vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, audituesit janë përqendruar kryesisht në metodat dhe procedurat e administrimit të mjeteve monetare e materiale që sigurojnë ndarjen e detyrave, verifikimin reciprok të punëve me qëllim zbulimin e anomalive, gabimeve dhe parregullsive të informacioneve financiare ose jo financiare. Temat e trajtuara në trajnimin e vijueshëm të audituesve lidhur me rëndësinë e vlerësimit periodik të sistemeve të kontrollit të brendshëm, kanë ndikuar në reflektimin në praktikë të njohurive të përfituara gjatë trajnimeve.

Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar - audituesit rekomandojnë më shumë vëmendje të stafit të njërive publike në këto sisteme

Nga vlerësimi i kontrollit të brendshëm janë identifikuar dobësi në sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar. Këto sisteme kanë pasur ndikim me pasoja financiare për buxhetin e shtetit. Angazhimet e auditimit të brendshëm kanë identifikuar 4,186 raste të parregullsive financiare, për të cilat vlera e gjetjeve llogaritet të jetë 68,789 milionë lekë dhe rreth 84% të këtyre parregullsive i përkasin veprimeve financiare të kryera në periudhën 2010-2013.

Rekomandimet e auditimit të brendshëm - të shumta në numër, por ka nevojë për një nivel më cilësor të tyre, duke u fokusuar tek rritja e performancës

Rekomandimet e nxjerra për sistemet e audituara synojnë trajtimin e dobësive dhe boshllëqeve që gjenerojnë ose mundësojnë shkeljet dhe mashtrimet. Ka një numër të konsiderueshëm të rekomandimeve, në total 7,459 të tillë, të ndarë në: 3,439 rekomandime me prioritet të lartë, 2,837 rekomandime me prioritet të mesëm dhe 1,183 rekomandime me prioritet të ulët.

Rekomandimet e dhëna nga audituesit e brendshëm fokusohen në të shumtën e rasteve në rekomandime të aspektit financiar (shlyerje detyrimesh, kthim shume) dhe një numër relativisht i ulët i rekomandimeve fokusohet në përmirësimin e proceseve të punës dhe rritjen e performancës. Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të rekomandimeve shihet me prioritet nga njësitë e auditimit të brendshëm.

Kapacitetet e auditimit të brendshëm - plotësimi i strukturave audituese mbetet ende problem, ndërkohë zhvillimi profesional ka shënuar progres.

Në fund të vitit 2015, në sektorin publik funksionojnë 103 NJAB, në qeverisjen qendrore dhe lokale, të cilat kanë të punësuar 363 auditues të brendshëm nga 395 të planifikuar sipas strukturave organizative të miratuara.

Nga analiza e kryer, vihet re se në sektorin publik, 28 NJAB kanë kryer aktivitetin e tyre në kundërshtim me përcaktimet e bëra në aktet nënligjore, ku 15 prej tyre kanë funksionuar me 2 auditues të brendshëm dhe 13 prej tyre kanë vetëm 1 auditues të brendshëm.

Nga 360 auditues të brendshëm të planifikuar për të ndjekur trajnimin e vijueshëm profesional për vitin 2015, këtë program trajnimi e përfunduan me sukses 349 auditues të brendshëm të punësuar (nga të cilët 85 drejtues të njësive të auditimit të brendshëm dhe 264 auditues). Vihet re se trajnimi i vijueshëm profesional, ka pësuar rritje nga viti në vit, si në numrin e audituesve të brendshëm të trajnuar, ashtu dhe në cilësinë e temave të trajtuara.

Tabela 1. Përmbledhje e të dhënave të Njësive të Auditimit të Brendshëm

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015
Numri i NJAB	109	106	100	103
Pozicioneve e auditimit të plotësuara (në%)	96,3%	95%	93,9%	92%
Audituesit aktual të certifikuar (në%)	82%	85%	82,9%	90%
AB me mbi 5 vite eksperiencë (në%)	60%	57,6%	58,4%	63%
AB me më pak se 5 vite eksperiencë (në%)	40%	42%	41,6%	37%
Realizimi i misioneve të auditimit (në numër)	2346/2391	2098/2196	1642 /1665	1609/1515
Realizimi i misioneve të auditimit (në%)	98%	96%	99%	94%
Numri i gjetjeve	4698	3556	4441	4186
Gjetjet në vlerë për auditues (në milion)	8.2	11.2	57.4	189.5
Niveli i rekomandimeve të dhëna	7650	6628	8469	7459
Niveli i zbatimit të rekomandimeve	3311	4015	3822	3835

KAPITULLI I- VLERËSIMI I MONITORIMIT TË PERFORMANCËS SË NJËSIVE TË QEVERISJES SË PËRGJITHSHME

Në mbështetje të Urdhërit të Monitorimit të ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015, nga stafi i DH/MFK është punuar për vlerësimin e performancës së institucioneve, për vitin 2015, konkretisht të Ministrive të linjës dhe të bashkive kryesore, bazuar në tregues të përzgjedhur si më poshtë:

Tabela 2. Indikatorët dhe burimet e të dhënave sipas Drejtorive në MF

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit	Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit	Drejtoria e Harmonizimit për MFK	Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	11. Cilësia e mjedisit të brendshëm	16. Përgatitja profesionale e audituesve të brendshëm
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	12. Cilësia e menaxhimit të riskut	17. Raportimi në kohë i audituesve të brendshëm në MF
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara thesari	8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	13. Cilësia e veprimtarive të kontrollit	18. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	14. Cilësia e sistemit të komunikimit dhe informacionit	19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	15. Cilësia e monitorimit	20. Kapacitetet e burimeve njerëzore të auditimit të brendshëm

Bazuar në vlerësimet e indikatorëve të mësipërm nga drejtoritë përkatëse, është realizuar rankimi i ministrive të linjës, të cilat janë ndarë në dy grupe. Ndarja në dy grupe e tyre është bërë bazuar në nivelin e buxhetit vjetor total të ministrive, si dhe numrit të programeve buxhetore, gjë e cila sillte një rankim jo të përshtatshëm për to. Ndaj, ministritë janë ndarë në: Ministritë e Mëdha dhe Ministritë e Vogla. Për t'u futur në grupin e parë 2 kriteret e mësipërme duhet të plotësojnë këto kushte:

- Numri i programeve buxhetore të ministrive duhet të jetë më i madh se 5 (pesë).
- Niveli i buxhetit total të ministrive duhet të jetë më i madh se 7 miliardë lekë.

Tabela 3. Rankimi i Ministrive të Mëdha sipas indikatorëve të performancës për vitin 2015¹

		TOTALI
Rankimi	Institucioni	
Marzhi i Pikëve		0-600
1	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	525
2	Ministria e Financave	520
3	Ministria e Brendshme	505
3	Ministria e Drejtësisë	505
5	Ministria e Arsimit dhe Sporteve	490
6	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	485
6	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	485
8	Ministria e Shëndetësisë	460

Tabela 4. Rankimi i Ministrive të Vogla sipas indikatorëve të performancës për vitin 2015

		TOTALI
Rankimi	Institucioni	
Marzhi i Pikëve		0-600
1	Ministria e Punëve të Jashtme	530
2	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	525
2	Ministria e Zhvillimit Urban	525
4	Ministria e Mbrojtjes	505
5	Ministria e Mjedisit	495
6	Ministria e Kulturës	485
7	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	481
8	Ministria e Integritimit	475

Tabela 5. Rankimi i Bashkive kryesore sipas indikatorëve të performancës për vitin 2015

		TOTALI
Rankimi	Institucioni	
Marzhi i Pikëve		0-450
1	Bashkia Durrës	425
2	Bashkia Shkodër	395
3	Bashkia Tiranë	390
4	Bashkia Korçë	375
5	Bashkia Elbasan	355
5	Bashkia Kukës	355
7	Bashkia Vlorë	350
7	Bashkia Gjirokastrë	350
9	Bashkia Berat	335
10	Bashkia Fier	330
11	Bashkia Bulqizë	290

¹ Për rankimin e ministrive dhe bashkive është përdorur Modeli i Rankimit Standard të Konkurrencës "1224". Sipas këtij modeli, institucionet me pikë të barabarta renditen në të njëjtin pozicion dhe në renditjen vijuese lihet një pozicion bosh. Psh: nëse Ministria A renditet e e para, Ministria B dhe C vijnë më pas me pikë të barabarta, duke u ndjekur nga Ministria D, renditja do të jetë e tillë: Ministria A renditet në pozicionin e 1-rë, Ministrinë B dhe C renditen në pozicionin e 2-të, dhe Ministria D renditet në pozicionin e 4-të.

Më poshtë, paraqitet rankimi i ministrive të linjës dhe bashkive kryesore për vitin 2014. Vlen për t'u theksuar fakti që për vitin 2015 kemi një analizë më të detajuar, duke qenë se janë shtuar indikatorët e marrë në vlerësim, si dhe është ndryshuar sistemi i pikëzimit të tyre.

Tabela 6. Rankimi i Ministrive të Linjës sipas indikatorëve të performancës për vitin 2014

Rankimi	Institucioni	Vlerësimi në pikë për vitin 2014
1	Ministria e Arsimit dhe Sporteve	331
1	Ministria e Drejtësisë	331
3	Ministria e Shendetësisë	326
4	Ministria e Mbrojtjes	325
5	Ministria e Zhvillimit Urban	321
6	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	320
7	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	318
7	Ministria e Financave	318
9	Ministria e Brendshme	315
10	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	314
11	Ministria e Kulturës	313
12	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	311
13	Ministria e Mjedisit	307
14	Ministria e Integritimit	302
15	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	298
16	Ministria e Punëve të Jashtme	287

Tabela 7. Rankimi i Bashkive kryesore sipas indikatorëve të performances për vitin 2014

Rankimi	Institucioni	Vlerësimi në pikë për vitin 2014
1	Bashkia Fier	314
2	Bashkia Gjirokastrë	307
3	Bashkia Durrës	305
4	Bashkia Shkodër	304
5	Bashkia Berat	303
6	Bashkia Tiranë	300
7	Bashkia Lezhë	299
8	Bashkia Kukës	295
9	Bashkia Peshkopi	290
10	Bashkia Vlorë	289
11	Bashkia Elbasan	286
12	Bashkia Korçë	281
13	Bashkia Pogradec	280

1.1 Analiza për Ministritë e Linjës:

Një vështrim i përgjithshëm për secilin tregues për ministritë e linjës paraqitet si vijon:

1. Treguesi **“Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar”** për vitin 2015 mesatarisht është arritur në nivelin 22.5 pikë ose 75%, duke reflektuar një performancë të përgjithshme mesatare. Për këtë indikator vetëm dy ministri janë vlerësuar me pikët maksimale, përkatësisht Ministria e Zhvillimit Urban dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Ndërkohë janë vlerësuar në nivel mesatar pesë ministri, të cilat kanë grumbulluar nga 15 pikë.
2. Indikator **“Anulimi i kontratave gjatë një viti”** është realizuar mesatarisht 20.6 pikë ose 69% e nivelit referues. Bazuar në këtë vlerësim, performanca e institucioneve paraqitet në nivele mesatare. Nga analiza rezulton që 9 ministri nga 16 të tilla janë vlerësuar nga strukturat përkatëse me 15 pikë dhe vetëm katër ministri kanë marrë pikët maksimale.
3. Gjatë vitit 2015, indikator **“Urdhër - shpenzimet e refuzuara nga ana e Thesarit”** është realizuar 92.7%, e vlerësuar mesatarisht me 27.8 pikë. Këto rezultate tregojnë për një performancë shumë të kënaqshme të ministrive të linjës, ku shumica prej tyre kanë marrë pikët maksimale të mundshme dhe vetëm dy ministri janë vlerësuar me 15 pikë.
4. **“Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar”** është një tregues shumë i rëndësishëm për Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme (NJQP). Sipas analizës së realizuar, ky indikator është vlerësuar mesatarisht me 19 pikë ose është realizuar vetëm 63%, duke u paraqitur si indikator me performancën më të dobët në krahasim me të gjithë indikatorët e tjerë. Për këtë tregues, asnjë ministri nuk ka marrë vlerësim maksimal, ndërkohë që shumica e tyre janë vlerësuar me 10-15 pikë.
5. Një indikator tjetër i marrë në analizë është **“Urdhër-prokurimet e paautorizuara”**. Për vitin 2015, ky tregues është realizuar 77% dhe është vlerësuar mesatarisht me 23.1 pikë. Nga këto rezultate, arrijmë në konkluzionin që institucionet nuk kanë problematika të mëdha në këtë drejtim, dhe shumica e tyre janë vlerësuar mbi 25 pikë.
6. Treguesi **“Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente”**, tregon që performanca e institucioneve në drejtim të realizimit të shpenzimeve buxhetore korrente për vitin 2015, është në nivelin e 82.3%, që i përgjigjet 24.7 pikëve të marra kundrejt 30 pikëve maksimale. Megjithatë, konstatohet që tre institucione kanë një nivel performancë mesatare, të cilat janë vlerësuar me 15 pikë.
7. Treguesi **“Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale”**, është realizuar mesatarisht me 21.3 pikë në vitin 2015 ose 70.8%, duke evidentuar faktin e një performancë më të dobët në krahasim me shpenzimet korrente. Për këtë indikator, shumica e institucioneve janë vlerësuar brenda intervalit 10-15 pikë.
8. **“Saktësia dhe konsistenca e raportimeve”** është indikator që paraqitet me realizimin maksimal të nivelit referues për vitin 2015, ku shumica e institucioneve janë vlerësuar me pikët maksimale dhe vetëm Ministria e Arsimit dhe Sporteve paraqitet me një performancë të nivelit të 15 pikëve.
9. **“Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve”** është realizuar mesatarisht me 21.2 pikë ose 70%. Këto rezultate tregojnë që institucionet nuk kanë pasur një planifikim të duhur të buxhetit të tyre si dhe kanë bërë rialokime të shumta gjatë vitit buxhetor.
10. **“Krijimi i detyrimeve të prapambetura”** është një tregues, i cili tregon ecurinë e institucioneve në drejtim të likuidimit të të gjitha shpenzimeve brenda vitit buxhetor. Për vitin 2015, ministritë kanë një performancë shumë pozitive, duke u vlerësuar mesatarisht me 29 pikë ose me realizim 97%.

1.2 Analiza për Bashkitë:

Një vështrim i përgjithshëm për secilin tregues për bashkitë paraqitet si vijon:

1. Treguesi **“Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar”** për vitin 2015 mesatarisht është vlerësuar me 23.6 pikë nga 30 pikë të mundshme ose ka një realizim prej 78.7%. Këto vlerësime tregojnë për një performancë të kënaqshme të këtij treguesi, ku gjysma e bashkive janë vlerësuar maksimalisht dhe pjesa tjetër kanë marrë nga 15-25 pikë. Pra, mund të konkludojmë që bashkitë nuk kanë problematika të mëdha në dërgimin në kohë të faturave në Thesar.
2. Indikator tjetër i analizuar është **“Anulimi i kontratave gjatë një viti”**, i cili ka një shkallë realizimi prej 85%, ku pikët mesatare të vlerësuara të këtij treguesi janë 25.5 pikë. Shumica e bashkive (9 prej tyre) kanë vlerësim maksimal të këtij indikator dhe vetëm dy bashki janë vlerësuar me 5 pikë. Në përgjithësi, mund të themi që situata e këtij indikator në bashkitë kryesore të marra në analizë paraqitet në nivele të kënaqshme.
3. Vlerësimet më të mira, bashkitë i kanë arritur në treguesin **“Urdhër- shpenzimet e refuzuara nga ana e Thesarit”**. Pikët mesatare të marra nga bashkitë për këtë indikator janë 28.2 pikë, duke evidentuar një realizim prej 94%. Nga të gjitha institucionet vendore, vetëm dy prej tyre kanë marrë përkatësisht 15 dhe 25 pikë, ndërsa të tjerat janë vlerësuar maksimalisht me 30 pikë.
4. **“Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar”** është një tjetër indikator i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit. Në përgjithësi, situata paraqitet e kënaqshme, ku mesatarisht bashkitë janë vlerësuar me 22.7 pikë dhe, vetëm një bashki është vlerësuar me 5 pikë. Realizimi i këtij treguesi është 76%, duke evidentuar faktin që institucionet vendore në shumicën e rasteve arrijnë të dorëzojnë kontratat në Thesar brenda afatit 3-ditor të përcaktuar.
5. **“Urdhër prokurimet e paautorizuara”** është indikator i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qenë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publik (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, për njësitë vendore, ky indikator është vlerësuar mesatarisht me 26 pikë dhe ka një realizim prej 86%, duke konkluduar në një performancë të kënaqshme të tij nga ana e institucioneve.

Treguesit e mësipërm lidhen kryesisht me komponentin e aktivitetit të kontrollit, që përfshin ekzistencën e rregullave dhe procedurave të shkruajtura të proceseve kryesore si: të prokurimeve, të kontratave, urdhër-shpenzimeve, detyrimeve të prapambetura, etj. Nga analiza e mësipërme arrijnë në konkluzionin paraprak se ky komponent i menaxhimit financiar dhe kontrollit, vlerësohet mesatarisht kënaqshëm.

KAPITULLI II- MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI

2.1 Analiza e sistemit sipas pesë komponentëve të MFK bazuar në vetëvlerësimin e njësive publike


Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një koncept i rëndësishëm, por i pa kuptuar ende si nga niveli i lartë menaxherial, ashtu edhe nga stafi i institucioneve publike. Ky sistem duhet të jetë konform legjislacionit në fuqi, si dhe me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, transparencës apo efektivitetit dhe ekonomicitetit. Vlerësimi i këtij sistemi, në institucionet publike të vendit tonë, bazohet në pyetësin e vetëvlerësimit dhe në raportet mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik. Në bazë të këtij vetëvlerësimi, situata e komponentëve të MFK paraqitet si më poshtë:

2.1.1. Mjedisi i kontrollit

Faktorët e mjedisit të kontrollit të brendshëm përfshijnë:

- vendosjen e objektivave dhe politikave;
- vlerat etike dhe profesionalizmin e menaxherëve;
- strukturën organizative;
- filozofinë dhe stilin e punës së drejtuesit;
- politikat dhe praktikat e burimeve njerëzore.

Grafiku 1. Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit sipas pyetësorit të vetëvlerësimit



*Shënim: Vetëvlerësimi është nga 1-4, sipas pyetësorit të vetëvlerësimit, ku 4 është vlerësimi maksimal dhe 1 është vlerësimi minimal.

Pyetësi i vetëvlerësimit (formati i të cilit është paraqitur në aneksin 4) për këtë komponent përmban 16 pyetje. Situata e përgjithshme e mjedisit të kontrollit paraqitet pozitive, ku 85% e institucioneve kanë ngritur një sistem efektiv mjedisi kontrolli, ndërsa pjesa tjetër janë në proces të përmirësimit të implementimit të këtij komponenti. Për sa i përket efektivitetit të ministrive, ai paraqitet në nivele mbi 90%, pavarësisht se ka një rënie të vogël me vetëm 3% nga viti 2013. Vlen për t'u theksuar se këto rezultate përfitohen nga vetëvlerësimi i institucioneve, gjë e cila çon në mungesën e garantimit të vërtetësisë së të dhënave.

Situata paraqitet më problematike në institucione lokale, ku efektiviteti ka pësuar një rënie prej 5% në krahasim me vitin 2013 dhe aktualisht vlerësohet me 75%.

Institucionet e pavaruara, në sajë të qëndrueshmërisë së tyre, kanë një efektivitet të lartë për të 3 vitet, mbi 85% dhe me një trend pozitiv rritjeje.

Në vijim janë paraqitur rezultatet e analizës së pyetjeve sipas faktorëve të mësipërm:

➤ *Vendosja e objektivave*

Në këtë seksion të mjedisit të kontrollit, janë analizuar elementë që kanë të bëjnë me deklaratën e misionit, ekzistencën e një strategjie të miratuar objektivash dhe prioritetesh, si dhe planin e veprimit për arritjen e objektivave strategjike. Bazuar në grafikun 2 të mëposhtëm, rreth 42% e institucioneve publike kanë vlerësuar pozitivisht situatën e elementeve përbërës, të cilët lidhen me vendosjen e objektivave. Nga ana tjetër, vetëm 5 % e institucioneve publike nuk kanë ngritur një bazë të shëndoshë të këtij nënkomponenti. Nga pyetësorët e vetvlerësimit të analizuar, konstatohet që efektiviteti i vendosjes së objektivave në institucionet publike për vitin 2015 është i njëjtë për ministritë dhe institucionet e pavarura, me një vlerësim prej 91%, ndërsa për pushtetin lokal ky efektivitet paraqitet në nivel më të ulët, rreth 70%, por ka dhe priten përmirësime në të ardhmen për shkak të reformës administrative - territoriale, pasi njësitë e qeverisje vendore janë reduktuar në vetëm 61 bashki. Shkrirja e komunave sjell një rritje të efektivitetit të këtij nënkomponenti dhe të mjedisit të kontrollit në tërësi.

➤ *Etika personale dhe profesionale*

Menaxherët e institucioneve janë përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e procedurave për raportimin e parregullive. Në lidhje me ekzistencën e procedurave për raportimin e gabimeve, mashtrimit dhe parregullive, pjesa më e madhe e institucioneve (89% e tyre) pohojnë se kanë procedurë të tilla ekzistuese. Ndërmjet këtyre institucioneve, efektiviteti i zbatimit të rregullave dhe procedurave mbi etikën paraqitet në nivele të kënaqshme si për ministritë, bashkitë dhe institucionet e pavarura, me një vlerësim prej mbi 80%. Por pavarësisht përgjigjeve pozitive, nga ana e institucioneve nuk është kuptuar që kërkesa ka të bëjë me ekzistencë procedurash të shkruara dhe jo zbatimin ose jo të kuadrit ligjor mbi etikën.

Për sa i përket kodit të etikës, institucionet kryesisht zbatojnë legjislacionin në fuqi dhe një pjesë e tyre (institucionet qendrore kryesisht) kanë përfshirë rregulla të etikës në rregulloret e brendshme. Por nuk rezulton që çdo institucion të ketë kodin/rregulloren e vet të etikës në përputhje me legjislacionin në fuqi, por edhe me veprimtarinë specifike të tij.

➤ *Struktura organizative*

Titullari i çdo institucioni publik duhet të ngrejë një strukturë organizative që të bëjë të mundur arritjen e objektivave dhe të jetë në pajtim me funksionet e ngarkuara sipas kuadrit ligjor. Struktura organizative është korniza me anë të së cilës planifikohen, zbatohen, kontrollohen dhe raportohen aktivitetet e njësisë. Ajo duhet të paraqitet në formë të dokumentuar duke evidentuar qartë rregullat për përcaktimin dhe ndarjen detyrave, detyrimeve dhe përgjegjësi, si dhe hierarkinë dhe linjat e përshtatshme të raportimit. Nga analiza e bërë, vihet re që rreth 90% institucioneve kanë një strukturë organizative që përputhet me madhësinë dhe aktivitetin e tyre, si dhe përcakton qartë detyrat dhe përgjegjësitë e departamenteve përkatëse. Ndërsa, bazuar në vetvlerësimin e bërë nga institucionet, efektiviteti i këtij nënkomponenti paraqitet në nivele mbi 80 %, për ministritë, bashkitë dhe institucionet e pavarura, përkatësisht me vlerësim 92%, 80% dhe 90%.

Drejtorja e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin monitoron në vazhdimësi caktimin e NZ bazuar në kriteret e përcaktuara në ligjin e rishikuar të MFK. Në ligjin e rishikuar, në krahasim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, janë reflektuar rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në të cilin janë ndryshuar kriteret për caktimin e NZ si më poshtë: së pari, mbarimi i studimeve të ciklit të dytë ose të një diplome ekuivalente me të, vetëm në shkencat ekonomike, dhe së dyti, pasja e një eksperience mbi 5 vjet në profesionin e ekonomistit. Gjithashtu, në njësitë publike të ndërtuara me më shumë se dy nivele vartësie, punonjësit e financës të vendosur në nivelet e poshtme të vartësisë, duhet të kenë përfunduar të paktën studimet e ciklit të parë në shkencat ekonomike për t'u konfirmuar si nëpunës zbatues.

➤ *Filozofia e menaxhimit të drejtuesve*

Ky nënkomponent reflekton pikëpamjet kryesore të drejtuesit rreth mënyrës se si duhen organizuar punonjësit dhe aktivitetet.

Në lidhje me mënyrën e menaxhimit, elementi pozitiv përfaqësohet nga praktika e mirë e zhvillimit të takimeve të rregullta të menaxhimit për diskutimin e çështjeve themelore të menaxhimit të njësisë publike ku ata bëjnë pjesë. Në disa njësi publike, frekuenca dhe mënyra e organizimit të takimeve janë të përshkruara në rregulloret e brendshme të institucioneve. Një ndër elementet thelbësorë përbërës të stilit menaxherial është dhe delegimi i detyrave. Aktualisht nga përgjigjet e Pyetësorëve të vetëvlerësimit, rreth 90% e institucioneve kryejnë procedura delegimi sipas kërkesave të ligjit të MFK, por realisht konstatohet se kemi të bëjmë me delegim në mungesë dhe jo delegim sipas kërkesave të neneve 9, 12 dhe 15 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.


Efektiviteti i mënyrës së menaxhimit të drejtuesve paraqitet në nivele pozitive si për ministritë, ashtu edhe për bashkitë e institucionet e pavarura, duke tregur për një qëndrim korrekt të nivelit të lartë menaxherial në institucionet publike ndaj raportimit të brendshëm dhe të jashtëm, auditimeve të brendshme e të jashtme apo edhe teknologjisë së informacionit.

➤ *Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore*

Politikat e burimeve njerëzore dhe praktikat e ngjashme lidhen me rekrutimin transparent, emërimin, trajnimin e vazhdueshëm, vlerësimin korrekt të performancës, avancimin në detyrë bazuar në rezultatet e performancës, si dhe me veprimet disiplinore të punonjësve të institucioneve publike.

Nga analiza e pyetësorëve të vetëvlerësimit, 80% e institucioneve kanë politika favorizuese në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore, ndërsa 19% shprehen se nuk kanë politika të mirëfillta motivuese për punonjësit. Gjithashtu, situata paraqitet më pozitive për ministritë dhe institucionet e pavarura se sa në bashkitë, të cilat kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme të mjedisit të kontrollit në përgjithësi.

Grafiku 2. Analiza e nënkomponentëve të mjedisit të kontrollit, 2015




*Shënim: Vetëvlerësimi është nga 1-4, sipas pyetësorit të vetëvlerësimit, ku 4 është vlerësimi maksimal dhe 1 është vlerësimi minimal.

Konstatime

1. Mosfunzionimi i rregullt i Grupit për Menaxhimin Strategjik në trajtimin e çështjeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si dhe mungesa e dokumentimit gjatë mbledhjeve të këtij grupi.
2. Mungesa e ndërgjegjësimit të institucioneve mbi konceptin e delegimit sipas ligjit të MFK dhe devijimi i rregullave të delegimit të dokumentuar, duke ndikuar në veprimtarinë e përditshme të institucioneve. Gjithashtu, vihet re vazhdimi i mungesës së besimit nga ana e Nëpunësve autorizues/zbatues për delegimin e përgjegjësive tek vartësit funksionalë.

2.1.2. Menaxhimi i Riskut

Grafiku 3. Vlerësimi i Menaxhimit të Riskut sipas pyetësorit të vetvlerësimit



*Shënim: Vetëvlerësimi është nga 1-4, sipas pyetësorit të vetëvlerësimit, ku 4 është vlerësimi maksimal dhe 1 është vlerësimi minimal.

Menaxhimi i Riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të risqeve me të cilat përballet njësia publike në arritjen e objektivave të saj, si dhe kryerja e kontroleve të nevojshme, për ta mbajtur ekspozimin ndaj riskut në një nivel të pranueshëm për institucionin. Menaxhimi i riskut paraqet një koncept të ri për administratën publike shqiptare, ende të pakonsoliduar. Për sa i përket akteve normative, përveç ligjit të MFK, i cili hedh bazat për futjen e konceptit të riskut dhe të dokumentimit të procedurave të identifikimit dhe vlerësimit të risqeve, aktet nënligjore në fushën e menaxhimit të financave publike të miratuara nga Ministria e Financave, shtjellojnë detyrat dhe përgjegjësitë në këtë fushë.

Pyetësori i vetëvlerësimit për këtë komponent përmban 6 pyetje. Nga përgjigjet e NJQP rezulton se më pak se gjysma e institucioneve kanë përgatitur regjistër dhe strategji rrisht të konsoliduar. Kryesisht këta elementë janë hartuar nga ministritë dhe 3 bashki kryesore, të cilat janë dhe institucione pilot. Gjithashtu, problematikë tjetër në lidhje me këtë çështje është se GMS nuk mbështetet me materiale të formalizuara për menaxhimin e risqeve strategjike, të cilat do të ndihmonin në marrjen e vendimeve efektive dhe arritjen e objektivave të institucionit.

Siç vihet re dhe nga grafikët e mësipërm, një pjesë e konsiderueshme e institucioneve publike janë në fazat e para të implementimit të këtij komponenti, ku rreth 19% e tyre, sipas Pyetësorit të vetëvlerësimit, akoma nuk kanë hartuar asnjë element të tij.

Ndërmjet institucioneve publike, problematikat më të mëdha paraqiten te njësitë vendore, të cilat kanë një efektivitet prej 59%, më të ulët se ministritë dhe institucionet e pavarura, të vlerësuara përkatësisht me 80.5% dhe 70%. Pra, si përfundim, mund të themi se menaxhimi i


riskut është një komponent thelbësor në implementimin e një sistemi modern të MFK, për të cilin institucionet publike kanë nevojë për asistencë teknike dhe rritje ndërgjegjësimit në periudhën në vijim.

Konstatime

1. Procesi i Menaxhimit të Riskut dhe vendosja e kontrolleve në disa nivele për fushat me risk më të lartë, vazhdon të mbetet në fazë fillestare.
2. Megjithëse vihet re një ndërgjegjësimit më i madh në rëndësinë e përgatitjes së regjistrit të riskut dhe strategjisë së riskut, këto dokumente mbeten të pa finalizuar me identifikimin e risqeve strategjike dhe diskutimin e tyre në Grupin e Menaxhimit Strategjik të kryesuar nga Titullari.
3. Bazuar në sa më sipër, vihet re mungesë marrje përgjegjësie/delegim kompetencash dhe si rrjedhim, mungesë monitorimi për minimizimin e risqeve.

2.1.3. Aktivitetet e Kontrollit

Grafiku 4. Vlerësimi i Aktiviteteve të Kontrollit sipas pyetësorit të vetvlerësimit



*Shënim: Vetëvlerësimi është nga 1-4, sipas pyetësorit të vetëvlerësimit, ku 4 është vlerësimi maksimal dhe 1 është vlerësimi minimal.

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet, që synojnë reduktimin e risqeve me synimin për të arritur objektivat e organizatës, si dhe për të nxitur zbatimin e vendimeve të titullarit. Në vendosjen e aktiviteteve të kontrollit, titullarët e institucioneve duhet të marrin parasysh përfitimet që këto aktivitete pritet të japin, sikurse dhe kostot për futjen dhe zbatimin e tyre. Aktivitetet e kontrollit duhet të ingranohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit më vonë, do të ishte më e kushtueshme dhe më pak efiçente. Njësitë publike deklarojnë se kanë përmbushur kërkesat ligjore minimale dhe kanë vënë në zbatim kontrolle të përshtatshme në fushat e mëposhtme si: ekzistencën e rregullave/udhëzimeve të brendshme për përshkrimin e proceseve kryesore operacionale dhe financiare, ndarjen e detyrave, delegimin e detyrave dhe përgjegjësi.

Pyetësori i vetëvlerësimit për këtë komponent përbëhet nga 7 pyetje, të analizuar në tërësi. Siç vihet re dhe nga grafiku i mësipërm, 77% e institucioneve publike deklarojnë se përdorin aktivitete kontrolli për reduktimin e risqeve dhe arritjen e objektivave, ndërsa pjesa tjetër është ende në fazat e para të zbatimit të këtyre aktiviteteve. Ky komponent paraqitet në nivele të kënaqshme për të gjitha NJQP, ku ministritë dhe institucionet e pavarura karakterizohen nga një efektivitet mbi 90% dhe në rritje në krahasim me vitin 2013, ndërsa situata në pushtetin lokal paraqitet më pak efektive, me një vlerësim prej 71% dhe në rënie nga viti 2013.

Mbi sa më sipër, mund të konkludojmë që ecuria e këtij komponent është e lartë dhe koncepti është kuptuar dhe zbatuar në pjesën më të madhe të institucioneve publike.

➤ *Ndarja e detyrave*

Brenda çdo njësie publike është e detyrueshme të ketë një hierarki të menaxhimit, me titullarin e njësisë që ka përgjegjësinë kryesore për miratimin e politikave dhe rregullave të brendshme të KB, dhe pastaj përgjegjësitë individuale menaxheriale që shpërndahen tek NA dhe çdo menaxher brenda njësisë (përfshi edhe drejtuesit e njësive të vartësisë). Ky proces menaxhimi duhet të dokumentohet plotësisht duke përfshirë shkallën e çdo kompetence individuale të menaxherit, niveli i vendimmarrjes së menaxherit dhe mënyra e raportimit.

Pavarësisht përgjigjeve të dhëna nga NJQP mund të theksojmë se, për përshkrimet e pozicioneve të punës ekziston një bazë ligjore dhe një praktikë e mirë në këtë drejtim. Në lidhje me këtë aspekt të ndarjes së detyrave mund të pohojmë që në pjesën më të madhe të njësive publike (në të gjitha njësitë qendrore dhe pjesërisht në ato vendore) ekzistojnë përshkrimet e punës. Ato përfshihen në rregulloret e brendshme ose në kontratat e punës. Ndryshimet e vazhdueshme të strukturave, si dhe të formatimit të drejtorive, kërkojnë dhe rishikimin në vazhdimësi të rregulloreve të brendshme të institucioneve. Nga monitorimi i kryer në vazhdimësi është konstatuar që në pjesën më të madhe të institucioneve nuk është bërë rishikimi i rregulloreve të brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore të tyre.

➤ *Përshkrimi i proceseve të punës*

Përgatitja e manualeve me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të procesit. Vërehet që në praktikë ka një moskuptim të domosdoshmërisë së ekzistencës së përshkrimit të proceseve të punës. Jo vetëm kaq, por shpeshherë përshkrimi i procesit të punës konfundohet me përshkrimin e pozicionit të punës. Për të bërë të mundur që çdo institucion të përgatisë manualin e proceseve të punës DH/MFK do të përgatisë një format standard dhe ti asistojë institucionet për ta realizuar këtë proces duke i trajnuar në vazhdimësi.

➤ *Menaxhimi i aktiveve*

Në praktikë ka probleme në fushën e menaxhimit të aktiveve, sidomos për sa i përket vendimmarrjes për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve publike. Në bazë të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 të ministrit të Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, çdo NJQP ka detyrimin e përgatitjes së udhëzimeve specifike për njësitë e tyre. Kjo përsa i përket organizimit të brendshëm të procesit të vlerësimit dhe kompetencave në daljen nga përdorimi të aktiveve të tyre.

Bazuar në përgjigjet e pyetësorëve të vetëvlerësimit të institucioneve, i gjithë procesi i menaxhimit të aktiveve realizohet kryesisht sipas Udhëzimit bazë nr. 30 dhe jo sipas udhëzimeve specifike të tyre. Gjithashtu, një problem i evidentuar është procedura për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e ndërtesave ekonomike dhe administrative.

Konstatime


1. Moskuptimi i domosdoshmërisë së hartimit të manualeve të proceseve të punës si dhe konfondimi i manualit të proceseve të punës me përshkrimin e pozicioneve të punës.
2. Mungesa e një baze ligjore të plotë dhe të detajuar në lidhje me procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e ndërtesave ekonomike dhe administrative.
3. Mbështetja në çështjet e menaxhimit të aktiveve vetëm në Udhëzimin bazë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, duke mos hartuar

akte nënligjore specifike në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe veprimtarinë e institucioneve.

2.1.4. Informimi dhe Komunikimi

Grupi i katërt i komponentëve të KB, paraqitur në grafikun më poshtë, lidhet me çështjet e informacionit dhe të komunikimit. Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet personave dhe institucioneve, për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara. Informacioni i duhet komunikuar titullarit dhe nëpunësve të tjerë, në formën dhe në kohën e duhur, për t'i ndihmuar ata në përmbushjen e përgjegjësive të tyre.

Grafiku 5. Vlerësimi i Informimit dhe Komunikimit sipas Pyetësorit të vetëvlerësimit



*Shënim: Vetëvlerësimi është nga 1-4, sipas pyetësorit të vetëvlerësimit, ku 4 është vlerësimi maksimal dhe 1 është vlerësimi minimal.

Pyetësori i vetëvlerësimit për këtë komponent përmban 6 pyetje, për të cilat është bërë analiza e përgjithshme e mëposhtme. Nga përgjigjet e NJQP mbi çështje specifike si vënia në dispozicion e informacionit mbi arritjen e objektivave, dhe informacionit të nevojshëm për kryerjen e detyrave, si dhe mbi ekzistencën e kanaleve të komunikimit për parregullsitë, vërehen aspekte të kënaqshme në këtë fushë, pasi rreth 90% për qind e institucioneve janë përgjigjur pozitivisht ndaj këtyre elementeve. Në përgjithësi, institucionet i kanë të trajtuara këto çështje nëpërmjet rregulloreve të brendshme të tyre.

Përsa i përket analizës ndërmjet institucioneve, vihet re një rritje e ndjeshme e efektivitetit të këtij komponenti, sidomos për bashkitë dhe institucionet e pavarura, në krahasim me vitin 2013. Vlerësimi i përgjithshëm, për vitin 2015, i Informimit dhe Komunikimit është mbi 80%, megjithatë, theksojmë se nga ana e drejtuesve dhe stafit të institucioneve nuk është kuptuar termi i sistemit të informacionit dhe komunikimit, i cili nuk përfshin vetëm sisteme IT apo elektronike, por një rrjet të brendshëm të strukturuar të marrjes dhe dhënies së informacionit ndërmjet niveleve të ndryshme hierarkike në funksion të arritjes së objektivave dhe menaxhimit të mirë të fondeve.

Konstatime


1. Raportimet e brendshme, kryesisht janë vetëm të natyrës financiare dhe nuk përfshijnë informacione të tjera që lidhen me treguesit e performancës së nevojshme për menaxhimin.

2.1.5. Monitorimi

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të institucionit, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficiente me kalimin e kohës. Sistemi dhe komponentët e tij të veçantë mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të monitorimit apo nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura.

Fokusi këtë vit, si në pyetësorët, ashtu edhe në raportet vjetore, ka qenë raportimi periodik i drejtorive të ndryshme tek titullari, monitorimi i progresit të arritjes së objektivave dhe përmbushja e pritshmërive në lidhje me aktivitetin e njësisë së auditimit të brendshëm.

Grafiku 6. Vlerësimi i Monitorimit sipas Pyetësorit të vetëvlerësimit



*Shënim: Vetëvlerësimi është nga 1-4, sipas pyetësorit të vetëvlerësimit, ku 4 është vlerësimi maksimal dhe 1 është vlerësimi minimal.

Mbi bazën e analizës së kryer, siç paraqitet në grafikun më sipër, konstatohet se 78% e institucioneve kryejnë një monitorim të rregullt mbi ecurinë e aktiviteteve të ndërmarrja prej tyre. Efektiviteti i sistemit të monitorimit paraqitet në rritje për ministritë dhe institucionet e pavarura, të cilat në vitin 2015, janë vlerësuar respektivisht me 93% dhe 84%, ndërkohë në institucionet lokale evidentohet një situatë më pesimiste. Komponenti i monitorimit për pushtetin lokal vlerësohet me një efektivitet prej 73%, më i ulët se dy vitet e tjera, gjë e cila vjen si pasojë e mungesës së njësive të auditimit të brendshëm në një numër të konsiderueshëm institucioneve vendore.

Konstatime

1. Mungesë monitorimi në shumicën e institucioneve vendore për shkak të mungesës së njësive të auditimit të brendshëm, duke ndikuar në këtë mënyrë në efektivitetin e komponentit të monitorimit.

2.2. Analiza e përgjithshme e institucioneve të pavarura për vitin 2015

Vlerësimi i sistemeve të MFK në njësitë qendrore të pavarura për vitin 2015 (gjithsej 24 institucione) u bazua në pyetësorët e vetëvlerësimit, deklaratën personale të NA të njësive qendrore të pavarura dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, ku është për t'u theksuar fakti që këto materiale janë paraqitur nga të gjitha njësitë qendrore të pavarura, brenda afatit kohor të përcaktuar.


Gjatë kësaj analize u vlerësuan të pesë komponentët e MFK, si: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi dhe komunikimi, monitorimi duke u mbështetur jo

vetëm në aspektin statistikor, por edhe në komentet përkatëse të njësive në raportet e tyre të vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm.

Në bazë të pikëve të vlerësuara në total për të pesë komponentët e MFK, u përfitua rankimi i mëposhtëm, i paraqitur nëpërmjet grafikut në vijim.

Siç vihet re, në grafikun më poshtë, institucioni me pikët më të larta është Shërbimi Informativ i Shtetit me 154 pikë nga 156 pikë maksimale të mundshme, duke u renditur në këtë mënyrë në vend të parë, me një realizim performance prej 98.7%. Më pas, me vetëvlerësim më të lartë kemi institucionin e Presidentit, ILDKPKI, Autoritetin e Konkurrencës, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, etj, të cilët kanë grumbulluar respektivisht 153, 150, 150 dhe 149 pikë. Bazuar në këtë vetëvlerësim, performanca e këtyre institucioneve paraqitet e kënaqshme, pasi nga pikët e marra, sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit rezulton me një efektivitet minimal prej 71%, i cili i përket institucionit të pavarur të renditur në vend të fundit, me 111 pikë.

Grafiku 7. Totali i vlerësimit të cilësisë së sistemit të MFK në Njësitë Qendrore të Pavarura



*Shënim: Vlerësimi në pikë i sistemit të MFK nga 156 pikë maksimale të mundshme.

Bazuar në nenet 25 dhe 26, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", DH/MFK, ka si funksion të saj monitorimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucionet publike.

DH/MFK në fund të muajit prill 2016, ka kryer monitorimin për sistemet e MFK për vitin 2015, mbi bazë dokumentare pranë Nëpunësit Autorizues të dy institucioneve të pavarura: Presidencës dhe Kuvendit.

Çështjet që u monitoruan, u fokusuan në pyetjet e mëposhtme:

1. A është rishikuar rregullorja e brendshme e institucionit në kuadrin e kërkesave të ligjit të MFK?
2. A ka procedura të shkruara delegimi?
3. A është përgatitur regjistri i riskut i institucionit?
4. A ka manual për proceset e punës?
5. A ka procedura të shkruara për administrimin e aktiveve bazuar në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në institucionet publike"?

Më poshtë rendisim rezultatet e këtyre monitorimeve:

1. Presidenca

Gjatë monitorimit evidentohet fakti se ky institucion duhet të rrisë shkallën e përgjegjshmërisë ndaj implementimit të sistemit të kontrollit të brendshëm. Rezultatet e monitorimit janë si më poshtë vijon:

- Rregullorja e këtij institucioni është rishikuar.
- Nuk është ndërtuar një regjistër risku i konsoliduar, por ai është në proces për drejtori të veçanta, si dhe nuk ka manuale të proceseve të punës sipas ligjit të MFK.
- Delegimi i detyrave funksionon vetëm në mungesë bazuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe jo në detyrë, sipas kërkesave të ligjit nr. 10296/2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar.
- Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në Udhëzimin nr. 30 datë, 27.12.2011, ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" dhe nuk ka ndonjë udhëzim specifik.

2. Kuvendi

Gjatë monitorimit rezultoi një ndërgjegjësime i lartë mbi kontrollin e brendshëm nga ana e menaxherëve të lartë të këtij institucioni dhe stafit si dhe në varësi të kërkesave, informacioni vijon si më poshtë:

- Rregullorja e brendshme e këtij institucioni është rishikuar. Kjo rregullore përmbante të gjitha procedurat dhe rregullat mbi etikën e institucionit, komunikimin dhe funksionimin e sistemit të IT.
- Regjistri i riskut ishte përgatitur nga çdo drejtori dhe ishte konsoliduar në një dokument të vetëm.
- Ky institucion ka përgatitur Strategjinë e menaxhimit të riskut të konsoliduar.
- Delegimi i detyrave funksionon si në mungesë bazuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe në detyrë, sipas kërkesave të ligjit nr. 10296/2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar.
- Ishte përgatitur strategjia e konsoliduar e objektivave për të gjithë institucionin.
- Nuk kishte manual të proceseve të punës sipas formatit të kërkuar nga DH/MFK, por kishte procedura të shkruajtura për proceset e punës.
- Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në Udhëzimin nr. 30 datë, 27.12.2011, ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike" dhe nuk ka ndonjë udhëzim specifik.

KAPITULLI III - IMPLEMENTIMI I KËRKESAVE TË MFK NË 7 INSTITUCIONE PILOT

3.1. Implementimi i MFK në institucionet pilot për vitin 2015

Projekti i binjakëzimit "Implementimi i një Sistemi Modern për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Inspektimin Financiar Publik në Shqipëri", i financuar nga fondet IPA 2012, zhvilluar në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të Austrisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të Francës, ka si qëllim implementimin e kërkesave të MFK në institucionet publike. Në këtë kuadër, u përzgjedhën 7 institucione pilot, nga të cilat 3 janë ministri (Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë), ndërsa në nivel lokal janë përfshirë katër njësi të qeverisjes vendore (Bashkia Berat, Bashkia Shkodër, Bashkia Korçë dhe ajo e Pogradecit). Përzgjedhja e institucioneve u bazua në performancën dhe në gatishmërinë e tyre për t'u përfshirë në projekt. Për këtë, u komunikua paraprakisht me Nëpunësit Autorizues dhe Zbatues, të cilëve ju paraqit fokusi i projektit, i cili ishte futja e mjeteve të MFK në këto institucione, për të shërbyer si bazë për zgjerimin e tyre në njësitë e tjera. Gjatë vitit 2015, ekspertët në bashkëpunim me stafin e DH/MFK kanë realizuar katër misione si më poshtë:

- Vlerësimi i funksionimit të sistemit të KBFP, për të cilin u përgatitën pyetësorë specifik për çdo grup institucionesh lidhur me komponentët e ndryshëm të KB. Pas këtij vlerësimi, u përgatitën raporte nga ekspertët, të cilët evidentonin problemet e institucioneve përkatëse si dhe fokusin e aktiviteteve në vazhdim.
- Misioni i Menaxhimit të Riskut, i cili konsiston në prezantimin dhe zhvillimin e menaxhimit të riskut në këto institucione pilot. Gjatë këtij aktiviteti çdo strukturë e këtyre institucioneve përgatiti regjistrin e risqeve bazuar në objektivat e secilës drejtori.
- Misioni për përgatitjen e listës së proceseve u fokusua në identifikimin e proceseve kryesore të punës dhe në plotësimin e formatit standard sipas manualit të MFK. Çdo drejtori përgatiti hartat e proceseve për proceset kryesore.
- Misioni i përgatitjes së gjurmëve të auditimit. Bazuar në listën e proceseve të përgatitura në misionin e mëparshëm, u punua për përgatitjen e gjurmëve të auditit për proceset kryesore të punës. Këto gjurmë u hartuan mbi bazën e një formati standard dhe simboleve të unifikuara.

Gjatë vitit 2016, është realizuar dhe misioni i fundit i parashikuar, i cili konsistonte në zhvillimin e një plan veprimi, bazuar në regjistrin e riskut dhe të hartës së proceseve të institucionit, për marrjen e masave për minimizimin e risqeve që pengonin arritjen e objektivave.

Bazuar në aktivitetet e mësipërme, institucionet pilot patën këto rezultate dhe përmirësime:

Menaxhimi i riskut

Si komponenti më i rëndësishëm i MFK, menaxhimi i riskut u fokusua kryesisht në hartimin e regjistrit të risqeve dhe të planit të kontrollit për minimizimin e risqeve me nivel më të lartë. Në lidhje me përgatitjen e regjistrit të risqeve në institucionet pilot situata është si më poshtë:

- Në tre ministritë pilot, (Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë) është përgatitur regjistri i riskut në nivel institucioni sipas programeve buxhetore. Planit i veprimeve për minimizimin e risqeve është akoma në proces nga këto institucione.
- Në Bashkitë Korçë, Berat Shkodër, është përgatitur regjistri i risqeve për të gjitha drejtoritë, kurse në Bashkinë Pogradec është punuar me të gjitha drejtoritë për regjistrin e risqeve, por nuk është finalizuar në një dokument të vetëm.

Harta dhe manuali i proceseve të punës, si dhe gjurma e auditimit

Në lidhje me këtë aktivitet, situata është si më poshtë:

- Në MBZHRAU dhe MAS është punuar për përgatitjen e hartës së proceseve në disa drejtori, kurse gjurma e auditit është përgatitur vetëm për disa procese kryesore.
- MMSR ka përgatitur një draft të hartës dhe manualit të proceseve të punës në pjesën më të madhe të drejtorive, gjithashtu janë përgatitur dhe gjurmët e auditit për këto procese.
- Bashkitë Berat dhe Korçë kanë përgatitur hartat e proceseve të punës për të gjitha drejtoritë, kurse gjurmët e auditit vetëm për proceset kryesore. Bashkia Shkodër ka përgatitur hartat e proceseve për pjesën më të madhe të drejtorive, ndërsa gjurma e auditit vetëm në disa procese. Në Bashkinë Pogradec është punuar në çdo drejtori për hartën e proceseve, por nuk është finalizuar në një dokument të vetëm.

Problematikat dhe rekomandimet për përmirësim

Problemet e konstatuara gjatë zhvillimit të aktiviteteve në shtatë institucionet pilot janë si më poshtë:

- Mungesa e angazhimit të nivelit të lartë menaxherial dhe stafit operativ.
- Mos finalizimi i dokumentave të instrumenteve të MFK, të cilët janë ende në proces.
- Në disa institucione, nëpunësi zbatues nuk është angazhuar plotësisht.
- Nga të gjitha bashkitë e përfshira në këtë projekt, Bashkia Pogradec nuk arriti t'i përgjigjet kërkesave të projektit dhe për rrjedhojë nuk u arrit të realizojë produktet e parashikuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (DH/MFK).

Rekomandimet për përmirësim janë:

- Në bazë të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i rishikuar, çdo institucion duhet të emërojë një punonjës nga sektori i financës, i cili do të luajë rolin e koordinatorit të deleguar të MFK dhe riskut.
- Institucionet pilot duhet të përgatisin një plan veprimi për ecurinë e produkteve të cilat nuk janë realizuar.

DH/MFK do të vazhdojë të monitorojë në vazhdimësi të gjitha këto insitucione, në mënyrë që procesi i nisur të finalizohet me sukses. Për këtë qëllim:

- DH/MFK do të përgatisë planin e veprimit për të ndjekur ecurinë e realizimit të të gjithë elementeve të zhvilluar në aktivitetet e mësipërme;
- Për institucionet pilot do të zhvillohet monitorimi në vend për të gjithë komponentët e KB;
- Gjithashtu, procesi i pilotimit për implementimin e MFK do të vazhdojë të realizohet dhe për institucionet e tjera të sektorit publik në mënyrë të njëpasnjëshme.

KAPITULLI IV – VEPRIMTARIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Të dhënat e veprimtarisë së auditimit të brendshëm janë analizuar nga konsolidimi i raporteve vjetore të 98 njësi të auditimit të brendshëm (NJAB) nga 103 NJAB që funksionojnë në sektorin publik. Për vitin 2015, nuk kanë raportuar NJAB-të e ngritura në Prefekturën Fier, Prefekturën Gjirokastrë, Prefekturën Elbasan, Qendrën Spitalore Korçë dhe Universitetin Durrës. Në raportet vjetore të njërive të auditimit të brendshëm janë prezantuar rezultatet e veprimtarisë së tyre gjatë vitit 2015, si dhe sfidat me të cilat ato janë përballur, sipas një formati të standardizuar raportimi, të përcaktuar nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (DH/AB)². Nga analiza e këtij sistemi kanë dalë konkluzione të rëndësishme, mangësi, të meta dhe arritje, të cilat do të jenë bazë për DH/AB, për të reflektuar në ndryshime pozitive për ecurinë e auditimit të brendshëm në tërësi.

4.1 Analiza e strukturave të auditimit të brendshëm

Për zhvillimin sa më efikas të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik është e domosdoshme ngritja e strukturave të auditimit dhe komunikimi i vazhdueshëm ndërmjet elementeve të këtij sistemi. Aktet ligjore dhe nënligjore për auditimin e brendshëm përcaktojnë kërkesën që çdo njësi publike duhet të kryejë shërbimin e auditimit të brendshëm, sipas mënyrave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore për këtë fushë.

Fuqizimi i këtij sistemi është vendimtar dhe i rëndësishëm së veçantë për të mbështetur titullarët e njërive publike në arritjen e objektivave dhe në mënyrë të veçantë për të bërë qeverisjen publike më efikase dhe efektive.

Aktualisht baza rregullative e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik është në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, këtu mund të përmendim Ligjin nr 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Manualin e Auditimit, Kodin e Etikës, Kartën e Auditimit të Brendshëm të miratuar nga çdo njësi si dhe në aktet e tjera nënligjore. NJAB bazuar në aktet e mësipërme kryejnë veprimtarinë audituese nëpërmjet zbatimit të Planit Strategjik dhe Vjetor të auditimit, i cili përcakton qartë objektivat për t’u arritur, vlerësimin e riskut, treguesit e matjes së performancës së auditimit, si dhe kapacitetet në dispozicion.

DH/AB në Ministrinë e Financave monitoron veprimtarinë e auditimit të brendshëm në të gjithë subjektet e sektorit publik dhe vlerëson në mënyrë periodike këtë veprimtari në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar dhe praktikatat më të mira evropiane.

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet DH/AB dhe NJAB-ve në ministrinë e linjës, institucionet e vartësisë, institucionet e pavarura dhe në pushtetin vendor, ka konsistuar në: shkëmbimin e eksperiencave dhe dhënien e mendimeve për ndryshimet ligjore dhe nënligjore, zgjidhjen e problematikave të ndryshme, si dhe në analizën dhe vlerësimin e veprimtarisë së strukturave audituese në shkallë vendi.

Nga të dhënat e mbledhura, deri në fund të vitit 2015 numri i NJAB në sektorin publik konsiston në 103 njësi që funksionojnë në njësi të qeverisjes qendrore dhe lokale. Tabela e mëposhtme jep informacion të detajuar mbi ecurinë e procesit të krijimit të strukturave audituese në subjektet publike për katër vitet e fundit:

² Format i ri i raportimit u bazua në strukturën e përcaktuar në botimin e Robert de Koning “Public Internal Financial Control” (fq.295); www.pifc.eu

Tabela 8. Ecuria e krijimit të NJAB gjatë viteve 2012-2015

NJAB	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
Institucione Qendrore	14	16	16	16
Institucione të Vartësisë	31	30	31	40
Prefektura & N/Prefektura	15	15	14	14
Institucione të Pavarura	8	8	8	8
Pushteti Vendor	41	37	31	25
Gjithsej	109	106	100	103

Gjatë këtij viti vihet re një rritje e lehtë në numrin e NJAB (3 më shumë se në vitin 2014). Nga analiza e përbërjes së strukturave audituese konstatojmë se nga 395 auditues të brendshëm të planifikuar sipas organikave të miratuara, aktualisht janë të punësuar 363, nga të cilët 328 janë të certifikuar si “Auditues të brendshëm në sektorin publik” dhe 35 punonjës të NJAB-ve nuk e zotërojnë këtë certifikatë.

Shërbimi i auditimit të brendshëm përfshin jo vetëm vlerësimin e sistemeve të kontrollit, por dhe dhënien e rekomandimeve të vlefshme për menaxherët. Për rrjedhojë audituesit e brendshëm duhet të zotërojnë dhe të tregojnë se kanë nivelin e duhur profesional, si dhe integritet për të siguruar ushtrimin e drejtë dhe të saktë të funksionit të tyre.

Në tabelën nr. 9 jepet një informacion i detajuar mbi shpërndarjen e numrit të audituesve sipas strukturave, si dhe statusin e tyre lidhur me certifikimin si “Auditues të brendshëm në sektorin publik”.

Tabela 9. Të dhëna për Audituesit e Brendshëm

Emërtimi	Struktura (numri)	Auditues të brendshëm Plan/Fakt	Të certifikuar	Të pa certifikuar
Ministritë e Linjës	16	93/83	79	4
Inst. Qendrore	40	159/146	127	19
Pref. & N/Prefektura	14	53/47	46	1
Inst.të Pavarura	8	30/29	29	0
Pushteti Vendor	25	60/58	47	11
Shuma	103	395/363	328	35

Nga këto të dhëna, vihet re një numër prej 35 punonjës të NJAB-ve janë të pa certifikuar, të cilët sipas specifikimeve ligjore janë të detyruar të ndjekin procesin e certifikimit brenda një periudhe dy-vjeçare, gjatë së cilës do të jenë nën mbikëqyrjen e audituesve të brendshëm me përvojë.


Nga analiza e përbërjes profesionale të stafit auditues të punësuar gjatë vitit 2015 vërejmë që numrin më të madh e zënë specialistë të fushave ekonomike, ku 307 auditues janë diplomuar si ekonomistë, 41 juristë dhe vetëm 15 i përkasin disiplinave të tjera. Duke marrë në konsideratë fushat e ndryshme të sektorit publik që janë objekt i auditimit, është e nevojshme që dhe audituesit e brendshëm të jenë të profilizuar sipas fushave specifike të veprimtarisë së njësive publike. Ky profilizim bazohet dhe në ligjin në fuqi të auditimit të brendshëm. Aktualisht në 103 NJAB-të në sektorin publik vihet re se: NJAB e Fondit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor ka në përbërjen e saj mjek dhe farmacist, NJAB-të në Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike kanë në përbërje inxhinier elektrik, Drejtoria e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave ka të punësuar në NJAB inxhinier ndërtimi, etj.

Përbërja profesionale e audituesve, e cila konsiston në faktin që pjesa më e madhe e tyre i përkasin fushës së ekonomisë, është e lidhur edhe me nivelin e lartë të auditimeve me karakter financiar që kryhen aktualisht, në raport me auditimet e llojeve të tjera. Në lidhje me këtë, vihet

re një rritje e audituesve të brendshëm me profesion bazë në shkencat ekonomike, nga 295 ekonomistë të punësuar në vitin 2014 në 307 ekonomistë për vitin 2015.

Grafikisht përbërja profesionale dhe vjetërsia në auditimin e brendshëm e shprehur në % paraqitet si më poshtë:

Grafiku 8. Vjetërsia e AB gjatë 4 viteve dhe ndarja profesionale e AB e shprehur në%



Një nga kushtet e punësimit si auditues i brendshëm është dhe eksperiencia në profesionin bazë, e diferencuar për drejtues të NJAB dhe specialistë të auditimit të brendshëm. Nga analiza e të dhënave të raportuara nga strukturat audituese, rezulton se 135 punonjës kanë eksperiencë pune në auditim deri në 5 vjet dhe 228 mbi 5 vjet punë si auditues. Numri i konsiderueshëm i punonjësve me mbi 5 vjet punë në strukturat audituese shihet si një faktor tek i cili mund të mbështetemi për të krijuar nivelin e sigurisë mbi cilësinë e punës së audituesve.

Nga analiza e kryer me të dhënat e disponuara nga DH/AB, rezulton se brenda një periudhe prej 2-3 vitesh një numër i konsiderueshëm prej mbi 20% të audituesve të brendshëm plotësojnë kushtet e përfitimit të pensionit të pleqërisë.

4.2 Vlerësimi i performancës

Gjatë planifikimit vjetor të angazhimeve të auditimit, NJAB-të i kushtojnë gjithnjë e më shumë vëmendje përmirësimit të procesit të planifikimit. Prioriteti i DH/AB, si vlerësuese e jashtme e cilësisë së punës audituese, është orientimi i NJAB-ve gjithnjë e më shumë ndaj identifikimit dhe përfshirjes në auditim të fushave me risk të lartë, auditime të mirëfunksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar, pajtueshmërisë me rregullat, si dhe auditimin e performancës së të gjitha njësive të publike, me qëllim arritjen e objektivave të vendosura nga titullarët e njësive publike.

Përcaktimi i këtyre fushave me risk të lartë bëhet që në fazën e planifikimit të veprimtarisë për vitin përkatës, megjithatë, si rezultat i rivlerësimit të riskut gjatë vitit dhe kur menaxhimi e ka gjykuar të arsyeshme, për fusha të cilat risku në situata të veçanta paraqitet më i lartë se vlerësimi në planin vjetor, kryhen angazhime auditimi me urdhër të veçantë të titullarëve.

Në drejtim të rritjes së performancës si dhe kontributit në shtimin e vlerës dhe këshillave për menaxhimin, kanë qenë dhe mbeten në fokus kryesor të auditimit aktivitetet apo fushat me risk të lartë, si dhe sistemet e kontrollit të brendshëm.


4.2.1 Plani dhe realizimi i veprimtarisë

Njësitë e Auditimit të Brendshëm që në fazën e planifikimit të punës për programimin e subjekteve dhe përcaktimit të tematikave të auditimit për vitin 2015, janë mbështetur në këto kritere:

- Marrja në konsideratë e mendimeve dhe sugjerimeve nga titullari i njësisë publike;
- Përcaktimi i prioriteteve dhe mjeteve për të arritur objektivat me një kosto sa më të ulët;
- Përfshirja në Planin Vjetor të Auditimit të subjekteve me risk të lartë;

- Përcaktimi i saktë i afatit për auditimin e radhës;
- Marrja parasysh e gjetjeve dhe rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.


Grafiku 9. Realizimi i misioneve të AB, 2012-2015



Siç vihet re nga grafiku i mësipërm, nga viti në vit kemi një rënie të numrit të angazhimeve të auditimit, por duke rritur gjithnjë e më shumë cilësinë e tyre. Kjo analizë vjen si rezultat i vlerësimit të raporteve finale të NJAB. Cilësia vihet re si në hapat e ndjekur nga NJAB që në planifikimin e subjekteve deri në ndjekjen e rekomandimeve të dhëna. Gjatë këtij viti strukturat e auditimit të brendshëm kanë realizuar 1,515 angazhime auditimi kundrejt 1,609 të programuara, që e shprehur në përqindje përbën 94% të Planit Vjetor të miratuar.

Në figurën 10 përcaktohet realizimi i misioneve të auditimit për vitin 2015 sipas llojit, kundrejt auditimeve të parashikuara për t'u kryer gjatë kësaj periudhe. Nga të dhënat e pasqyruara vërehet se gjatë vitit 2015 ka një ndryshim të pranueshëm të planit të realizuar krahasuar me planin e miratuar.

Grafiku 10. Llojet e AB sipas realizimit



Sipas të dhënave të analizuara vihen re shmangie të angazhimeve të auditimit nga planifikimi. Analiza e veprimtarisë tregon se shmangiet më të mëdha lidhen me llojet e auditimeve të kryera. Në lidhje me këtë, nga analiza e të dhënave rezulton se kanë ndikuar faktorët e mëposhtëm:

- Ndryshimi i prioriteteve në veprimtaritë e subjekteve të audituara, pra ndryshim i shkallës së vlerësimit të riskut (fushat e konsideruara me risk të ulët gjatë fazës së planifikimit kanë rezultuar me risk të një shkalle më lartë dhe anasjelltas); Në subjekte në të cilat risku është vlerësuar i një niveli të lartë, vëmendje e madhe i është kushtuar procesit të ndjekjes së rekomandimeve, duke synuar jo vetëm përcaktimin e dëmit të shkaktuar apo përgjegjësi, por mbi të gjitha përmirësimin dhe parandalimin në përsëritjen e fenomeneve të tilla në të ardhmen.
- Ndërhyrja e titullarëve në zbatimin e planeve të auditimit, duke kërkuar auditime të rëndësishme të veçantë jashtë planeve.
- Planifikim të pabazuar në burimet reale të NJAB, ku mund të përmendim: Shërbimin Kombëtar të Punësimit 18/15, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve 20/16, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve 22/18, Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI 16/10, Qendrën Spitalore Vlorë 13/6, Albpetrol Fier 20/12, OST 20/12, OSHEE 8/0, Zyrën e Administrimit Buxhetit Gjyqësor 17/7, Bashkinë Tiranë 39/17, Bashkinë Kamëz 15/12,

Bashkinë Pogradec 13/6, Bashkinë Tepelenë 16/7, Bashkinë Mallakastër 14/9, Bashkinë Vlorë 12/8, Bashkinë Kuçovë 8/2, Bashkinë Lushnjë 15/11, Bashkinë Librazhd 13/7, Bashkinë Kukës 9/4 dhe Bashkinë Prenjas 17/7.

- Ndikim jo të vogël ka dhënë mbivendosja e angazhimeve të auditimit të parashikuara nga NJAB, pjesë përbërëse e njësive të vartësisë me auditimet e parashikuara nga njësi auditimi të brendshëm nga institucionet qendrore ose auditimi i jashtëm (KLSH).
- Performancë jo në kërkesat e standardit të audituesve në kryerjen e funksionit të tyre, e theksuar kjo sidomos në stafin e punësuar rishtazi, pa eksperiencë, të patrajnuar e të pacertifikuar për njohuritë që kërkon profesioni. Një fenomen i tillë vlerësohet të ketë sjellë vonesa në kryerjen dhe përfundimin e misionëve të auditimit brenda afateve të caktuara.

Faktorët e trajtuar më sipër, që kanë ndikuar në ndryshimin e planit të auditimit, do të merren në konsideratë dhe do të trajtohen nga NJAB-të me synimin e minimizimit të impaktit negativ që ato kanë në ushtrimin normal dhe të qëndrueshëm të veprimtarisë audituese.

4.2.2. Vlerësimi i riskut

Në Planet Strategjike dhe Vjetore të NJAB janë bërë përpjekje nga ana e audituesve të brendshëm për të identifikuar dhe vlerësuar risqet kryesore për veprimtarinë e njësive publike, por theksojmë se kjo procedurë kërkon akoma punë nga ana e strukturave audituese. Një planifikim i tillë kërkon njohje të mirë të funksionimit të njësive publike dhe pavarësi të plotë të audituesve të brendshëm.

Vlerësimi i riskut është një proces i rëndësishëm tek i cili audituesit e brendshëm duhet të mbështesin gjithnjë e më shumë planifikimin e punës së tyre, duke shpresuar në rritjen e cilësisë së punës audituese. Ndryshimi i planeve të auditimit tregon se ndonëse ka filluar të zbatohet procesi i vlerësimit të riskut, ai duhet të zhvillohet dhe përsoset më tej për të qënë në pajtueshmëri të plotë me standardet e fushës.

Gjatë ushtrimit të funksionit të auditimit të brendshëm në të gjithë aktivitetin e njësive publike është përfshirë vlerësimi dhe funksionimi i kontrollit të brendshëm, klasifikimi, mënyra e operimit dhe efektiviteti i tij. Ky drejtim i auditimit të brendshëm duhet vlerësuar dhe duhet parë me përparësi, për vetë faktin se mosfunksionimi i kontrollit të brendshëm, ka sjellë pasojë prezencën e risqeve dhe ndikimin e tyre në arritjen e objektivave strategjike të njësive publike. Në njësitë ku auditimi i brendshëm ka identifikuar dhe përcaktuar risqet kryesore, është informuar drejtuesi i njësive publike rreth fushave me risk, ku ka nevojë të ndërmerren veprime të mëtejshme, si dhe është rekomanduar njësia për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe përcaktimin sa më të qartë të përgjegjësisë, për të menaxhuar risqet me qëllim frenimin dhe minimizimin e tij, për një vlerësim të vazhdueshëm të riskut, për rishikimin dhe rishqyrtimin rregullisht të kontrolleve respektivë. Në të gjitha sistemet, të cilat janë vlerësuar me nivel të lartë risku, auditimi është parashikuar të kryhet me një frekuencë më të shpeshtë.

Bazuar në faktorët e përmendur më sipër strukturat audituese gjatë vitit 2015 kanë vlerësuar me risk më të lartë sistemet në vijim:

1. Sisteme të tjera sipas qëllimit dhe misionëve të veçanta të institucioneve konsiderohen si sisteme ku risku i korrupsionit dhe mashtrimit është i pranishëm. Duke iu referuar të dhënave, raste të shumta që kapin shifrën e 1414 gjetje dhe në vlerë të konsiderueshme 65,690 milionë lekë ose në 95,5% të të gjitha gjetjeve i përkasin këtij sistemi. Në këtë sistem shuma 57,931 milionë lekë përfaqëson shumën e efekteve nga parregullsitë e konstatuara në lidhje me zbatimin e marrëveshjes së shitjes së aksioneve të OSSH, veprime financiare që i përkasin periudhës 2010 – 2013.
2. Sistemi i Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar është vlerësuar me risk të lartë dhe ka vijuar të jetë në fokus të objektivave të auditimit. Vlerësimet në këto sisteme kanë konsistuar jo vetëm thjesht në pajtueshmërinë me ligjet e rregullat por dhe vlerën e parasë së fondeve publike, pra në vlerësimin nëse fondet publike janë shpërndarë dhe përdorur për qëllimin që ato janë dhënë dhe deri në ç'masë është siguruar përdorimi i

tyre me dobi, kursim dhe frytshmëri, me 886 raste dhe e shprehur në përqindje gjetjet në këtë sistem kapin 3% të totalit të tyre ose 2,057 milionë lekë;

3. Sistemi i pagesave për personelin rezulton të ketë një nivel të konsiderueshëm risku që lidhet kryesisht me shmangie në zbatimin korrekt të procedurave ligjore të kërkuara për këtë qëllim, kontrole të pa mjaftueshme dhe jo eficiente, si dhe mosnjohja e legjislacionit të pagave kanë sjellë rritjen e rasteve të shkeljeve dhe pagesave të parregullta për personelin e subjekteve publike, me 565 raste e shprehur në vlerë gjetjet në këtë sistem kapin rreth 602 milionë lekë.
4. Sistemi i prokurimeve si fusha ku risku është i pranishëm. Duke iu referuar të dhënave, paraqiten me 462 raste të identifikuar me vlerë 168 milionë lekë;
5. Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore paraqitet me risk në mënyrë të veçantë për zbatueshmërinë e kuadrit ligjor në rekrutimin e stafit sa më profesional, në pajtueshmëri me kërkesat e vendit të punës, lëvizjen e pamotivuar të punonjësve. Një nga mangësitë kryesore të këtij sistemi është ndarja jo e qartë e roleve dhe përgjegjësive që tregon për dobësi në vetë sistemin e kontrollit të brendshëm, me 488 raste dhe në vlerë 111 milionë lekë.

Megjithatë konstatohet se, për subjekte të cilat janë konsideruar të kenë kompleksitet të lartë të veprimtarisë së tyre, vlerësimi i përgjithshëm i kontrollit të brendshëm ka çuar në gjykimin se niveli i riskut është i lartë dhe për këtë arsye audituesit e brendshëm kanë kryer auditime të të gjithë sistemeve. Në raste të tjera auditimet kanë konsistuar në vlerësimin e sistemeve të veçanta, të cilat janë vlerësuar të kenë edhe riskun më të lartë për periudhën.

4.2.3. Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm

Nga NJAB që funksionojnë në sektorin publik është kryer vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësitë publike brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore. Nga raportimet rezulton se sistemet e kontrollit të brendshëm pranë subjekteve të audituara, janë ngritur dhe funksionojnë, por nevojiten përmirësime të mëtejshme në menaxhimin dhe funksionimin e tyre. Për vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm audituesit janë përqendruar kryesisht në masat e kontrollit, në planet e organizimit, në metodat dhe procedurat për administrimin e mjeteve monetare e materiale që sigurojnë ndarjen e detyrave, verifikimin reciprok të punëve me qëllim parashikimin e tyre ose të paktën në zbulimin pa vonesë të anomalive, gabimeve dhe parregullsive në informacionet kontabile dhe financiare, shpërdorimet dhe dëmtimet, etj. Auditimi i sistemit të kontrollit të brendshëm është bërë jo për një kohë të caktuar dhe për persona të caktuar, por është vlerësuar si një proces i pandërprerë dhe i vazhdueshëm gjatë gjithë veprimtarisë, ku marrin pjesë të gjithë punonjësit e subjektit të audituar.

Gjatë këtij procesi janë vlerësuar të gjithë komponentët e kontrollit të brendshëm:

Për mjedisin e kontrollit

Baza ligjore dhe rregullat e vendosura për auditimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm janë të plota dhe garantojnë përmbushjen e objektivave. Një numër i konsiderueshëm prej 86 NJAB që kanë raportuar mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, vërejnë se kompetencat e kontrollit të brendshëm janë të identifikueshme dhe vlerësohen si të plota, si dhe janë miratuar rregulloret e brendshme, ku janë të përcaktuara më qartë kompetencat, detyrimet dhe përgjegjësitë e secilit, kryesisht në përgjegjësinë personale, zbatimin e ligjit, marrëdhëniet me subjektet.

Në rreth 20% të NJAB që funksionojnë në sektorin publik strukturat organizative të miratuara në shumë raste nuk kanë qenë të plotësuara, duke ndikuar shpesh edhe në ecurinë e punës. Në përgjithësi rregullat e Kodit të Etikës zbatohen nga personeli. Ndarja e detyrave dhe e kompetencave ka siguruar që të mos ketë konflikt interesi ndërmjet shkallës hiarkike dhe të drejtës së ushtrimit të kontrollit të gjithësecilit. Ekziston një përcaktim i drejtë i autoritetit dhe i përgjegjësisë. Ka trajnime dhe ecuri zhvillimi të burimeve njerëzore në drejtim të kryerjes me profesionalizëm të detyrave.

Për menaxhimin e riskut

Një ndër kushtet themelore për rritjen e efektivitetit të sistemeve të kontrollit dhe për përcaktimin e procedurave përkatëse është auditimi i bazuar në vlerësimin e riskut. Në rreth 60% të NJAB, gjatë auditimeve janë identifikuar, vlerësuar, analizuar dhe menaxhuar risqet dhe janë vlerësuar pengesat në arritjen e objektivave, duke i parë risqet si një element i rëndësishëm gjatë kryerjes së aktiviteteve të institucioneve dhe duke forcuar bashkëpunimin me strukturat e tjera të njësisve publike.

Për aktivitetin e kontrollit

Gjatë auditimeve është vlerësuar se nga ana e drejtuesve të subjekteve të audituara ka vend për përmirësime. Në lidhje me efektivitetin e aktiviteteve të kontrollit, së pari kërkohet një ndërthurje mes kontrolleve para faktit, kontrolleve pas faktit dhe kontrolleve menaxheriale, së dyti ato duhet të jenë të përshtatshme, efektive, të gjithanshme, të dokumentuara qartë dhe në përputhje me planin e zbatimit të tyre për një periudhë të caktuar.

Vlerësojmë se burimet janë përdorur dhe përdoren në mënyrë ekonomike dhe eficiente në procesin e realizimit të objektivave. Masat e ndërmarra nuk kanë qenë të mjaftueshme për të adresuar riskun dhe pengesat në arritjen e objektivave.

Për informimin dhe komunikimin

Nga analiza e kryer vlerësojmë se komunikimi, ashtu edhe raportimi në njësitë publike janë në nivel të mirë dhe sigurojnë informacionin e duhur, në kohë për të gjithë nivelet e drejtimit. Gjithashtu funksionon një sistem raportimi, i cili garanton këtë nivel të informimit dhe të komunikimit. Sistemi i informacionit financiar dhe i drejtimit është në pajtim me synimin për të sjellë raportime të nevojshme për arritjen e detyrave. Është kuptuar roli i gjithësecilit në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe se veprimet individuale reflektojnë tek puna e të gjithë stafit.

Për monitorimin

Sistemet e kontrollit të brendshëm janë në monitorim të vazhdueshëm nga NJAB, për të vlerësuar cilësinë e sistemeve të ekzekutimit në kohë të detyrave dhe arritjen e objektivave të njësisve publike. Efektiviteti i këtyre sistemeve qëndron në faktin se ato japin informacion të saktë, të detajuar për çdo fazë të punës, duke krijuar mundësinë e monitorimit në çdo kohë.

Megjithë përmirësimet gjatë këtij viti në funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm të ngritura në njësitë publike, janë evidentuar dhe disa dobësi, si më poshtë:

- Moszbatim i rregullave ligjore dhe procedurale për administrimin e vlerave materiale dhe monetare, në ruajtjen e aseteve, në kontabilizimin dhe regjistrimin e veprimeve në mbështetje të dokumenteve justifikues;
- Kryerje e operacioneve financiare mbi bazën e autorizimeve e dokumentave justifikuese jo të plota;
- Mos ushtrim të kontrollit rigoroz mbi zbatimin e procedurave operacionale në çdo hallkë të tij;
- Mos përcaktim në mënyrë të drejtë e të saktë të detyrave, përgjegjësive dhe funksioneve të punonjësve në rregulloren e brendshme apo përkrahimin e vendit të punës;
- Zbatimin si duhet të kontrolleve të brendshme, pasi nuk njihet kuadri ligjor nga strukturat (ndryshimi i shpeshtë i stafit);
- Ndarjen jo e qartë të detyrave, për eliminimin e mbivendosjeve, konfliktit të interesit dhe mos zbatimit të procedurave ligjore.

4.2.4. Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë

Rishikimi dhe vlerësimi brendshëm i cilësisë për materialet e auditimit duhet të realizohet nga audituesit me përvojë ose nga drejtuesi i NJAB, konform kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në Manualin e auditimit të brendshëm.

Nga shqyrtimi i sigurimit të cilësisë të praktikave të auditimit, rezulton se përgjithësisht ato janë konform standardeve dhe praktikave profesionale të auditimit, konkretisht: janë dhënë opinione profesionale të mbështetura në gjykime objektive, si dhe raportet e auditimit janë përgatitur me kompetencë e profesionalizëm. Gjithnjë mbetet prioritet përmirësimi i cilësisë dhe zbatimi i plotë standardeve të auditimit, në këtë drejtim.

Vihet re se në 28 NJAB që funksionojnë me një dhe dy auditues, ky proces nuk arrin të realizohet. Këta auditues nuk mund të rishikojnë dhe vlerësojnë punën e tyre, ky vlerësim duhet të realizohet nga drejtuesi i NJAB, i cili në këto njësi mungon. Kjo bën që angazhimet e auditimit të kryera në këto njësi të mos sigurojnë vlerësim të brendshëm të cilësisë.

4.2.5. Gjetjet e auditimit të brendshëm

Në ushtrimin e funksionit të tyre, strukturat e auditimit kanë nxjerrë në pah hallkat më të dobëta dhe jo funksionale të sistemit, të cilat kanë sjellë dhe pasojat e tyre negative në përdorimin me dobi, kursim dhe frytshmëri të fondeve publike. Gjetjet kryesore të rezultuara nga kjo veprimtari lidhen kryesisht me mosfunksionim siç duhet të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në fushën e investimeve publike, në fushën e prokurimeve, sistemin e pagave, ngritjen e strukturave dhe rekrutimin e audituesve të brendshëm, etj, ku më kryesoret përmendim gjetjet:

- Në fushën e shitjeve të aseteve publike dhe menaxhimit të fondeve. Bazuar në raportimet e dërguara nga njësitë e auditimit, rezulton se ka pasur probleme me menaxhimin e fondeve dhe pasurive në institucione;
- Në sistemet e kontabilitetit dhe raportimit financiar, të cilat konsistojnë në gabime materiale në regjistrimin e transaksioneve të rëndësishme, shmangie nga standardet e miratuara, apo pasqyrim jo të saktë dhe korrekt të situatës financiare në deklaratat financiare.
- Në fushën e zbatimit të akteve ligjore, deri në moszbatim apo keqinterpretim të ligjeve ose akteve nënligjore;
- Në fushën e auditimit të brendshëm konstatohet se ngritja dhe funksionimi i strukturave të auditimit të brendshëm vijon të ketë probleme. Niveli relativisht i ulët i ndërgjegjësimit të menaxhimit të lartë ndaj rolit të auditimit të brendshëm ka shkaktuar në disa raste ushtrimin jo në përputhje të plotë të këtij funksioni me standardet ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor të vendit. Në vijim, vështirësi janë konstatuar edhe në mbështetjen e punës audituese apo sigurimin e kapaciteteve dhe burimeve të nevojshme. Këto probleme hasen më shumë në pushtetin vendor;
- Një numër i konsiderueshëm prej më shumë se 8% të vendeve vakante (të pa plotësuar) në strukturat e NJAB, rekrutimi i punonjësve të pacertifikuar, pa njohuritë dhe eksperiencën profesionale të kërkuar, kanë ndikuar në funksionimin e strukturave audituese.

Të dhënat numerike mbi rastet e konstatuara të parregullsive financiare, si dhe ndikimi që ato kanë pasur në buxhetin e subjekteve të audituara në mënyrë të përmbledhur jepen në tabelën e mëposhtme:


Tabela 10. Gjetjet sipas sistemeve, viti 2015

Nr.	Sistemet	Gjetje (në numër)	Gjetje në vlerë (në 000/lekë)
1	Menaxhimi Burimeve Njerëzore	488	110,756
2	Programim Zbatim Buxheti	371	160,378
3	Sistemi i Pagesave	565	602,318
4	Sistemi i Prokurimeve	462	168,226
5	Sistemi i Kontabilitetit & Rap.Financiar	886	2,056,887
6	Sisteme të tjera sipas qëllimit dhe misionit të njësisve publike	1414	65,690,480
Totali		4186	68,789,045

Vërehet se nga auditimet e kryera janë konstatuar 4,186 raste të shkeljeve, për të cilat gjetjet llogariten në 68,789 milionë lekë.

Në grafikun 11 tregohet në mënyrë të qartë se gjatë vitit 2015, sisteme të tjera sipas qëllimit dhe funksionit të institucionit dhe sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar kanë pasur gjetjet me vlerë më të madhe të shkeljeve të konstatuara.

Grafiku 11. Niveli i gjetjeve për vitet 2012 - 2015



Siç shihet, sistemeve me risk më të lartë i përkasin dhe gjetjet dhe problematikat kryesore që kanë dalë si rezultat i auditimeve të kryera gjatë këtij viti.

4.2.6. Rekomandimet e AB

Titullarëve të njësive publike u nevojitet të marrin rekomandime sa më efikase, në lidhje funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe vlerësimin e riskut, për një mirëqeverisje të njësive publike. Në këtë këndvështrim audituesit e brendshëm, duhet të japin rekomandime sa më të zbatueshme dhe që i shtojnë vlerë subjektit të audituar.

Ndër rekomandimet më kryesore të dhëna nga NJAB gjatë vitit 2015 mund të përmendim:

1. Rekomandime që lidhen me përmirësimin e proceseve të vendimmarrjes të politikave, të procedurave dhe hartimit të strategjive, të cilat i ndihmojnë organizatat publike për përcaktimin sa më real të prioriteteve dhe objektivave vjetore, afatmesëm dhe afatgjatë.
2. Rekomandime për përmirësimin e proceseve të implementimit të politikave, kuadrit ligjor e procedural të brendshëm e të jashtëm që drejton veprimtarinë e njësive publike.
3. Rekomandime për përmirësimin e srukturave organike, në funksion të rritjes së dhe efektivitetit të punës;
4. Rekomandime për përmirësimin e elementeve të sistemit të kontrollit të brendshëm me qëllim që të sigurohet përdorimi me efektivitet, ekonomi dhe eficiencë i fondeve publike;
5. Rekomandime që lidhen me ndreqjen e parregullsive, parandalimin e shpërdorimeve, shkeljeve dhe ruajtjen e asetëve publike;
6. Rekomandime që lidhen me zhvillimin e vijueshëm profesional të punonjësve në njësitë publike dhe sidomos stafit që punon në strukturat e menaxhimit financiar.

Tabela e mëposhtme jep informacion mbi shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve sipas prioritetit të tyre. Konstatohet se treguesi për zbatimin e rekomandimeve është pozitiv, pasi ato janë pranuar 100% dhe zbatueshmëria e tyre është në masën 52%, pjesa tjetër është në proces zbatimi.

Është e njohur që përgjegjësia e zbatimit të rekomandimeve rëndon mbi vetë drejtuesit e subjekteve të audituara, por nga ana tjetër përgjegjësia e auditimit të brendshëm nuk kufizohet vetëm në dhënien, por dhe në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, pasi dhe rezultatet e punës audituese varen në një masë të madhe nga ky faktor.

Tabela 11. Zbatimi i rekomandimeve për vitin 2015

Llojet e rekomandimeve sipas prioriteteve					
Prioritet i lartë		Prioritet i mesëm		Prioritet i ulët	
Pranuar	Zbatuar	Pranuar	Zbatuar	Pranuar	Zbatuar
3439	1669	2837	1559	1183	607


Nëse auditimi i brendshëm do të luajë një rol pasiv, i cili do të konsistonte thjesht në dhënien e rekomandimeve të paqarta dhe të pa aplikueshme, atëherë nuk do të kishim përbushje të misionit dhe objektivave të tij strategjikë, pra për vlerë të shtuar të subjektit të audituar apo përmirësim të veprimitarisë së tij. Për këtë arsye, vlerësimi i veprimitarisë së strukturave të auditimit nuk është kufizuar vetëm në paraqitjen e propozimeve për masa dhe rekomandimet e dhëna, por ka konsideruar si tregues të rëndësishëm edhe shkallën e zbatimit të këtyre rekomandimeve.

Këto rekomandime i referohen gjetjeve të konstatuara dhe kanë synim përmirësimin e sistemeve përkatëse, uljen e nivelit të riskut në këto sisteme dhe dhënien e këshillave për zgjidhje që mundësojnë parandalimin e rasteve të shkeljeve në të ardhmen.

Nga analiza e veprimitarisë së njërive të auditimit të brendshëm konstatohet se vazhdojnë përpjekjet e audituesve për rritjen e cilësisë së rekomandimeve të lëna për zbatim. Të dhënat e mësipërme tregojnë se pranimi i rekomandimeve dhe niveli i zbatimit të tyre janë rezultat i përmirësimit të cilësisë së punës së vetë audituesve. Gjithashtu, kjo shoqërohet me një kuptim më të drejtë të menaxhimit të subjekteve të audituara mbi vlerën dhe përfitimet e auditimit të brendshëm.

Në grafikun 12, jepet një pasqyrim i nivelit të rekomandimeve sipas prioriteteve gjatë katër viteve të fundit.

Grafiku 12. Niveli i rekomandimeve 2012-2015 (në numër) dhe zbatimi i rekomandimeve viti 2015



Përpjekjet e auditimit për të përmirësuar punën në drejtim të zbatueshmërisë së rekomandimeve gjatë vitit 2015 reflektohen edhe në planifikimin dhe kryerjen e auditimeve të veçanta për ndjekjen e tyre. Planifikimi dhe më pas kryerja e angazhimeve për të verifikuar ndjekjen e rekomandimeve, ka ndikuar ndjeshëm në sigurimin e informacionit mbi vazhdueshmërinë dhe vlerën e auditimeve.


4.3. Vetëvlerësimi i Njësive të Auditimit të Brendshëm

Raportet e veprimitarisë së njësive të auditimit të brendshëm për vitin 2015, janë shoqëruar dhe me Pyetësin e vetëvlerësimit të NJAB, të miratuar me Udhëzimin nr.89, datë 28.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për monitorimin e performancës së njësive publike". Nga 103 NJAB të cilat funksionojnë në sektorin publik, këtë pyetësor e kanë plotësuar 86 NJAB.

Analiza e Pyetësorit të vetëvlerësimit fokusuar në katër grupime pyetjesh, përkatësisht:

- Pyetje që kanë lidhje me funksionimin e NJAB sipas akteve ligjore;
- Pyetje që kanë lidhje me identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve;
- Pyetje që kanë lidhje me planin e veprimit dhe monitorimin e rekomandimeve;
- Pyetje që kanë lidhje me raportimin e veprimtarisë audituese.

Grafiku 13. Funksionimi i NJAB sipas akteve ligjore



NJAB në sektorin publik duhet të funksionojnë në përputhje me bazën ligjore dhe nënligjore në fuqi, e cila është e bazuar në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm. NJAB e ngritura në sektorin publik duhet të përbëhen minimalisht nga tre auditues. Ky kriter nuk është i plotësuar nga një pjesë e NJAB dhe kjo sjell si pasojë edhe mosfunksionimin si duhet të tyre. Nga analiza e të dhënave 80% e NJAB janë ngritur dhe funksionojnë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, pra e përmbushin këtë kriter.


Çdo NJAB ka detyrimin ligjor të hartojë dhe përmirësojë herë pas here Kartën e Auditimit të Brendshëm (KAB). Sipas Manualit të auditimit të brendshëm, çdo njësi duhet të miratojë KAB dhe herë pas here ta rishikojë atë. KAB përcakton statusin organizativ të NJAB, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e NJAB. Nga të dhënat e konsoliduara shihet se 71% e NJAB i kanë KAB të miratuara dhe që i përmbushin kriteret.

NJAB duhet të përfshijnë në aktivitetin e tyre të gjithë fushat e përgjegjesisë shtetërore të njësisë publike që përfaqësojnë. Nga analiza e të dhënave ka rezultuar që 73% e NJAB përfshijnë në veprimtarinë e tyre gjithë aktivitetin e njësisë publike. Problematika më e madhe në këtë fushë janë veprimtaria audituese e një numri të konsiderueshëm të NJAB në ministritë e linjës, të cilat nuk programojnë auditimin e aparateve të ministrive si subjekte me risk të lartë, dhe si shpenzuese të vlerave të konsiderueshme monetare.

Roli i auditimit të brendshëm është të ndihmojë njësinë publike në arritjen e objektivave. Objektivat e NJAB gjithnjë duhet të jenë në përputhje me objektivat e njësisë publike. Nga analiza e të dhënave, vihet re se 73% e NJAB i kanë objektivat e tyre në përputhje me objektivat e njësisë publike.


Është detyrë e NJAB që në procesin e planifikimit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e njësisë publike. Në bazë të këtij identifikimi dhe vlerësimi organizohet puna që njësitë e identifikuar me risk të lartë të përfshihen në planin vjetor të auditimit. Nga analiza e përgjigjeve të NJAB, rezulton që 54% e tyre e bazojnë planin e auditimit në vlerësimin e riskut të veprimtarisë së njësisë publike.

Grafiku 14. Identifikimin, vlerësimi dhe menaxhimi i risqeve



Në lidhje me identifikimin dhe vlerësimin e drejtë nga NJAB të risqeve që lidhen me objektivat, kemi pothuajse të njëjtën situatë, 57% e NJAB procesi i identifikimit dhe vlerësimit të riskut mbulon të gjitha fushat e auditimit.


Grafiku 15. Plani i veprimit dhe monitorimi i rekomandimeve



Plani i veprimit është një dokument i rëndësishëm përmbyllës i një angazhimi auditimi, i cili hartohet nga pala e audituar dhe miratohet nga titullari i njësisë publike të audituar. Afatet e zbatimit të rekomandimeve diskutohen paraprakisht për të qenë sa më konciz dhe të saktë, që parregullsitë e vërejtura të mos përsëriten. Nga të dhënat e analizuar 64% e NJAB përmbushin këtë kriter, pra hartimi i planit të veprimit kryhet nga pala e audituar, diskutohet dhe miratohet nga titullari i njësisë dhe i dërgohet zyrtarisht NJAB.

Vihet re se, përgjigjet në lidhje me përputhshmërinë e rekomandimeve me gjetjet përkatëse dhe monitorimin e tyre rezultatet janë pozitive, 83% dhe 70% të NJAB rekomandimet i kanë të lidhura me gjetjet dhe i monitorojnë ato vazhdimisht.

Grafiku 16. Raportimi i veprimtarisë audituese



Manuali i auditimit të brendshëm ka një procedurë të qartë në lidhje me raportimin e angazhimit të auditimit. Vihet re se 77% e NJAB përgatisin dhe dërgojnë raportin e auditimit në përputhje me kërkesat e Manualit të auditimit të brendshëm.

Dosja e një angazhimi auditimi duhet të plotësohet me përpikmëri me të gjitha letrat e punës si: programi i angazhimit, dokumentet justifikues të gjetjeve, projekt-raporti, vërejtjet e palës së audituar, raporti final, etj. Nga të dhënat e konsoliduara vihet re se 87% e NJAB i bashkëngjisin në dosje vërejtjet e subjektit të audituar.

Pas plotësimit të dosjeve të auditimit sipas përcaktimeve të Manualit të auditimit të brendshëm, ato arkivohen sipas akteve ligjore në fuqi. Nga analiza e përgjigjeve vihet re se 66% e NJAB kryejnë arkivimin e dosjeve të përhershme sipas akteve ligjore në fuqi, pjesa tjetër e NJAB dhe institucionet përkatëse i duhet të marrin masat për përmbushjen e këtij kriteri sipas akteve ligjore në fuqi.

Nga analiza në tërësi e Pyetësorit të vetëvlerësimit, vihet re që në masë të konsiderueshme NJAB kanë qenë të qarta dhe koncize në përgjigjet e tyre. Të dhënat tregojnë që përgjigjet e dhëna janë shumë afër të dhënave reale, të cilat ne i kemi analizuar nga raportet vjetore të veprimtarisë së NJAB.

Në lidhje me problematikat e konstatuara në këtë analizë, kërkohet një koordinim më i madh i informacionit mes DH/AB dhe NJAB për funksionimin e shërbimit të auditimit të brendshëm në përfaqësim të plotë me standardet ndërkombëtare.

KAPITULLI V- AKTIVITETET E DH/KBFP PËR VITIN 2015 DHE PLANI NË VIJIM SIPAS STRATEGJISË SË MFP 2014 - 2020

Në kuadër të realizimit të objektivave të caktuara në planin vjetor të drejtorisë gjatë vitit 2015, në përputhje me strategjinë MFP, DH/KBFP ka zhvilluar një sërë aktivitetesh me fokus elementet e MFK dhe AB. Këto aktivitete janë realizuar në bashkëpunim me ekspertët e Projektit të binjakëzimit dhe me aktorë të tjerë të sektorit publik. Në sajë të këtyre aktiviteteve u përmirësua baza ligjore, u rrit ndërgjegjësimi rreth koncepteve të MFK dhe AB, si dhe u përmirësuan komponentët e menaxhimit financiar në institucionet publike. Aktivitetet e zhvilluara janë si më poshtë:

Aktivitetet e DH/MFK gjatë vitit 2015

1. Hartimi i ndryshimeve dhe miratimi i ligjit nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “ Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Ndryshimet ligjore u përqendruan kryesisht në saktësimin e disa terminologjive dhe përgjegjësi të nëpunësit autorizues dhe zbatues.
2. Hartimi i akteve nënligjore në plotësim të kuadrit ligjor për MFK, ku përmendim: Urdhri i Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për monitorimin e performances së njësive publike”, Udhëzimi nr. 33, datë 28.12.2015, “Për mbylljen e llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2015”
3. Përmirësimi i kapaciteteve të stafit menaxherial të NJQP, në lidhje me risitë e kuadrit ligjor të MFK dhe konceptin e përgjegjshmërisë menaxheriale nëpërmjet trajnimeve, ndihmës dhe konsultimeve me stafin e DH/MFK.
4. Gjatë vitit 2015, u organizuan dy kurse të plota trajnime në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike me tema:
 - Koncepti i përgjegjshmërisë menaxheriale;
 - Menaxhimi i riskut;
 - Gjurma e auditit dhe lista e proceseve.

Në këto trajnime morën pjesë përfaqësues nga njësi të qeverisjes qendrore dhe u trajnuan rreth 71 pjesëmarrës.

5. Gjatë kësaj periudhe DPHKBFP në bashkëpunim me ekspertët e projektit kanë realizuar këto aktivitete:
 - Hartimi i Draft-Udhëzimit për Nëpunësit Zbatues;
 - Hartimi i Draft-Udhëzimit për Koordinatorin e MFK dhe Koordinatorin e Riskut;
 - Rishikimi dhe miratimi i Pyetësorit të vetëvlerësimit për MFK dhe Auditin e Brendshëm;
 - Rishikimi i Manualeve të MFK dhe AB;
 - Rishikimi i Raportit mbi Funkionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme;
 - Mbyllja e ciklit të MFK në institucionet pilote;
 - Organizimi i tre seminareve të ndërgjegjësimit lidhur me rëndësinë e zbatimit të MFK përkatësisht një me Sekretarët e Përgjithshëm të ministrive të linjës dhe nivelin e lartë të Ministrisë së Financave (gjithsej 30 pjesëmarrës), dhe dy në nivel lokal ku kanë qënë të ftuar të marrin pjesë kryetarët e Bashkive(Nëpunësit Autorizues), drejtuesit e Financës(Nëpunës Zbatues) dhe një Drejtor i Politikave që është i lidhur më shumë me çështjet e MFK (gjithsej 74 pjesëmarrës);
 - Përfundimi i trajnimeve të Nëpunësve Zbatues në nivel qendror dhe atë lokal, si dhe të stafit të Ministrisë së Financave lidhur me instrumentin e Raportimit Financiar (gjithsej rreth 45 pjesëmarrës duke përfshirë edhe stafin e Ministrisë së Financave);
 - Përfundimi i dizenjimit të checklist-ës për pasqyrimin e problemeve të evidentuara nga vizitat në terren nga specialistët e DH/MFK, si dhe të rekomandimeve për përmirësimet e mundshme në të ardhmen në fushën e MFK;

- Trajnimi i vijueshëm i audituesve të brendshëm;
 - Organizimi i vizitave studimore në Austri dhe Francë, si dhe dy intership-eve po në të njëjta vende për stafin e DPHKBFP.
6. Vlerësimi dhe rankimi i 16 ministrive të linjës dhe 11 bashkive kryesore mbi bazën e treguesve të performancës.
 7. Vazhdoi monitorimi në vazhdimësi i përputhshmërisë së statusit të nëpunësve zbatues të çdo niveli në njësitë e qeverisjes së përgjithshme me kërkesat e nenit 12, të ligjit nr. 10296/2010 të MFK, i ndryshuar dhe ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”. Për këtë qëllim janë kontrolluar institucionet rast pas rasti duke u konfirmuar/refuzuar nëpunës zbatues që nuk plotësonin kërkesat e arsimimit dhe njëkohësisht janë dhënë rekomandime për rishikime të strukturave të financave aty ku është konsideruar e mundshme.

Më poshtë jepen masat që parashikohen të ndërmerren në fushën e MFK për vitin 2016:

1. Hartimi i udhëzimit të drejtuesit të financave të njërive publike për përcaktimin e strukturës organizative dhe funksionit të Nëpunësit Zbatues.
2. Hartimi i udhëzimit mbi koordinatorin e menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe koordinatorin e riskut.
3. Monitorimi në vazhdimësi i procesit të caktimit të nëpunësve zbatues në çdo nivel në NJQP, me qëllim përmbushjen e kriterëve ligjore dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e strukturave.
4. Përmirësimi i procesit të menaxhimit të riskut dhe hartimit të strategjisë së riskut në njësitë qendrore dhe vendore në përputhje me aktet e reja nënligjore të MFK, nëpërmjet asistencës së vazhdueshme të institucioneve dhe trajnimeve në shkallë të gjerë. Fokusi do të jetë në ngritjen e sistemeve të menaxhimit të riskut në këto institucione. Vazhdimi i bashkëpunimit me Kontrollin e Lartë të Shtetit, për të pasur objekt të punës së tyre dhe kërkesat e ligjit të MFK, duke u fokusuar më shumë në menaxhimin e riskut (praktikë që tashmë ka filluar).
5. Bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, për zbatimin e kërkesave të Udhëzimit nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, për dërgimin nga NJQQ, të formularit që lidhet me identifikimin dhe kostimin e risqeve për objektivat e paraqitura.
6. Bashkëpunimi në vazhdimësi me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) për realizimin e trajnimeve të planifikuara me tematikë “Konceptet e MFK me fokus përgjegjshmëria menaxheriale”, “Menaxhimi i riskut” dhe “Procedurat për përgatitjen e hartës së proceseve dhe gjurmës së auditit”, me grupe të ndryshme interesi të institucioneve publike.
7. Organizimi i një ëorkshop-i me titullarët e institucioneve qendrore dhe vendore për rritjen e ndërgjegjësimit mbi kontrollin e brendshëm.
8. Zgjedhja e institucioneve të reja pilot, për të vazhduar implementimin e MFK, sipas eksperiencës së fituar nga Projekti i binjakëzimit.
9. Rishikimi dhe botimi i Manuali të MFK
10. Analizat e kryera nga DH/MFK dhe rekomandimet për çdo Ministri linje dhe Kryeministrinë, do t'i dërgohen secilit titullar, për të reflektuar mbi përmirësimin e punës në të ardhmen.

Aktivitetet e DH/AB gjatë vitit 2015

Gjatë vitit 2015 DH/AB ka patur si objektiva kryesorë:

- Planifikimin dhe raportimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik;

- Zhvillimin e një procesit të certifikimit dhe trajnimit të vijueshëm profesional sa më cilësor;
- Përgatitjen e ndryshimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e auditimit të brendshëm.

Me synim arritjen e objektivave të sipërcituar, veprimtaria e DH/AB u fokusua në:

- Përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore:

Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Ky ligj përcaktoi role dhe përgjegjësi të qarta për titullarët e njësive publike dhe audituesit e brendshëm, në veprimtarinë audituese, si dhe Ministrinë e Financave si koordinuese dhe bashkërenduese e kësaj veprimtarie. Në zbatim të këtij ligji janë përmirësuar, si dhe janë në proces përmirësimi aktet nënligjore të mëposhtme:

1. Hartimi i Kodit të Etikës së audituesve të brendshëm, i miratuar me Urdhrin e ministrit të Financave nr.86, datë 10.12.2015 “Për miratimin e Kodit të Etikës për audituesit e brendshëm në sektorin publik”. Ky kod është i bazuar në Kodin e Etikës të Institutit të Audituesve të Brendshëm (IIA)³ dhe përcakton parimet që rregullojnë sjelljen e audituesve të brendshëm në kryerjen e shërbimit të auditimit në njësitë publike;
2. Vendimi “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i cili është miratuar nga Këshilli i Ministrave në muajin shkurt të vitit 2016. Ky vendim përcakton kriteret e qarta për krijimin e njësive të auditimit në sektorin publik (buxhetin dhe numrin e punonjësve të institucionit dhe përbërjen e njësisë së auditimit), si dhe synon eliminimin e mbivendosjeve në procesin e auditimit;
3. Vendimi “Për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjen e Komisionit të Kualifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit”, është miratuar nga Këshilli i Ministrave në muajin shkurt të vitit 2016. Ky vendim përcakton kriteret dhe rregullave të qarta mbi mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjes së Komisionit të Kualifikimit të audituesve të brendshëm dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit që do të aplikohen në procesin e certifikimit dhe trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm;
4. Vendimi “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të brendshëm në njësitë publike”, është miratuar nga Këshilli i Ministrave në muajin mars të vitit 2016. Ky vendim përcakton mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komiteteve të Auditimit të Brendshëm, me qëllim rritjen e pavarësisë funksionale të veprimtarisë së strukturave të auditimit të brendshëm në sektorin publik dhe i vjen në ndihmë titullarëve të njësive publike në përmbushjen e objektivave të vendosura;
5. Urdhëri i “Rregullores për trajnimin e vijueshëm profesional për audituesit e brendshëm në sektorin publik”, është miratuar me urdhër të ministrit të Financave, në janar të vitit 2016. Kjo rregullore përcakton rregulla të qarta mbi programimin, organizimin, administrimin dhe dokumentimin e procesit të trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik, si dhe rolin e marrëdhëniet e Komisionit të Kualifikimit, strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, audituesve të brendshëm në detyrë dhe trajnerëve;
6. Urdhëri i “Rregullores për procedurat e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik”, është miratuar me urdhër të ministrit të Financave, në muajin mars të vitit 2016. Kjo rregullore është hartuar në bashkëpunim me ekspertë të SIGMA dhe përcakton rregulla të qarta mbi programimin, organizimin, administrimin dhe dokumentimin e procesit të certifikimit të audituesve të brendshëm, si dhe rolin e marrëdhëniet e Ministrit të Financave, Nënpunësit të Parë Autorizues, Komisionit të Kualifikimit të audituesve të brendshëm, strukturës përgjegjëse për harmonizimin e

³ IIA është institucion ndërkombëtar me qendër në SHBA, i cili përcakton standardet e aplikueshme në fushën e AB.

auditimit të brendshëm, audituesve të brendshëm të pacertifikuar, trajnerëve dhe mbikëqyrësve.

- Certifikimi i Audituesve të Brendshëm

DH/AB-ja ka vijuar veprimtarinë për organizimin dhe administrimin e procesit të certifikimit të audituesve të brendshëm publik, si produkt bashkëpunimi midis DH/AB dhe Komisionit të Kualifikimit të audituesve të brendshëm.

Në vijim të Urdhërit nr.65, datë 22.07.2014, të Ministrit të Financave, gjatë sezonit 2014-2015, DH/AB realizoi me sukses procesin e certifikimit të 80 kandidatëve, të cilët iu nënshtruan një procesi intensiv cikli leksionesh në 2 module nga 4 module gjithsej, (2 module të zhvilluara gjatë vitit 2014), me tema të cilat kanë patur si synim të japin njohuritë e mjaftueshme, teorike e praktike për kryerjen e shërbimit të auditimit.

Sezoni i certifikimit u programua nga DH/AB të zhvillohej në dy periudha:

Cikli i parë i leksioneve është zhvilluar nga muaji tetor deri në muajin dhjetor 2014, periudhë gjatë së cilës kandidatët morrën njohuritë bazë në dy module, si: "Legjislacion" dhe "Kontabilitet".

Cikli i dytë i leksioneve është zhvilluar nga muaji janar deri në muajin mars 2015, periudhë gjatë së cilës kandidatët morën njohuritë bazë në dy modulet e tjera, si: "Qeverisja dhe Kontrolli i Brendshëm" dhe "Auditimi i Brendshëm".

Gjatë të gjithë këtij procesi, kujdes i veçantë është treguar në zhvillimin sa më korrekt të programit të certifikimit, i cili është hartuar me objektivin për të ndihmuar audituesit e brendshëm të sektorit publik në rritjen e njohurive dhe aftësive të tyre.

Në fund të procesit u certifikuan si "Auditues të brendshëm në sektorin publik" 71 kandidatë, nga 80 kandidatë të regjistruar ose 88.7% e numrit fillestar të pjesëmarrësve, fakt që tregon për menaxhim të kujdesshëm të procesit dhe seriozitet në kontrollin e përvetësimit të dijeve dhe aftësive profesionale të kandidatëve.

Si përfundim, për periudhën 2005-2015, sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Financave, rezulton se janë certifikuar gjithsej 1872 auditues të brendshëm në sektorin publik, të cilët janë të regjistruar në "Regjistrin Kombëtar të audituesve të brendshëm në sektorin publik".

Me qëllim eliminimit të mangësive dhe problemeve të hasura në proceset e mëparshme të certifikimit, është përgatitur procesi i ri i certifikimit, për të cilin është rishikuar e tërë baza ligjore dhe nënligjore. Programi i certifikimit do të përbëhet nga 7 module (1 modul specifik dhe 6 module bazë), të cilat do të zhvillohen të alternuara me vetëstudim nga ana e kandidatëve dhe me konsulta të herë pas herë me trajnerët. Modulet bazë janë përgatitur me mbështetjen e ekspertëve të SIGMA, në mënyrë që në këtë proces të përgatiten kandidatë sa më të zhvilluar nga ana profesionale.

- Trajnimi i vijueshëm profesional

Trajnimi i vijueshëm profesional për vitin 2015 u organizua bazuar në Urdhrin e ministrit të Financave nr.104, datë 19.12.2014 "Për miratimin e programit të trajnimit të vijueshëm profesional për audituesit e brendshëm në sektorin publik për vitin 2015".

Ky program u hartua bazuar në analizën e nevojave për trajnim të identifikuar nga drejtuesit e auditimit në 103 NJAB. Njëkohësisht, u mbajtën në konsideratë dhe analiza e kërkesave individuale për trajnim të audituesve të brendshëm të identifikuar në formularët e vlerësimit të trajnimeve të mëparshme, si dhe kërkesat e paraqitura nga intervistat sporadike me audituesit, gjatë zhvillimit të fazave të trajnimit. Trajnimi për vitin 2015 u konceptua në 3 module, sipas grupeve të synuara (periudha mars-nëntor). Konkretisht:

- Në modulën e I-rë, u përfshinë drejtuesit e NJAB;
- Në modulën e II-të, u përfshinë audituesit me përvojë mbi 3 vjet në fushën e auditimit;
- Në modulën e III-të, u përfshinë audituesit e rinj në detyrë, me më pak se 3 vite përvojë pune në profesion.

Përgatitja e moduleve dhe zhvillimi i trajnimit, u krye nga ekspertë të Projektit të binjakëzimit Austriako-Francez “Implementimi i një sistemi modern të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Inspektimi Financiar në Shqipëri”, i financuar nga fondet IPA 2012. Trajnimi u realizua sipas programit dhe kalendarit të miratuar, duke ofruar tek audituesit njohuri bashkëkohore, me qëllim që audituesit të jenë në gjendje të zhvillojnë dhe të ruajnë aftësitë dhe përvojën e nevojshme për ushtrimin e funksionit të tyre.

Për të siguruar që trajnimi të jetë sa më i dobishëm dhe frytdhënës, metodologjia e trajnimit u orientua si drejt teorisë, po ashtu dhe praktikës, duke marrë në konsideratë mjedisin aktual me të cilin përballet stafi i njësive publike, në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK) dhe fushën e auditimit të brendshëm. Për të arritur këtë qëllim, ekspertët e projektit përzgjedhën trajnerë me eksperiencë akademike, si dhe ekspertë e profesionistë me eksperiencë praktike në të dyja mjediset, atë të MFK-së dhe të auditimit. Për më tepër rastet studimore, puna në grupe, si dhe eksperiencat profesionale të ekspertëve nga vende të ndryshme evropiane, vlerësohen që kanë patur një efekt pozitiv në procesin e përditësimit të njohurive të audituesve.

Nga 360 auditues të brendshëm të planifikuar, këtë program trajnimi e përfunduan me sukses 349 auditues të brendshëm të punësuar (nga të cilët 85 drejtues të njësive të auditimit të brendshëm dhe 264 auditues). Të dhënat e audituesve të trajnuar ndër vite paraqiten në tabelën në vijim:

Tabela 12. Të dhënat e audituesve të trajnuar

Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
Plan/Fakt	Plan/Fakt	Plan/Fakt	Plan/Fakt
0/0	328/80	388/280	360/349

Nga analiza e të dhënave, vihet re se trajnimi i vijueshëm profesional, ka pësuar rritje nga viti në vit, si në numrin e audituesve të brendshëm të trajnuar, ashtu dhe në cilësinë e temave të trajtuara. Gjatë dy viteve të fundit, duke marrë në konsideratë dhe rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë, fokusi kryesor i punës së DH/AB ka qenë përditësimi i njohurive dhe rritja e vazhdueshme profesionale e audituesve të brendshëm në sektorin publik.

Në përfundim të çdo faze trajnimi, janë analizuar formularët e vlerësimit të cilësisë për të gjithë komponentët e trajnimit dhe çdo pjesëmarrës ka shprehur opinionin tij lidhur me: organizimin e procesit, metodave dhe materialeve të trajnimit, profesionalizmin e trajnerëve, mjedisin e trajnimit, etj.

Përmirësimet dhe mangësitë e konstatuara në veprimtarinë e auditimit të brendshëm gjatë vitit 2015

Në vlerësimin e DH/AB, përmirësimet e vërejtura në veprimtarinë e auditimit të brendshëm, gjatë vitit të kaluar janë në drejtim të:

- ndërgjegjësimin në rritje, si nga ana e strukturave të auditimit të brendshëm, ashtu dhe nga ana e titullarëve të institucioneve, të cilët gjithnjë e më tepër po kuptojnë rolin e auditimit si një vlerësues i sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësi edhe si këshillues për ta. Kjo vërehet ndër të tjera në reflektimet e përmirësimit për mangësitë që lidhen me planet dhe raportimet, me nivelin e realizimit të planeve të auditimit, si dhe me numrin e rekomandimeve të zbatuara;
- Ndërgjegjësimi i audituesve lidhur me rëndësinë e zhvillimit profesional të tyre, gjë e cila bazohet në pjesëmarrjen e një numri të konsiderueshëm të audituesve të brendshëm në trajnimet e organizuara nga DH/AB.

Në vlerësimin e DH/AB, mangësitë e vërejtura në veprimtarinë e auditimit të brendshëm (planifikim & raportim), gjatë vitit të kaluar janë në drejtim të:

- NJAB-ve, të cilat nuk i janë përmbajtur formatit të miratuar të raportimit dhe planifikimit, këtu mund të përmendim: Bashkinë Pogradec, Bashkinë Prrenjas, Radio Televizionin Shqiptar, etj.
- NJAB-ve, që kanë bërë ndryshime të planeve të auditimit gjatë vitit dhe nuk kanë njoftuar në DH/AB sipas përcaktimeve në aktet nënligjore (Ministria e Mjedisit, Ministria e Punëve të Brendshme, etj).
- Mbivendosjeve të planeve të auditimit të brendshëm mes NJAB të njësive të vartësisë dhe NJAB në institucionet qendrore, si: Ministria e Punëve të Brendshme me Prefekturat dhe Drejtoritë e Policisë; Ministria e Arsimit dhe Sportit me Universitetet; Ministria e Financave me Drejtoritë e Përgjithshme të Doganave dhe atë të Tatimeve; Ministria e Shëndetësisë me Qendrat Spitalore; Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës me Albcontrol dhe Ujësjetësat, Autoritetin Portual Durrës, etj; Ministria e Energjisë dhe Industrisë me KESH, OST, Albpetrol, etj;
- Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga NJAB dhe mos nxjerrje e përgjegjësisë në këtë drejtim (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit);
- Mos llogaritje e saktë e burimeve njerëzore, ditëve të punës në dispozicion si dhe të buxhetit vjetor të njësive të auditimit të brendshëm;
- Mos identifikim të risqeve dhe si rrjedhojë mos plotësim i formatit për analizën e riskut.
- Funksionimi i njësive të auditimit të brendshëm (28 NJAB) në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore është një problem që nuk po merr zgjidhje për një kohë të gjatë;

Lidhur me mbivendosjet e auditimit të brendshëm është programuar një saktësim në aktet përkatëse nënligjore për të mos e lejuar këtë fenomen në të ardhmen.

Prioritetet për vitin 2016

Gjatë vitit 2016 DH/AB do të fokusohet në:

- Dërgimin për miratim të akteve nënligjore në zbatim të ligjit të auditimit si: akti i krijimit dhe funksionimit të njësive të auditimit të brendshëm, të Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe Komisionit të Kualifikimit të audituesve të brendshëm.
- Planifikimi i vlerësimeve të jashtme të cilësisë në NJAB e organizuara në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore.
- Organizimin e ëorkshop-eve mes drejtuesve të njësive të auditimit dhe audituesve të brendshëm me përvojë për të ndarë përvojat më të mira dhe për të diskutuar problematikat e dala gjatë punës audituese.
- Organizimin e një procesi sa më efektiv të trajnimit të vijueshëm për zhvillimin profesional të audituesve, i dizenuar për audituesit e brendshëm në detyrë;
- Organizimin e procesit të certifikimit, për të ofruar njohuritë kryesore për profesionin e audituesit të brendshëm;
- Organizimin e seminareve në bashkëpunim me DH/MFK për ndërgjegjësimin e menaxherëve të pushtetit vendor për rëndësinë dhe efektivitetin e ngritjes dhe funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm;
- Komunikim të vazhdueshëm me drejtuesit e njësive të auditimit të brendshëm, për ndryshimet e akteve nënligjore dhe standardeve të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm;
- Zhvillimin e një metodologjie për vlerësimin e jashtëm të punës së njësive të auditimit të brendshëm.

Tabela 13. Lidhja e Strategjisë së MFP 2014-2020 me Planin e Aktiviteteve të MFK

Produkti	Veprimet që do të ndërmeren	Statusi i realizimit	Kur?		
			Afat shkurtër 2016	Afat mesëm 2017-2019	Afat gjatë 2020
REFERENCA PËR AKTIVITETET STRATEGJIKE:					
AKTIVITETI 1 – Monitorimi i implementimit të kërkesave ligjore të fushës së MFK					
Legjislacioni i rishikuar I MFK-së dhe kuadri ligjor/nënligjor i pajtueshëm me kërkesat e MFK-së	- Rishikimi i Ligjit për MFK miratuar me VKM nr. 288, datë 08.04.2015	100%			
	- Draftimi i Udhëzimit për Nëpunësin Zbatues	80%	x		
	- Draftimi i Udhëzimit për Koordinatorin e Riskut dhe Koordinatorin e MFK-së	80%	x		
	- Rishikimi i Manualit të MFK-së	80%	x		
AKTIVITETI 2 – Implementimi i një sistemi modern të MFK në 3 ministri linje dhe 4 bashki					
Sistemet e MFK të përmirësuara në 7 njësi publike	- Realizimi i aktiviteteve të projektit pilot të binjakëzimit:				
	o Vlerësimi i institucionit				
	o Hartimi i regjistrit të riskut				
	o Harta e proceseve	80%	x		
	o Ndërtimi i gjurmëve të auditit për çdo proces pune				
	o Hartimi i Planit të Veprimit				
AKTIVITETI 3 – Rritja e ndërgjegjësimit të njësive publike mbi përfitimet e implementimit të konceptit të përgjegjshmërisë menaxheriale					
Rritja e ndërgjegjësimit të menaxhimit të lartë në lidhje me përgjegjshmërinë manaxheriale dhe përgjegjësitë përfundimtare për të ardhurat e buxhetit nëpërmjet seminareve ose takimeve të punës	- Ofrimi i trajnimeve për nivele të ndryshme të menaxherëve mbi konceptin e përgjegjshmërisë manaxheriale në bashkëpunim me ASPA	71 menaxherë të trajnuar	x	x	x
	- Organizimi i trajnimeve dhe seminareve të ndërgjegjësimit, për nivele të ndryshme të menaxhimit në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit	68 menaxherë të trajnuar	x		
	- Organizimi i seminareve të ndërgjegjësimit dy herë brenda vitit me titullarët e institucioneve qendrore dhe lokale	0%	x		

	- Trajnimi i Nëpunësve Zbatues për Udhëzimet e reja	41 nëpunës të trajnuar	58 nëpunës të trajnuar	x	x
Aktivite për tu ndërmarrë në periudhën në vazhdim					
Implementimi dhe zbatimi i një sistemi modern MFK-je në dy ministri linje dhe dy bashki, bazuar në përvojën e fituar nga projekti i mëparshëm	- Prezantimi i koncepteve bazë të MFK	0%		x	
	- Organizimi i punës për të ndërtuar regjistrin e riskut në institucion	0%	x	x	
	- Organizimi i punës për të ndërtuar manualët e punës dhe gjurmët e auditit në institucion	0%	x	x	
	- Organizimi i punës për të ndërtuar planin e veprimit në institucion	0%	x	x	
Monitorimi i Zbatimit të MFK-së	- Përzgjedhja e institucioneve, të cilat do të monitorohen dhe organizimi i vizitave në terren	0%	x	x	x
	- Vlerësimi i performancës dhe rankimi i tyre sipas performancës	0%	x	x	x
Seminaret/trajnimet/asistence direkte nga DH/MFK te organizuara me gjithë NJQP	- Ndërgjegjësimi i menaxherëve për konceptin e përgjegjshmërisë menaxheriale dhe Ofrimi i trajnimeve të vazhduara në shkallë të gjerë të drejtuesve financiarë dhe operacionalë në bashkëpunim me ASPA-n	0%	x	x	x

Tabela 14. Lidhja e Strategjisë së MFP 2014-2020 me Planin e Aktiviteteve të AB

Produkti	Veprimet që do të ndërmerren	Statusi i realizimit	Afat shkurtër 2016	Kur?	
				Afat mesëm 2017-2019	Afat gjatë 2020
REFERENCA PËR AKTIVITETET STRATEGJIKE:					
AKTIVITETI 1 – Rishikimi i zhvillimit të ardhshëm të dëshirueshëm të funksionit të AB-së dhe ndryshimi i kuadrit ligjor dhe metodologjik					
Legjislacioni i ndryshuar i AB	- Ndryshimi dhe miratimi i Ligjit të AB	100%			
	- Shqyrtimi i akteve nënligjorë për krijimin e njërive të auditimit	80%	x		
	- Hartimi i akteve nënligjore për krijimin e Komitetit të Auditimit	50%	x		
	- Rishikimi i Manualit të AB-së	30%	x		
AKTIVITETI 2 – Profesionalizimi i funksionit të AB-së					
Metodologjitë e reja të dokumentuara për AB-në dhe Programi i ri i Certifikimit	- Kryen zhvillimin profesional dhe trajnime mbi metodologjinë dhe praktikat për audituesit e brendshëm në sektorin publik	100%			
	- Përmirësimi i procedurave të certifikimit për Audituesit e Brendshëm	80%	x		
AKTIVITETI 3 – Forcimi i Kapacitetit të DH/AB					
Programi Vjetor i zhvillimit profesional të vazhdueshëm	- Punësimi i personelit shtesë për DH/AB	0%	x		
	- Staf i DH/AB të marrë pjesë në të gjitha trajnimet e organizuara nga ana e ekspertëve të binjakëzimit për audituesit e brendshëm të punësuar në sektorin publik	100%			
Aktivitete për tu ndërmarrë në periudhën në vazhdim					
350 auditues të brendshëm në detyrë të trajnuar nga Struktura Përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm	- Hartimi i programit vjetor të TVP	0%	x		
	- Organizimi, zhvillimi dhe monitorimi i TVP sipas programit vjetor.	0%	x	x	x

40 kandidatë për tu trajnuar si "Auditues të brendshëm në sektorin publik"	- Hartimi i programit të trajnimit të Certifikimit të AB	0%	x	x	x
	- Organizimi i procesit të Certifikimit të AB sipas programit përkatës	0%	x	x	x
	- Zhvillimi dhe monitorimi i procesit të Certifikimit të AB sipas programit përkatës	0%	x		
Njësitë e AB të monitoruara dhe vlerësuara për pajtueshmërinë dhe implementimin e standardeve të AB të pranuar	- Kryerja e auditimeve për vlerësimin e cilësisë së NJAB-ve të sektorit publik	0%	x		
	- Monitorimi i NJAB në sektorin publik nëpërmjet raporteve të angazhimeve të auditimit të realizuara.	0%	x	x	x
Kuadri nënligjor metodologjik i auditimit të brendshëm i rishikuar në lidhje me Manualin e AB dhe vlerësimin e cilësisë së NJAB	- Organizimi dhe zhvillimi i punës për rishikimin e kuadrit nënligjor dhe metodologjik të AB.	0%	x		
	- Hartimi i draftit të Manualit dhe shpërndarja për mendim tek NJAB	0%	x		
	- Hartimi i draftit të Metodologjisë së vlerësimit të cilësisë.	0%	x		
	- Finalizimi i Manualit të AB	80%	x		
	- Finalizimi i kuadrit mbështetës të fushës së AB			x	

ARBEN AHMETAJ

MINISTËR

ANEKSI 1: METODOLOGJIA

Metodologjia e Përdorur

Raporti vjetor i vitit 2015 mbi "Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" është hartuar duke marrë në konsideratë metodologjinë standarde të vetëvlerësimit, të kombinuar me indikatorë të matjes së performancës buxhetore dhe kontrollit të brendshëm, nga ana e Ministrisë së Financave. Indikatorët e matjes së performancës buxhetore dhe kontrollit të brendshëm sigurohen nga strukturat e Ministrinë e Financave që kanë funksione të mbikëqyrjes/monitorimit, të tilla si: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Financiare, Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik.

Burimet e Informacionit

Ministri i Financave është përgjegjës për udhëheqjen e procesit të zbatimit dhe zhvillimit të sistemit të KBFP, në sektorin publik. DH/MFK është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të sistemeve të MFK, si bazë për kontrollin e financave publike. DH/AB është përgjegjëse për harmonizimin dhe monitorimin e zbatimit të standardeve të AB, pranë NJQP-ve. Në këtë kuadër këto njësi kanë mbledhur informacionin për funksionimin e sistemit të MFK dhe AB nëpërmjet burimeve të mëposhtme:

1. Pyetësorët e vetëvlerësimit mbi sistemin e MFK, të cilat u shpërndanë për t'u plotësuar nga 112 NJQP dhe u përpunuan nga DH/MFK.
2. Deklaratat dhe Raportet vjetore të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, të nënshkruar nga Nëpunësit Autorizues të NJQP.
3. Monitorimi dhe analiza e plotësimit të kriterëve ligjore për caktimin e nëpunësve zbatues (drejtuesve të financave) në njësitë publike, të kryera nga DH/MFK.
4. Monitorimi në bazë dokumentare pranë dy institucioneve të pavarura nga ana e DH/MFK.
5. Rankimi sipas treguesve të performancës buxhetore, për të gjitha ministrinë dhe bashkitë kryesore bazuar në të dhënat e siguruar nga Sistemi i Thesarit (mbi respektimin e afatit të dërgimit të faturave në thesar, numri i anulimit të kontratave gjatë një viti, urdhrat e shpenzimeve të refuzuara nga Thesari, etj), Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit (mbi realizimin e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit, saktësinë dhe konsistencën e raportimit, deviacionin mesatar të fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve buxhetore, etj), DH/MFK (cilësia e mjedisit të brendshëm të institucionit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, sistemi i komunikimit dhe informacionit, cilësia e monitorimit) dhe DH/AB (përgatitja e audituesve të brendshëm, raportimi në kohë i audituesve të brendshëm, cilësia e raportit të audituesve të brendshëm, etj).
6. Monitorime të vazhdueshme dhe analiza të kryera nga stafi i DH/AB.
7. Të dhënat e Pyetësorit të vetëvlerësimit të raportuara nga strukturat e auditimit të brendshëm të NJQP, sipas metodologjisë së miratuar nga Ministri i Financave.
8. Të dhënat e raportuara nga 103 Njësi të Auditimit të Brendshëm të ministrive të linjës, institucioneve qendrore dhe të njëjësive të qeverisjes vendore sipas udhëzimit të miratuar nga Ministri i Financave.

Baza për vlerësimin e sistemit aktual:

Ky vlerësim u bazua kryesisht në deklaratën personale të NA të NJQP dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të KB. Të gjitha NJQP kanë detyrimin për të paraqitur në Ministrinë e Financave deklaratën dhe raportin vjetor të gjendjes së sistemit të KB në njësinë që

përfaqësojnë. Formati i deklaratës dhe struktura e raportit është standard i vendosur nga Ministria e Financave me Udhëzimin nr.28, datë 15.12.2012, “Mbi Paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë Publike”, në kuadrin e plotësimit të akteve nënligjore të MFK (kërkesë e nenit 6, të ligjit nr.10296, të MFK, i ndryshuar).


Pyetësorët e vetëvlerësimit të NJQP

Vlen të theksohet që stafi i DH/MFK ka analizuar jo vetëm të dhënat statistikore nga përgjigjet e dërguara nga NJQP, por ka bërë vlerësimin duke marrë në shqyrtim komentet e bëra nga institucionet për zhvillimin e elementeve të ndryshëm të sistemeve të MFK në njësitë e tyre, raportet dhe deklaratat e cilësisë së sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, takimet direkte të zhvilluara me disa përfaqësues të nivelit menaxherial të NJQP, eksperiencën e krijuar gjatë zhvillimit të seminareve informuese dhe ndërgjegjësuese, vlerësimin në praktikë të një pjese të institucioneve qendrore nëpërmjet monitorimit të përgjigjeve të dhëna në pyetësorë, si dhe vlerësimin e treguesve të performancës të dërguar nga strukturat e Buxhetit, Thesarit, DH/MFK dhe DH/AB të Ministrisë së Financave.

Raportimet nga NJQP

Deklaratat dhe raportet vjetore, për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe pyetësorët e vetëvlerësimit u dërguan në Ministrinë e Financave nga të gjithë Nëpunësit autorizues të njësive qendrore dhe vendore. Institucionet qendrore i janë përgjigjur 100% kërkesës ligjore mbi raportimin, megjithëse ka patur vonesa në raportim. Nga institucionet vendore, vetëm 3 prej tyre nuk i kanë dërguar dokumentet e kërkuara. Megjithatë, për sa i përket pushtetit vendor, vihet re një rritje e nivelit të informimit dhe ndërgjegjësisimit mbi rëndësinë e parimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit krahasuar me vitet e mëparshme. Konstatohet i njëjti trend për tre vitet e fundit në përgjigjet e dhëna nga njësitë e qeverisjes vendore dhe qendrore. Grafiku i mëposhtëm paraqet përgjigjet e siguruara nga NJQP në katër vite.

Grafiku 17. Niveli i Raportimit të NJQP



ANEKS 2. ANALIZA E DETAJUAR E MINISTRIVE DHE BASHKIVE

Performanca e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) të Ministrive të linjës për vitin 2015, është bazuar në metodologjinë e miratuar me Urdhër të ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015. Vlerësimi i performancës buxhetore u bazua në analizën e dhjetë treguesve të menaxhimit të fondeve buxhetore, si dhe dhjetë treguesve që lidhen me komponentët e MFK dhe efektivitetin e auditimit të brendshëm. Gjithashtu, vlerësimi i performancës së sistemeve të MFK në NJQP u realizua në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Për çdo komponent janë llogaritur pikët mesatare të tij, të cilat përcaktohen duke konsideruar raportin e shumës së pikëve me të cilat institucioni ka vlerësuar çdo pyetje në përbërje të secilit komponent, me numrin e pyetjeve respektive. Njëkohësisht, analiza përfshin dhe vlerësimin e indikatorëve të AB, ku si bazë të dhënash ka shërbyer pyetësori specifik i vetëvlerësimit të AB si dhe raportet periodike dhe vjetore të dorëzuar nga çdo NJAB. Në këtë aneks paraqitet vlerësimi i detajuar për ministrinë e linjës (të ndara në Ministri të Mëdha dhe Ministri të Vogla), si dhe bashkitë kryesore.

❖ Monitorimi i performancës për Ministrinë e Mëdha⁴

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë është vlerësuar me 525 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë shumë të mirë të kësaj ministrie e cila është e renditur në vendin e parë në rankimin e Ministrive të Mëdha.

Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë si në tabelë më poshtë.

Tabela 155. Vlerësimi i indikatorëve për MMSR

Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	25	3.5%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	15	12.3%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga Thesari	30	0.9%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	25	3.3%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	2.1%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	25	3%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	15	18.2%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	15	19.83%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	30	0%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4
12. Menaxhimi i Riskut	30	4
13. Aktivitetet e kontrollit	30	4

⁴ Plotësojnë njëkohësisht këto dy kritere: kanë buxhet vjetor më të madh se 7 miliardë lekë, dhe kanë më shumë se 5 programe buxhetore

14. Informimi dhe komunikimi	30	4
15. Monitorimi	30	4
16. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
18. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15	
20. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

- Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë kjo ministri gjatë vitit 2015 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 3.5% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, është 25 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të dytë të vlerësimit.
- Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2015, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 12.3%, çka flet për një nivel të mesatar të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet me 15 pikë.
- Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, 0.9% e urdhër-shpenzimet të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë janë paraqitur në thesar në mënyrën jo të duhur. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
- Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikatori i **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, ky institucion karakterizohet nga një performancë e kënaqshme pasi vetëm 3.3% e numrit të kontratave të dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me 25 pikë pasi ndodhet në nivelin e dytë të vlerësimit.
- Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publik (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuara në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 2.1%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë shumë të mirë lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë maksimale.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit

- Duke u bazuar në raportet tremujore të monitorimit, që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria e Mirëqënies Sociale dhe

Rinisë i ka dorëzuar të katër raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.

2. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për vitin buxhetor. Gjatë vitit 2015, ky institucion ka realizuar 97% të planit të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është rreth 3%. Të shoqëruar dhe nga arsyet e mosrealizimit të këtyre shpenzimeve, vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë është 25 pikë, çka flet për një performancë të kënaqshme të këtij indikator.
3. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale**, është indikator që gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Ky indikator evidencën masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë ka realizuar këto shpenzime në masën 81.8% dhe ka një mosrealizim të këtyre shpenzimeve me 18.2%. Vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë së monitorimit është vlerësuar me 15 pikë çka flet për një nivel mesatar të këtij indikator.
4. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, **numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2015 ka qënë 35 dhe shuma e shprehur në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qënë 15.100.041**. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në%) është 19.83%. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, vlerësimi në pikë për këtë institucion përsa i përket këtij indikator është 15 pikë, çka flet për një performancë mesatare të këtij indikator.
5. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikator i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, gjatë vitit 2015 nuk janë krijuar detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar (0%). Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është maksimal, 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, mjedisi i kontrollit dhe menaxhimi i riskut janë vlerësuar mesatarisht me 3.5 pikë secila, gjë që i referohet nivelit të parë të vlerësimit e barabartë me 30 pikë. Gjithashtu edhe aktivitetet e kontrollit, Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi kanë marrë 30 pikë pasi janë vlerësuar respektivisht me 3.7 pikë, 4 dhe 3.7 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2015, të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor duhej dhënë arsyetim më i detajuar sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar dhe realizuar 30 angazhime auditimi, dhe vetëm 1 angazhim auditimi të vetë institucionit, si njësi të rëndësishme shpenzuese të fondeve buxhetore, duke dobësuar rolin dhe misionin që i ngarkon ligji i auditimit. Në planin vjetor nuk ka planifikuar auditimin e aparatit të institucionit por me ndryshimin e menaxhimit është inicuar ndryshimi i planit duke përfshirë auditimin e drejtorisë së financës dhe shërbimeve mbështetëse.

Kjo njësi ka kryer auditime të mbivendosura me njësitë e auditimit të brendshëm në Shërbimin Kombëtar të Punësimit dhe Shërbimin Social Shtetëror, këtu mund të përmendim: 7 Drejtori Rajonale të Formimit Profesional Publik, 6 Drejtori Rajonale Punësimi 4 Drejtori Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, etj.

Nga monitorimi i raporteve finale dhe raportit vjetor ka rezultuar se vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm nuk është bërë në nivelin e kërkuar dhe rekomandimet janë të pa adresuara sipas sistemeve.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuar. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 5 punonjës (1 drejtues dhe 4 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe të trajnuar. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Financave për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Financave është vlerësuar me 520 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të kënaqshme të kësaj ministrie dhe e renditur në vendin e dytë në rankimin e Ministrive të Mëdha. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 16. Vlerësimi i indikatorëve të MF

Ministria e Financave	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	25	3.17%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	15	9.07%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara Thesari	30	0.33%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	5.99%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	1.35%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	25	4.6%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	15	16.4%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	30	2.14%
10. Shlyerja e detyrimeve të prapambetura	30	0%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4
12. Menaxhimi i Riskut	30	4
13. Aktivitetet e kontrollit	20	3
14. Informimi dhe komunikimi	30	4
15. Monitorimi	30	4
16. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	

18. Monitorimi i pyetësorit të vetëvleresimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilesia e raportimit të audituesve të brendshëm	25	
20. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	20	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar. Për këtë ministri gjatë vitit 2015 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 3.17% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë ministri, është 25 pikë duke qenë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të dytë.
2. Anulimi i kontratave gjatë vitit është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsytet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2015, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 9.07%, çka flet për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet me 15 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari përfaqson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, pothuajse të gjitha urdhër-shpenzimet e Ministrisë së Financave janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, për këtë institucion, raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në Thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 5.99%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e tretë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 15 pikë. Këto pikë tregojnë për një performancë mesatare.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qenë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 1.35%. Kjo përqindje do të thotë që një numër shumë i vogël i urdhër-prokurimeve kanë qenë të paautorizuara kur janë paraqitur në APP. Në këtë aspekt bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është maksimal 30 pikë.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit

1. Duke u bazuar në raportet tremujore të monitorimit, që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria e Financave i ka dorëzuar të

katër raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.

2. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për një vit buxhetor. Gjatë vitit 2015, ky institucion ka realizuar 95.4% të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është rreth 4.6%. Të shoqëruar dhe nga arsyet e mosrealizimit të këtyre shpenzimeve, vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë është 25 pikë, çka flet për një performancë të mirë të këtij institucioni.
3. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale**, ky indikator gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Indikator na evidencon masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Financave ka realizuar rreth 83.6% të shpenzimeve kapitale të planifikuara, duke evidencuar në këtë mënyrë në një nivel mosrealizimi të shpenzimeve kapitale prej 16.4% që është më i lartë se ato korrente (4.6%). Vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë së monitorimit është vlerësuar me 15 pikë, duke qënë se përqindja e mësipërme i përket intervalit të tretë të këtij sistemi vlerësimi.
4. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2015 ka qënë 17 dhe shuma në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qënë 164,064. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në%) është 2.14%. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, pikët për këtë institucion përse i përket këtij indikator janë 30 pikë. Ndaj, si përfundim mund të themi që Ministria e Financave ka një performancë të kënaqshme për këtë indikator.
5. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikator i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Financave, gjatë vitit 2015 nuk janë krijuar detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar. Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është 30 pikë maksimale.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Ministrinë e Financave, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.7 pikë, ndaj dhe ka marrë 30 pikë. Edhe menaxhimi i riskut është vlerësuar mesatarisht 3.7 pikë, duke marrë 30 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Ndërsa aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar me 20 pikë me një mesatare 3.4 pikë. Informimi dhe komunikimi si dhe Monitorimi kanë marrë mesatarisht 4 pikë secili, duke u vlerësuar maksimalisht me 30 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele shumë të kënaqshme.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Financave**, paraqet indikatorët e mëposhtëm.

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2015, të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB prej vitesh ka një përpikmëri në lidhje me afatet e raportimit dhe ka marrë vlerësimet maksimale. (30 pikë)

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor duhej dhënë arsyetim i detajuar sipas përcaktimeve të metodologjisë. Ky arsyetim nuk është plotësuar. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar 26 dhe ka realizuar 59 misione auditimi, ku pjesa më e madhe prej 31 misionesh janë ndjekje dhe zbatim rekomandimesh. Nga monitorimi i raporteve finale të auditimit, vihet re se ka kryer 7 angazhime auditimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe INSIG, institucione të cilat kanë njësi të auditimit të brendshëm.

Në lidhje me raportin vjetor, theksojmë se kjo njësi nuk i është përmbajtur strukturës së miratuar të raportimit. Por për një cilësi sa më të mirë të raporteve kërkohet një vlerësim sa më i detajuar i sistemeve të kontrollit të brendshëm për angazhimet e auditimit të kryera. Ky detajim duhet bërë në të ardhmen për çdo komponent të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 9 punonjës (1 drejtues dhe 8 specialistë), dhe aktualisht kjo NJAB nuk ka tre auditues të brendshëm. (20 pikë)

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Brendshme për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Brendshme është vlerësuar me 505 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë mesatare të kësaj ministrie dhe e renditur në vendin e tretë. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 17. Vlerësimi i indikatorëve të MB

Ministria e Brendshme	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	25	3.64%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	25	4%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga Thesari	30	0.4%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	12.6%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	15	11.17%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	25	2.5%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	30	2.37%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi	15	7.6%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	30	0%
11. Mjedisi i kontrollit	20	3
12. Menaxhimi i Riskut	20	3
13. Aktivitetet e kontrollit	20	3
14. Informimi dhe komunikimi	30	4
15. Monitorimi	30	4
16. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
18. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25	
20. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë ministri gjatë vitit 2015 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 3.64% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njërive publike për këtë ministri, është 25 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të dytë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2015, për ministrinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 4%, çka flet për një nivel të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 25 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0.4%, pra pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, ky institucion karakterizohet nga një numër i konsiderueshëm i kontratave të paraqitura me vonesë në Thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 12.6%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e tretë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 15 pikë. Këto pikë tregojnë për një performancë mesatare si dhe theksojnë nevojën për marrjen e masave të menjëhershme në këtë drejtim.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 11.17%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 15 pikë.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit

6. Duke u bazuar në raportet tremujore të monitorimit, që ministrinë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria e Punëve të Brendshme i ka dorëzuar të katër raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë, që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe

saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.

7. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për një vit buxhetor. Gjatë vitit 2015, ky institucion ka realizuar 97.5% të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është 2.5%. Bazuar në këtë performancë të ministrisë përkatëse, vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë është 25 pikë, pra vlerësim me pikë të larta.
8. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale**, ky indikator gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Indikatorin na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Punëve të Brendshme ka realizuar rreth 97.63% të shpenzimeve kapitale të planifikuara, duke evidencuar në këtë mënyrë në një nivel më të ulët mosrealizimi të shpenzimeve kapitale (2.37%) krahasuar edhe me ato korrente (2.5%). Vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë, duke qënë se përqindja e mësipërme i përket intervalit të parë të këtij sistemi vlerësimi.
9. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2015 ka qënë 49 dhe shuma në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qënë 1,482,602. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në%) është 7.6%. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, pikët për këtë institucion përse i përket këtij indikator janë 15 pikë maksimale. Ndaj, duke marrë parasysh dhe numrin e lartë të rialokimeve, si përfundim mund të themi që Ministria e Punëve të Brendshme ka një performancë jo të mirë për këtë indikator.
10. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikatorin i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Punëve të Brendshme, gjatë vitit 2015, nuk janë krijuar detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar. Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është 30 pikë maksimale.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Ministrinë e Punëve të Brendshme, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.4 pikë, ndaj dhe ka marrë 20 pikë. Menaxhimi i riskut është vlerësuar mesatarisht 3 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Gjithashtu, aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar mesatarisht me 3.4 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë. Informimi dhe komunikimi si dhe Monitorimi kanë marrë mesatarisht 4 pikë, duke u vlerësuar me 30 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, kryesisht, në kuadër të përmirësimit të komponentit të Menaxhimit të riskut, Mjedisit të kontrollit dhe Aktiviteteve të kontrollit, të cilët mesatarisht janë vlerësuar më pak në krahasim me të tjerët.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Punëve të Brendshme** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2015, të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor duhej dhënë arsyetim më i detajuar sipas përcaktimeve të metodologjisë. Ky arsyetim nuk është plotësuar dhe ky fakt ka ndikuar në vlerësimin e cilësisë së raportimit. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar 27 angazhime auditimi, në fakt ka kryer 20 angazhime auditimi, duke shmangur auditimin e vetë institucionit dhe të Drejtorisë së Prokurimeve të Përqëndruara, si njësi të rëndësishme shpenzuese të fondeve buxhetore, duke dobësuar rolin dhe misionin që i ngarkon ligji i auditimit.

Kjo njësi ka kryer auditime të mbivendosura në 15 raste me njësitë e auditimit të brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave të Shtetit dhe në disa Prefektura të Qarqeve. Nga monitorimi i raporteve të auditimit konstatohen mangësi në drejtim të zbatimit të standardeve të auditimit të brendshëm, pasi në disa raste janë rekomanduar masa disiplinore, në një kohë që duhej rekomanduar përmirësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 8 punonjës (1 drejtues dhe 7 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe të trajnuar. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Drejtësisë për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Drejtësisë është vlerësuar me 505 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të mirë të kësaj ministrie e cila është e renditur në vendin e tretë në rankimin e Ministrive të Mëdha. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 18. Vlerësimi i indikatorëve për MD

Ministria e Drejtësisë	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	25	2.6%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	25	4.1%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga Thesari	30	0.7%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	25	3.1%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	25	4.3%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0.0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	15	8.8%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	30	+30.8%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	15	7.5%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	30	2%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4
12. Menaxhimi i Riskut	20	3
13. Aktivitetet e kontrollit	30	4
14. Informimi dhe komunikimi	30	4
15. Monitorimi	20	3
16. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	10	
18. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të	30	4

brendshëm

19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25
20. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë kjo ministri gjatë vitit 2015 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 2.6% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njërive publike për Ministrinë e Drejtësisë, është 25 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të dytë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2015, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 4.1%, çka flet për një nivel të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet me 25 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, pothuajse të gjitha urdhër-shpenzimet e Ministrisë së Drejtësisë janë paraqitur në Thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikatori i **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, ky institucion karakterizohet nga një performancë e kënaqshme pasi vetëm 3.1% e numrit të kontratave të dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me 25 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 4.3%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë të kënaqshme lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 25 pikë pasi ndodhet në nivelin e dytë.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit

6. Duke u bazuar në raportet tremujore të monitorimit, që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe**

Konsistenca e Raportimeve për një vit buxhetor. Ministria e Drejtësisë i ka dorëzuar të katër raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.

7. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për vitin buxhetor. Gjatë vitit 2015, ky institucion ka realizuar 91.2% të planit të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është rreth 8.8%. Të shoqëruar dhe nga arsyet e mosrealizimit të këtyre shpenzimeve, vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë është 15 pikë, çka flet për një performancë në një nivel mesatar i këtij indikator.
8. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale**, ky indikator gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Ky indikator evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. **Ministria e Drejtësisë ka një tejkalim të këtyre shpenzimeve me 30.8% dhe kjo vjen si rrjedhojë e disbursimit të huaj jashtë sistemit të thesarit.** Vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë së monitorimit është vlerësuar maksimalisht me 30 pikë.
9. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, **numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2015 ka qënë 15 dhe shuma e shprehur në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qënë 531.721.** Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në%) është 15%. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, vlerësimi në pikë për këtë institucion përse i përket këtij indikator janë 15 pikë. Ndaj, si përfundim mund të themi që Ministria e Drejtësisë ka një performancë mesatare për këtë indikator.
10. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikator i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Drejtësisë, gjatë vitit 2015 janë krijuar 2% detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar. Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është maksimal, 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Ministrinë e Drejtësisë, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.5 pikë, gjë që i referohet nivelit të parë të vlerësimit e barabartë me 30 pikë. Komponenti "Menaxhimi i riskut" arrin në një vlerësim mesatar sipas pyetësorit me 3 pikë, duke i korresponduar kështu nivelit të dytë i vlerësuar me 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Ndërsa aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar me 30 pikë pasi janë vlerësuar me 3.7 pikë. Gjithashtu edhe Informimi dhe komunikimi është vlerësuar me pikët maksimale - 30 pikë pasi vlerësimi mesatar i këtij indikator për periudhën që analizohet është 3.7 pikë. Monitorimi ka marrë mesatarisht 3.3 pikë, që sipas metodologjisë së monitorimit vlerësohet me 20 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave kryesive, në kuadër të përmirësimit të komponentit të Menaxhimit të riskut dhe monitorimit, të cilët mesatarisht janë vlerësuar më pak në krahasim me të tjerët.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Drejtësisë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2015, të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB nuk ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 10 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor duhej dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Ky arsyetim nuk është plotësuar. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar dhe realizuar 29 angazhime auditimi, por **duhet theksuar se nuk ka kryer angazhime auditimi për institucionin e ministrisë** duke dobësuar rolin dhe misionin që në fakt njësia e auditimit të brendshëm duke lënë jashtë programimit të gjitha drejtoritë e aparatit të ministrisë duke audituar vetëm institucione varësie.

Kjo njësi nuk ka dërguar zyrtarisht kopje të raporteve finale të auditimit për monitorim nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Në lidhje me raportimin vjetor megjithëse i është përmbajtur strukturës së kërkuar dhe është bërë identifikimi i risqeve, por kërkohet një vlerësim më i thelluar i sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 5 punonjës (1 drejtues dhe 4 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe të trajnuar. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Arsimit dhe Sporteve është vlerësuar me 490 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë mesatare të mirë të kësaj ministrie e cila është e renditur në vendin e pestë në rankimin e Ministrive të Mëdha. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 19. Vlerësimi i indikatorëve të MAS

Ministria e Arsimit dhe Sporteve	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	25	3.6%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	15	6.5%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga Thesari	30	0.4%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	25	4.5%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	1.4%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	15	25%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	30	1.2%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	15	12.5%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	30	0.84%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	30	0%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4

12. Menaxhimi i Riskut	30	4
13. Aktivitetet e kontrollit	30	4
14. Informimi dhe komunikimi	30	4
15. Monitorimi	10	2
16. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	15	
18. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15	
20. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	25	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

- Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë kjo ministri gjatë vitit 2015 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 3.6% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njërive publike për Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, është 25 pikë duke qenë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të dytë të vlerësimit.
- Anulimi i kontratave gjatë** vitit është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2015, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 6.5%, çka flet për një nivel të mesatar të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet me 15 pikë.
- Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, 0.4% e urdhër-shpenzimet të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve janë paraqitur në thesar në mënyrën jo të duhur. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
- Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikatori i **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, ky institucion karakterizohet nga një performancë e kënaqshme pasi vetëm 4.5% e numrit të kontratave të dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me 25 pikë pasi ndodhet në nivelin e dytë të vlerësimit.
- Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qenë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 1.4%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë shumë të mirë lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë maksimale.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit

1. Duke u bazuar në raportet tremujore të monitorimit, që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria e Arsimit dhe Sporteve të katër raportet e dorëzuara janë vlerësuar në masën 75% konsistente dhe të sakta. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 25 pikë që i referohet nivelit dytë të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie duhet të përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.
2. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për vitin buxhetor. Gjatë vitit 2015, ky institucion ka realizuar 98.8% të planit të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është rreth 1.2%. Të shoqëruar dhe nga arsyet e mosrealizimit të këtyre shpenzimeve, vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë është 30 pikë maksimale, çka flet për një performancë shumë të mirë të këtij indikator.
3. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale**, është indikator që gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Ky indikator evidencon masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Arsimit dhe Sporteve ka realizuar këto shpenzime në masën 87.5% dhe ka një mosrealizim të këtyre shpenzimeve me 12.5%. Vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë së monitorimit është vlerësuar me 15 pikë çka flet për një nivel mesatar të këtij indikator.
4. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, **numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2015 ka qënë 12 dhe shuma e shprehur në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qënë 337.738**. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në%) është 0.84%. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, vlerësimi në pikë për këtë institucion përsa i përket këtij indikator është maksimal me 30 pikë. Ndaj, si përfundim mund të themi që Ministria e Arsimit dhe Sporteve ka një performancë shumë të mirë për këtë indikator.
5. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikator i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, gjatë vitit 2015 nuk janë krijuar detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar (0%). Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është maksimal, 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi i performancës nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të Për Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.7 pikë, gjë që i referohet nivelit të parë të vlerësimit e barabartë me 30 pikë. Komponenti “Menaxhimi i riskut” arrin në të njëjtin nivel vlerësim me 3.6 pikë, duke i korresponduar kështu të njëjtit nivel vlerësimi me 30 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Ndërsa edhe aktivitetet e kontrollit dhe Informimi dhe komunikimi kanë marrë 30 pikë pasi janë vlerësuar me 3.8 pikë secila. Vetëm, Monitorimi është vlerësuar me 10 pikë pasi ka marrë 2.25 pikë mesatare. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. Kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2015, të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB nuk ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 15 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar 38 angazhime auditimi dhe ka realizuar 48 angazhime auditimi, nga të cilat janë kryer 21 angazhime për ndjekje rekomandimesh, tregues ky që ndikon në uljen e efektivitetit dhe rritjen e kostos së auditimit.

Në lidhje me raportimin vjetor megjithëse i është përmbajtur strukturës së kërkuar por kërkohet një vlerësim më i thelluar i sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 5 punonjës (1 drejtues dhe 4 specialistë), dhe aktualisht ka një vend vakant të specialistit në NJAB. Audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe të trajnuar. (25 pikë)

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës është vlerësuar me 485 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, duke e renditur në vendin e gjashtë në rankimin e Ministrive të Mëdha. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë si në tabelën në vijim.

Tabela 20. Vlerësimi i indikatorëve të MTI

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	Pikët	Vlerësimi nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	25	2.6%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	25	3.1%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga Thesari	30	0.2%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0.0%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0.0%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0.0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	25	3.5%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	15	6.6%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	15	15.4%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	25	4%
11. Mjedisi i kontrollit	20	3
12. Menaxhimi i Riskut	20	3
13. Aktivitetet e kontrollit	20	3

14. Informimi dhe komunikimi	30	4
15. Monitorimi	30	4
16. Përgatitja e audituesve të brendshëm	20	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
18. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15	
20. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	20	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit

- Indikatori i parë i analizuar është Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar. Për këtë kjo ministri gjatë vitit 2015 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 2.6% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të kënaqshëm të realizimit të këtij indikator. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njërive publike për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, është 25 pikë duke qenë se mosrealizimi i këtij indikator i përket nivelit të dytë të vlerësimit.
- Anulimi i kontratave gjatë vitit është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2015, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 3.1%, çka flet për një nivel të kënaqshëm të realizimit të këtij indikator, pra vlerësohet me 25 pikë.
- Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, pothuajse të gjitha urdhër-shpenzimet e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës janë paraqitur në Thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë e shkëlqyer në këtë drejtim.
- Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin **kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre**. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikator i **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, ky institucion karakterizohet nga një performancë e shkëlqyer pasi numri i kontratave të dorëzuara në Thesar ka qenë brenda afatit ligjor ndaj dhe është vlerësuar maksimalisht me 30 pikë.
- Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikator i fundit i gjeneruar nga Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qenë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Kjo përqindje do të thotë që nuk ka asnjë urdhër prokurim të paautorizuar nga Thesari, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit

6. Duke u bazuar në raportet tremujore të monitorimit, që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës i ka dorëzuar të katër raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.
7. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për një vit buxhetor. Gjatë vitit 2015, ky institucion ka realizuar 96.5% të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është rreth 3.5%. Të shoqëruar dhe nga arsyet e mosrealizimit të këtyre shpenzimeve, vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë është 25 pikë, çka flet për një performancë të kënaqshme të këtij institucioni.
8. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale**, ky indikator gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Ky indikator evidencon masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës ka realizuar rreth 93.4% të shpenzimeve kapitale të planifikuara, duke evidencuar në këtë mënyrë një nivel mesatar të mosrealizimit të shpenzimeve kapitale (6.6%) krahasuar edhe me mosrealizimin e shpenzimeve korrente (3.5%). Vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë së monitorimit është vlerësuar me 15 pikë, duke qënë se përqindja e mësipërme i përket intervalit të tretë të këtij sistemi vlerësimi.
9. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2015 ka qënë **32 dhe shuma e shprehur në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qënë 5.607,637**. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në%) është 15.4%. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, pikët për këtë institucion përse i përket këtij indikator janë 15 pikë. Ndaj, si përfundim mund të themi që Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës ka një performancë mesatare për këtë indikator.
10. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikator i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, gjatë vitit 2015 janë krijuar 4% detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar. Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është 25 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.3 pikë, gjë që i referohet nivelit të dytë të vlerësimit e barabartë me 20 pikë. Komponenti "Menaxhimi i riskut" arrin në një vlerësim mesatar sipas pyetësorit me 2.7 pikë, duke i korresponduar kështu nivelit të dytë i vlerësuar me 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Po ashtu edhe aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar me 20 pikë pasi janë vlerësuar me 3.4 pikë. Informimi dhe komunikimi si dhe Monitorimi kanë marrë mesatarisht respektivisht 3.5 dhe 4 pikë, që sipas metodologjisë së monitorimit janë vlerësuar me 30 pikë secili komponent. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave kryesisht, në kuadër të përmirësimit të komponentit të menaxhimit të riskut, i mjedisit të kontrollit dhe aktiviteteve të kontrollit të cilët mesatarisht janë vlerësuar më pak në krahasim me të tjerët.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministritë së Transportit dhe Infrastrukturës** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 20 pikë sepse për vitin 2015, një punonjës i njësisë është i pa certifikuar kurse të gjithë kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor duhet të shpjegohej në mënyrë më të detajuar arsyeimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar 19 angazhime auditimi dhe aktualisht ka realizuar 20 angazhime. Nga monitorimi i raporteve finale konstatohen mangësi në drejtim të zbatimit të standardeve të auditimit të brendshëm, programimi i veprimtarisë audituese nuk është bërë mbi bazën e vlerësimit të riskut dhe respektimit të frekuencës së auditimeve si në aparatit e ministritë ose në Autoritetin Rrugor Shqiptar. Në një kohë që janë audituar subjekte me risk të ulët si Ujësjellësat: Peqin, Lezhë, Sarandë, Kuçovë, Pukë, etj. Vihet re se kjo njësi kryen auditime financiare me nivel kontroll-revizioni dhe jo konform standardeve të auditimit të brendshëm.

Në lidhje me raportimin vjetor kërkohet një analizë e mirëfilltë e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe të trajtimit të risqeve të identifikuara dhe jo të evidentohen të gjitha rekomandimet sipas auditimeve të kryera.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e planifikuar në nivel drejtorie, e përbërë me 5 punonjës (1 drejtues dhe 4 specialistë), ku 1 auditues i brendshëm është i pa certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimin e vijueshëm profesional të gjithë audituesit e brendshëm. Aktualisht, në këtë njësi mungon drejtuesi i njësisë dhe një auditues i brendshëm. (20 pikë)

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave është vlerësuar me 485 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë jo të mirë të kësaj ministrie e cila është e renditur në vendin e gjashtë në rankimin e Ministrive të Mëdha. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 21. Vlerësimi i indikatorëve për MBZHRAU

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	25	2.7%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	15	11.7%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga Thesari	30	1%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	9.85%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	25	2.99%

6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	25	2.6%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	15	9.2%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	15	7.29%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	30	1%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4
12. Menaxhimi i Riskut	20	3
13. Aktivitetet e kontrollit	20	3
14. Informimi dhe komunikimi	20	3
15. Monitorimi	30	4
16. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
18. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25	
20. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	25	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë indikator, kjo ministri gjatë vitit 2015 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 2.7% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të mirë të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Adinistrimit të Ujërave është 25 pikë duke qenë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të dytë të vlerësimit.
2. Anulimi i kontratave gjatë vitit është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2015, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 11.7%, çka flet për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet me 15 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, 1% e urdhër-shpenzimet të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Adinistrimit të Ujërave janë paraqitur në thesar në mënyrën jo të duhur. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë e kënaqshme në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikatori i **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, ky institucion karakterizohet nga një performancë mesatare pasi 9.85% e numrit të kontratave të dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me 15 pikë pasi ndodhet në nivelin e tretë të vlerësimit.

5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikator i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 2.99%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë të mirë lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 25 pikë.

Drejtorja e Përgjithshme e Buxhetit

6. Duke u bazuar në raportet tremujore të monitorimit, që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria e Bujqësisë, zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave i ka dorëzuar të katër raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.
7. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për vitin buxhetor. Gjatë vitit 2015, ky institucion ka realizuar 97.4% të planit të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është rreth 2.6%. Të shoqëruar dhe nga arsyet e mosrealizimit të këtyre shpenzimeve, vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë është 25 pikë, çka flet për një performancë të mirë të këtij indikator.
8. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale**, është indikator që gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Ky indikator evidencon masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave ka realizuar këto shpenzime në masën 90.8% dhe ka një mosrealizim të këtyre shpenzimeve me 9.2%. Vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë së monitorimit është vlerësuar me 15 pikë, çka flet për një nivel mesatar të këtij indikator.
9. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, **numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2015 ka qënë 16 dhe shuma e shprehur në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qënë 613.144lekë**. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në%) është 7.29%. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, vlerësimi në pikë për këtë institucion përsa i përket këtij indikator është 15 pikë. Ndaj, si përfundim mund të themi që Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave ka një performancë mesatare për këtë indikator.
10. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikator i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, gjatë vitit 2015 nuk janë krijuar detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar (0%). Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është maksimal, 30 pikë.

Drejtorja e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.9 pikë, gjë që i referohet nivelit të parë të vlerësimit e barabartë me 30 pikë. Komponenti "Menaxhimi i riskut" arrin në një nivel vlerësimi me 2.8 pikë,

duke i korresponduar kështu nivelit të dytë të vlerësimit me 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Ndërsa për aktivitetet e kontrollit dhe Informimi dhe komunikimi kanë marrë 20 pikë pasi janë vlerësuar respektivisht me 3 dhe 3.3 pikë secila. Monitorimi është vlerësuar me 30 pikë pasi ka marrë mesatarisht 3.5 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. Kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2015, të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar 25 angazhime auditimi, në fakt ka kryer 31 angazhime auditimi, por duhet të theksojmë se kjo NJAB nuk ka dërguar në DH/AB ndryshimin e planit të miratuar nga titullari, sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e AB. Ka kryer auditime të mbivendosura në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, institucion që ka në strukturën e tij njësi të auditimit të brendshëm.

Në lidhje me raportimin vjetor megjithëse i është përmbajtur strukturës së kërkuar dhe është bërë identifikimi i risqeve, por kërkohet një vlerësim më i thelluar i sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 5 punonjës (1 drejtues dhe 4 specialistë). Pozicioni i drejtuesit të NJAB është i pa plotësuar. (25 pikë)

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Shëndetësisë për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Shëndetësisë është vlerësuar me 460 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë jo të mirë të kësaj ministrie e cila është e renditur në vendin e tetë në rankimin e Ministrive të Mëdha. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë si më sipër.

Tabela 22. Vlerësimi i indikatorëve për MSH

Ministria e Shëndetësisë	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degëne Thesarit	15	6.12%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	15	9.7%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga Thesari	30	2.13%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	18%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	15	10.66%

6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	25	2.5%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	30	0.9%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	30	0.55%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	30	0%
11. Mjedisi i kontrollit	20	3
12. Menaxhimi i Riskut	20	3
13. Aktivitetet e kontrollit	20	3
14. Informimi dhe komunikimi	20	3
15. Monitorimi	20	3
16. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	10	
18. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25	
20. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikator i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë kjo ministri gjatë vitit 2015 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 6.12% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikator. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për Ministrinë e Shëndetësisë, është 15 pikë duke qenë se mosrealizimi i këtij indikator i përket nivelit të tretë të vlerësimit.
2. Anulimi i kontratave gjatë vitit është një tjetër indikator që derivon nga Drejtorja e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2015, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkuara është 9.7%, çka flet për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikator, pra vlerësohet me 15 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, 2.13% e urdhër-shpenzimet të Ministrisë së Shëndetësisë janë paraqitur në thesar në mënyrën jo të duhur. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikator i **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, ky institucion karakterizohet nga një performancë jo e kënaqshme pasi 18% e numrit të kontratave të dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me 15 pikë pasi ndodhet në nivelin e tretë të vlerësimit.

5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikator i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 10.66%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni nuk ka një performancë shumë të mirë lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 15 pikë.

Drejtorja e Përgjithshme e Buxhetit

1. Duke u bazuar në raportet tremujore të monitorimit, që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria e Shëndetësisë i ka dorëzuar të katër raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.
2. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për vitin buxhetor. Gjatë vitit 2015, ky institucion ka realizuar 97.5% të planit të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është rreth 2.5%. Të shoqëruar dhe nga arsyet e mosrealizimit të këtyre shpenzimeve, vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë është 25 pikë, çka flet për një performancë të mirë të këtij indikator.
3. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale**, është indikator që gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Ky indikator evidencën masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Shëndetësisë ka realizuar këto shpenzime në masën 99.1% dhe ka një mosrealizim të këtyre shpenzimeve me 0.9%. Vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë së monitorimit është vlerësuar me 30 pikë maksimale, çka flet për një nivel shumë të mirë të këtij indikator.
4. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, **numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2015 ka qënë 14 dhe shuma e shprehur në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qënë 179.480 lekë**. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në%) është 0.55%. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, vlerësimi në pikë për këtë institucion përsa i përket këtij indikator është maksimal me 30 pikë. Ndaj, si përfundim mund të themi që Ministria e Shëndetësisë ka një performancë shumë të mirë për këtë indikator.
5. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikator i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Shëndetësisë, gjatë vitit 2015 nuk janë krijuar detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar (0%). Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është maksimal, 30 pikë.

Drejtorja e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Ministrinë e Shëndetësisë, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 2.9 pikë, gjë që i referohet nivelit të dytë të vlerësimit e barabartë me 20 pikë. Komponenti "Menaxhimi i riskut" arrin në një nivel vlerësimi me 2.7 pikë, duke i korresponduar kështu të njëjtë nivel vlerësimi me 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Ndërsa edhe aktivitetet e kontrollit dhe Informimi dhe komunikimi kanë marrë 20 pikë pasi janë vlerësuar respektivisht me 2.9 dhe 3

pikë secila. Ashtu si komponentët e sipërpermendur, edhe Monitorimi është vlerësuar me 20 pikë pasi ka marrë mesatarisht 3 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Shëndetësisë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2015, të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB nuk ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 10 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i detajuar sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar 17 angazhime auditimi, në fakt ka kryer 16 angazhime auditimi në institucionet e varësisë dhe megjithëse ka programuar 1 auditim në aparatit e ministrisë nuk e ka realizuar atë, duke theksuar që kjo ministri është një institucion i rëndësishëm shpenzues i fondeve buxhetore.

Nga monitorimi i raporteve finale të auditimit rezulton se në auditimet e kryera janë konstatuar mangësi në vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, vlerësimin e riskut dhe performancën e njësive të audituara. Në disa auditime, kjo njësi ka aktivizuar specialistë të pa certifikuar, gjë që ka ndikuar në cilësinë e shërbimit të auditimit.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 7 punonjës (1 drejtues dhe 6 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe të trajnuar. (30 pikë)

❖ Monitorimi i performancës së Ministrive të Vogla⁵

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Punëve të Jashtme për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Punëve të Jashtme është vlerësuar me 530 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë shumë të kënaqshme të kësaj ministrie, e cila është renditur në vendin e parë nga rankimi i Ministrive të Vogla. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë.

Tabela 23. Vlerësimi i indikatorëve për Ministrinë e Punëve të Jashtme

Ministria e Punëve të Jashtme	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	15	12.87%

⁵ Plotësojnë njëkohësisht këto dy kritere: kanë buxhet vjetor më të vogël se 7 miliardë lekë, dhe kanë më pak se 5 programe buxhetore

2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara Thesari	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	22.86%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	30	0%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	25	2.94%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	30	2.1%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	30	0%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4
12. Menaxhimi i riskut	20	3
13. Aktivitetet e kontrollit	20	3
14. Informimi dhe komunikimi	30	4
15. Monitorimi	30	4
16. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
18. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15	
20. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit.

Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit

- Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë ministri gjatë vitit 2015 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 12.87% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel jo të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë ministri, është 15 pikë duke qenë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të tretë.
- Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2015, për ministrinë në fjalë nuk kemi asnjë kontratë të anuluar, pra raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
- Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, pra të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në Thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.

9. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, ky institucion karakterizohet nga një numër i konsiderueshëm i kontratave të paraqitura me vonesë në Thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë ne thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 22.86%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e tretë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 15 pikë. Këto pikë tregojnë për një performancë jo të kënaqshme si dhe theksojnë nevojën për marrjen e masave të menjëhershme në këtë drejtim.
10. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikator i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Kjo përqindje do të thotë që të gjitha urdhër-prokurimet kanë qënë të autorizuara kur janë paraqitur në APP. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit

11. Duke u bazuar në raportet tremujore të monitorimit, që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria e Punëve të Jashtme i ka dorëzuar të katër raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë, që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet edhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.
12. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për një vit buxhetor. Gjatë vitit 2015, ky institucion ka realizuar 100% të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është 0%. Bazuar në këtë performancë të ministrisë përkatëse, vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë është 30 pikë, pra vlerësim me pikët maksimale të mundshme.
13. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale**, ky indikator gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Indikatorin na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Punëve të Jashtme ka realizuar rreth 97.06% të shpenzimeve kapitale të planifikuara, duke evidentuar në këtë mënyrë në një nivel më të lartë mosrealizimi të shpenzimeve kapitale (2.94%) krahasuar edhe me ato korrente (0%). Vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë së monitorimit është 25 pikë, duke qënë se përqindja e mësipërme i përket intervalit të dytë të këtij sistemi vlerësimi.
14. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2015 ka qënë 3 dhe shuma në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qënë 49,050 lekë. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në%) është 2.1%. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, pikët për këtë institucion për sa i përket këtij indikator janë 30 pikë maksimale. Ndaj, si përfundim mund të themi që Ministria e Punëve të Jashtme ka një performancë shume të mirë për këtë indikator.
15. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikator i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt

që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Punëve të Jashtme, gjatë vitit 2015, nuk janë krijuar detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar. Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është 30 pikë maksimale.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Ministrinë e Punëve të Jashtme, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.94 pikë, ndaj dhe ka marrë 30 pikë. Menaxhimi i riskut është vlerësuar mesatarisht 2.8 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Gjithashtu, aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar mesatarisht me 3.3 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë. Informimi dhe komunikimi si dhe Monitorimi kanë marrë mesatarisht 4 pikë, duke u vlerësuar me 30 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, kryesisht, në kuadër të përmirësimit të komponentit të Menaxhimit të riskut dhe Aktiviteteve të kontrollit, të cilët mesatarisht janë vlerësuar më pak në krahasim me të tjerët.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Punëve të Jashtme** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2015, të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor duhej dhënë arsyetim më i detajuar sipas përcaktimeve të metodologjisë. Ky arsyetim nuk është plotësuar. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar 19 angazhime auditimi, në fakt ka kryer 16 angazhime auditimi, duhet të theksojmë se kjo NJAB ka lënë jashtë programimit të gjitha drejtoritë e aparatit të ministrisë duke audituar vetëm ambasadat jashtë vendit.

Kjo njësi nuk ka dërguar zyrtarisht kopje të raporteve finale të auditimit për monitorim nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Në lidhje me raportimin vjetor megjithëse i është përmbajtur strukturës së kërkuar dhe është bërë identifikimi i risqeve, kërkohet një vlerësim më i thelluar i sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 5 punonjës (1 drejtues dhe 4 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe të trajnuar. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, sipas tabelës më poshtë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes është vlerësuar me 525 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të kënaqshme të kësaj ministrie dhe e renditur në vendin e dytë në rankimin e Ministrive të Vogla. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë.

Tabela 24. Vlerësimi i indikatorëve për MZHETTS

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	30	1.4%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	30	2.3%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga Thesari	30	0.0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	25	3.4%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	25	2.8%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0.0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	15	6.9%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	15	8%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi	15	11.6%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	25	5%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4
12. Menaxhimi i Riskut	20	3
13. Aktivitetet e kontrollit	30	4
14. Informimi dhe komunikimi	30	4
15. Monitorimi	30	4
16. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
18. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25	
20. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

- Indikator i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë ministri, gjatë vitit 2015, vetëm 1.4% e faturave janë regjistruar në Thesar për më shumë se 30 ditë nga data e faturimit të tyre. Kjo përqindje tregon për një numër të madh të faturave të shpenzimeve të kontraktuara, të cilat janë paraqitur në Thesar për më pak se 30 ditë nga data e pagesës sipas kontratës, gjë e cila tregon për një performancë shumë të kënaqshme të ministrisë në këtë aspekt. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë ministri, është 30 pikë, pra një vlerësim maksimal për këtë vit. Pra, si përfundim mund të themi që nuk ka pasur pengesa në veprimtarinë e përditshme të këtij institucioni për shkak të vonësave në dërgimin e faturave në thesar.
- Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator performance i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit. Njësitë publike shpesh herë anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2015, raporti i kontratave të anuluar gjatë këtij viti buxhetor me totalin e kontratave të nënshkruara është 2.3%, një nivel shumë i kënaqshëm, ndaj dhe vlerësimi sipas metodologjisë është maksimal, pra 30 pikë.
- Për kryerjen e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e udhëzimit për zbatimin e buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. Ndaj, si tregues më vete në këtë analizë, është vlerësuar dhe indikator i **Urdhër-**

Shpenzimeve të refuzuara nga Thesari. Nga analiza, vihet re që gjatë vitit 2015, të gjitha urdhër-shpenzimet e ministrisë janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë e shkëlqyer në këtë drejtim.

4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, ky institucion karakterizohet nga një numër i ulët i kontratave të paraqitura me vonesë në Thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 3.4%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e dytë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 25 pikë. Këto pikë tregojnë për një performancë të kënaqshme, por akoma ka vend për përmirësime të mëtejshme.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikator i fundit i gjeneruar nga Thesari, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimeve Publike, me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 2.8%. Kjo përqindje do të thotë që pjesa më e madhe e urdhër-prokurimeve kanë qënë të autorizuara kur janë paraqitur në APP, megjithatë mund të bëhen përmirësime të mëtejshme në këtë aspekt për të arritur performancë maksimale. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 25 pikë.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit

6. Duke u bazuar në raportet tremujore të monitorimit, që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit të dhënë. Sipas analizës së mësipërme, MZHETTS i ka dorëzuar të katër raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.
7. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për një vit të dhënë. Gjatë vitit 2015, ky institucion ka realizuar 93.10% të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është rreth 6.9%. Të shoqëruar dhe nga arsyet e mosrealizimit të këtyre shpenzimeve, vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë është 15 pikë, duke qënë se kjo përqindje i përket intervalit të tretë të këtij sistemi vlerësimi. Pra, menaxhimi i kësaj kategorie të fondeve publike nga ky institucion ka qënë në nivele mesatare.
8. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale** është një indikator tjetër i marrë në shqyrtim. Ky indikator na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për një vit të dhënë. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ka realizuar rreth 92% të shpenzimeve kapitale të planifikuara, duke rezultuar në këtë mënyrë në një nivel më të lartë mosrealizimi të shpenzimeve kapitale (8%) në krahasim me ato korrente (6.9%). Megjithatë, vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë së monitorimit është 15 pikë, duke qënë se përqindja e mësipërme i përket intervalit të tretë të këtij sistemi vlerësimi.
9. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2015 ka qënë 31 dhe shuma në lekë e këtyre rialokimeve ka qënë 167,047. Pavarësisht, numrit të lartë të rialokimeve të bëra gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në%) është 11.6%. Duke

qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, pikët për këtë institucion përse i përket këtij indikator janë 15 pikë. Ndaj, si përfundim mund të themi që bazuar dhe në arsyet e bërjes së këtyre rialokimeve, institucioni duhet të marrë masa në të ardhmen për të shmangur devijimet nga fondet e miratuara, për të shkuar drejt një performace më të mirë.

10. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikator i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Buxheti. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për MZHETTS, gjatë vitit 2015 janë krijuar rreth 5% detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar. Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është 25 pikë, duke na treguar për një performancë të kënaqshme në këtë aspekt.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për MZHETTS, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.8 pikë, ndaj dhe ka marrë 30 pikë të mundshme maksimale. Menaxhimi i riskut është vlerësuar mesatarisht 2.8 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Aktivitetet e kontrollit, Informimi dhe komunikimi si dhe Monitorimi kanë marrë mesatarisht 4 pikë, duke u vlerësuar maksimalisht me 30 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele shumë të kënaqshme, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, kryesisht, në kuadër të përmirësimit të komponentit të Menaxhimit të riskut, i cili është vlerësuar më pak në krahasim me të tjerët.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes**, paraqet indikatorët e mëposhtëm.

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. Kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë, sepse për vitin 2015, të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Aktualisht kjo NJAB ka vakant pozicionin e drejtuesit të njësisë.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm. Kjo NJAB prej vitesh ka një përpikmëri të lartë në lidhje me afatet e raportimit dhe ka marrë vlerësimet maksimale. (30 pikë)

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm. Për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i detajuar sipas përcaktimeve të metodologjisë. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm. Kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar dhe realizuar 22 misione auditimi. Nga monitorimi i raporteve finale të auditimit konstatohen mangësi në drejtim të zbatimit të standardeve të AB, pasi janë propozuar në disa raste masa disiplinore, kur duhej rekomanduar përmirësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Në lidhje me raportin vjetor, theksojmë se kjo njësi i është përmbajtur strukturës së miratuar të raportimit. Por për një cilësi sa më të mirë të raporteve kërkohet një vlerësim sa më i detajuar i sistemeve të kontrollit të brendshëm për angazhimet e auditimit të kryera. Ky detajim duhet bërë në të ardhmen për çdo komponent të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 5 punonjës (1 drejtues dhe 4 specialistë), por aktualisht kjo NJAB nuk ka drejtuesin e njësisë. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Zhvillimit Urban për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Zhvillimit Urban është vlerësuar me 525 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë mjaft të kënaqshme të kësaj ministrie dhe e renditur në vendin e dytë në rankimin e Ministrive të Vogla. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë si në tabelën më sipër.

Tabela 25. Vlerësimi i indikatorëve për MZHU

Ministria e Zhvillimit Urban	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	30	0.31%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	15	8%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara Thesari	30	0.8%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	15.4%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	15	10%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	30	1.3%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	25	5.0%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	15	8.6%
10. Shlyerja e detyrimeve të prapambetura	30	0%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4
12. Menaxhimi i Riskut	30	4
13. Aktivitetet e kontrollit	30	4
14. Informimi dhe komunikimi	30	4
15. Monitorimi	30	4
16. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
18. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilesia e raportimit të audituesve të brendshëm	25	
20. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	25	

Më poshtë, paraqitet një analizë e detajuar për çdo indikator të monitorimit:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikator i parë i analizuar është Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar. Për këtë ministri gjatë vitit 2015 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 0.31% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mjaft të kënaqshëm të realizimit të këtij indikator. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njërive publike për këtë ministri, është 30 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikator i përket nivelit të parë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të

këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2015, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 8%, çka flet për një nivel jo shumë të mirë të realizimit të këtij indikator, pra vlerësohet me 15 pikë.

3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, pothuajse të gjitha urdhër-shpenzimet e Ministrisë së Zhvillimit Urban janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, ky institucion karakterizohet nga një numër i konsiderueshëm i kontratave të paraqitura me vonesë në Thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në Thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 15.4%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e tretë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 15 pikë. Këto pikë tregojnë për një performancë jo të kënaqshme.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikator i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 10%. Kjo përqindje do të thotë që një pjesë e urdhër-prokurimeve kanë qënë të paautorizuara kur janë paraqitur në APP. Në këtë aspekt bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 15 pikë.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit

6. Duke u bazuar në raportet tremujore të monitorimit, që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria e Zhvillimit Urban i ka dorëzuar të katër raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.
7. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për një vit buxhetor. Gjatë vitit 2015, ky institucion ka realizuar 98.7% të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është rreth 1.3%. Të shoqëruar dhe nga arsyet e mosrealizimit të këtyre shpenzimeve, vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë është 30 pikë, çka flet për një performancë shumë të mirë të këtij institucioni.
8. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale**, ky indikator gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Indikator na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Zhvillimit Urban ka realizuar rreth 95% të shpenzimeve kapitale të planifikuara, duke evidencuar në këtë mënyrë në një nivel të ulët mosrealizimi të shpenzimeve kapitale (5%) krahasuar edhe me ato korrente (1.3%). Vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë

së monitorimit është vlerësuar me 25 pikë, duke qënë se përqindja e mësipërme i përket intervalit të dytë të këtij sistemi vlerësimi.

9. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2015 ka qënë 20 dhe shuma në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qënë 207,410. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në%) është 8.6%. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, pikët për këtë institucion përsa i përket këtij indikator janë 15 pikë. Ndaj, si përfundim mund të themi që Ministria e Zhvillimit Urban ka një performance jo të kënaqshme për këtë indikator.
10. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikator i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Zhvillimit Urban, gjatë vitit 2015 nuk janë krijuar detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar. Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është 30 pikë maksimale.

Drejtorja e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Ministrinë e Zhvillimit Urban, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 4 pikë, ndaj dhe ka marrë 30 pikë. Menaxhimi i riskut është vlerësuar mesatarisht 4 pikë, duke marrë 30 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Ndërsa aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar me 30 pikë me një mesatare 3.7 pikë. Informimi dhe komunikimi si dhe Monitorimi kanë marrë mesatarisht 3.7 dhe 4 pikë, duke u vlerësuar maksimalisht me 30 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele shumë të kënaqshme, duke theksuar këtu vlerësimin maksimal të të gjithë komponentëve.

Drejtorja e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Zhvillimit Urban**, paraqet indikatorët e mëposhtëm.

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. Kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2015, të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Aktualisht kjo NJAB ka vakant pozicionin e një specialisti të njësisë.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB prej vitesh ka një përpikmëri në lidhje me afatet e raportimit dhe ka marrë vlerësimet maksimale. (30 pikë)

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i detajuar sipas përcaktimeve të metodologjisë. (30 pikë).

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar 16 dhe ka realizuar 20 misione auditimi. Nga monitorimi i raporteve finale të auditimit, vihet re se bazuar në standardet dhe në ligjin e auditimit, janë kryer dy angazhime këshillimi, që mbështesin eksperincën profesionale të audituesve të brendshëm në MZHU. Nga ana tjetër janë konstatuar dhe mbivendosje të angazhimeve ku mund të përmenden 5 angazhime auditimi që i përkasin NJAB në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNIT dhe Entit Kombëtar të Banesave si: Dr.Përgj. Aluiznit Tiranë, Drejtoritë Rajonale Vlorë, Shkodër, Kukës, Durrës, Drejtoritë Rajonale EKB Tiranë dhe Dr. Pergj. Entit Kombëtar të Banesave.

Në lidhje me raportin vjetor, theksojmë se kjo njësi i është përmbajtur strukturës së miratuar të raportimit. Por për një cilësi sa më të mirë të raporteve kërkohet një vlerësim sa më i detajuar i sistemeve të kontrollit të brendshëm për angazhimet e auditimit të kryera. Ky detajim duhet bërë në të ardhmen për çdo komponent të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuar. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 5 punonjës (1 drejtues dhe 4 specialistë), dhe aktualisht kjo NJAB nuk ka një auditues të brendshëm. (25 pikë).

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Mbrojtjes është vlerësuar me 505 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të kënaqshme të kësaj ministrie dhe e renditur në vendin e katërt në rankimin e Ministrive të Vogla. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 26. Vlerësimi i indikatorëve për MM

Ministria e Mbrojtjes	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	15	8.2%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	15	11.2%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara Thesari	30	0.1%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	24.4%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	15	22.6%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0.0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	30	1.6%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	30	0.3%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	30	1.7%
10. Shlyerja e detyrimeve të prapambetura	30	0%
11. Mjedisi i kontrollit	20	3
12. Menaxhimi i Riskut	20	3
13. Aktivitetet e kontrollit	30	4
14. Informimi dhe komunikimi	30	4
15. Monitorimi	30	4
16. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
18. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15	
20. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuar	30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikator i parë i analizuar është Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar. Për këtë ministri gjatë vitit 2015 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 8.2% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel jo të kënaqshëm të realizimit të këtij indikator. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës

së njësive publike për këtë ministri, është 15 pikë duke qënë se mosrealizimi i këtij indikator i përket nivelit të tretë.

2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2015, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 11.2%, çka flet për një nivel jo shumë të mirë të realizimit të këtij indikator, pra vlerësohet me 15 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari përfaqson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, pothuajse të gjitha urdhër-shpenzimet e Ministrisë së Mbrojtjes janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, ky institucion karakterizohet nga një numër i konsiderueshëm i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në Thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 24.4%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e tretë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 15 pikë. Këto pikë tregojnë për një performancë jo të kënaqshme.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikator i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 22.6%. Kjo përqindje do të thotë që një pjesë e madhe e urdhër-prokurimeve kanë qënë të paautorizuara kur janë paraqitur në APP. Në këtë aspekt bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 15 pikë.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit

6. Duke u bazuar në raportet tremujore të monitorimit, që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria e Mbrojtjes i ka dorëzuar të katër raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.
7. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për një vit buxhetor. Gjatë vitit 2015, ky institucion ka realizuar 98.4% të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është rreth 1.6%. Të shoqëruar dhe nga arsyet e mosrealizimit të këtyre shpenzimeve, vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë është 30 pikë, çka flet për një performancë shumë të mirë të këtij institucioni.
8. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale**, ky indikator gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Indikator na evidencon masën në të cilën janë

realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Mbrojtjes ka realizuar rreth 99.7% të shpenzimeve kapitale të planifikuara, duke evidencuar në këtë mënyrë në një nivel shumë të ulët mosrealizimi të shpenzimeve kapitale (0.3%) krahasuar edhe me ato korrente (1.6%). Vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë së monitorimit është vlerësuar maksimalisht me 30 pikë, duke qënë se përqindja e mësipërme i përket intervalit të parë të këtij sistemi vlerësimi.

9. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2015 ka qënë 8 dhe shuma në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qënë 213,802. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në%) është 1.7%. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, pikët për këtë institucion përsa i përket këtij indikator janë 30 pikë maksimale. Ndaj, si përfundim mund të themi që Ministria e Mbrojtjes ka një performance shume të mirë për këtë indikator.
10. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikator i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Mbrojtjes, gjatë vitit 2015 nuk janë krijuar detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar. Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është 30 pikë maksimale.

Drejtorja e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Ministrinë e Mbrojtjes, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.4 pikë, ndaj dhe ka marrë 20 pikë. Menaxhimi i riskut është vlerësuar mesatarisht 2.8 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Ndërsa aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar me 30 pikë. Informimi dhe komunikimi si dhe Monitorimi kanë marrë mesatarisht 4 pikë, duke u vlerësuar me 30 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, kryesisht, në kuadër të përmirësimit të komponentit të Menaxhimit të riskut, i cili mesatarisht është vlerësuar më pak në krahasim me të tjerët.

Drejtorja e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Mbrojtjes** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2015, të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin dhe planifikimin vjetor dhe është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor duhej dhënë arsyetimi i detajuar sipas përcaktimeve të metodologjisë. Ky arsyetim nuk është plotësuar dhe ky fakt ka ndikuar në vlerësimin e cilësisë së raportimit. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar 30 angazhime auditimi, në fakt ka kryer 34 angazhime auditimi, nga të cilat 14 angazhime janë për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve, ky tregues ndikon në uljen e efektivitetit dhe rritjen e kostos së auditimit. Duhet theksuar se kjo njësi nuk ka planifikuar dhe nuk ka realizuar asnjë

angazhim auditimi për vetë institucionin e ministrisë, si një njësi e rëndësishme shpenzuese e fondeve buxhetore, duke dobësuar rolin dhe misionin që i ngarkon ligji i auditimit.

Në lidhje me raportimin vjetor megjithëse i është përmbajtur strukturës së kërkuar nuk është bërë një analizë e thelluar në trajtimin e fushave me risk, gjetjet e konstatuara për këtë periudhë dhe sidomos një vlerësim shumë i cekët i sistemeve të kontrollit të brendshëm. Kjo njësi nuk ka dërguar raportet finale të auditimit për monitorim pranë Drejtorisë së Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuar. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 9 punonjës (1 drejtues dhe 8 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe të trajnuar. (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Mjedisit për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Mjedisit është vlerësuar me 495 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë mesatare të kësaj ministrie e cila është e renditur në vendin e pestë në rankimin e Ministrive të Vogla. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 27. Vlerësimi i indikatorëve të MM

Ministria e Mjedisit	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	25	3.14%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	15	14.28%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga Thesari	30	0.35%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	5.54%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0.51%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	15	6.3%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	30	1.6%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	25	3.98%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	25	3%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4
12. Menaxhimi i Riskut	20	3
13. Aktivitetet e kontrollit	30	4
14. Informimi dhe komunikimi	30	4
15. Monitorimi	30	4
16. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	15	
18. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15	
20. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuar	25	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë kjo ministri gjatë vitit 2015 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 3.14% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të mirë të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njërive publike për Ministrinë e Mjedisit është 25 pikë duke qenë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të dytë të vlerësimit.
2. Anulimi i kontratave gjatë vitit është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2015, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 14.28%, çka flet për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet me 15 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, 0.35% e urdhër-shpenzimet të Ministrisë së Mjedisit janë paraqitur në thesar në mënyrën jo të duhur. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë mjaft e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikatori i **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, ky institucion karakterizohet nga një performancë mesatare pasi 5.54% e numrit të kontratave të dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me 15 pikë pasi ndodhet në nivelin e tretë të vlerësimit.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qenë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuara në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0.51%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë shumë të mirë lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është maksimal 30 pikë.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit

1. Duke u bazuar në raportet tremujore të monitorimit, që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria e Mjedisit i ka dorëzuar të katër raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.
2. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për vitin buxhetor. Gjatë vitit 2015, ky institucion ka realizuar 93.7% të planit të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është rreth 6.3%. Të shoqëruar dhe nga arsyet e mosrealizimit të këtyre shpenzimeve, vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë është 15 pikë, çka flet për një performancë mesatare të këtij indikatori.

3. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale**, është indikator që gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Ky indikator evidencon masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Mjedisit ka realizuar këto shpenzime në masën 98.4% dhe ka një mosrealizim të këtyre shpenzimeve me 1.6%. Vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë së monitorimit është vlerësuar me 30 pikë maksimale, çka flet për një nivel shumë të mirë të këtij indikator.
4. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, **numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2015 ka qënë 7 dhe shuma e shprehur në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qënë 95.568 lekë**. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në%) është 3.98%. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, vlerësimi në pikë për këtë institucion përsa i përket këtij indikator është 25 pikë. Ndaj, si përfundim mund të themi që Ministria e Mjedisit ka një performancë të mirë për këtë indikator.
5. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikator i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Shëndetësisë, gjatë vitit 2015 nuk janë krijuar detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar (0%). Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është maksimal, 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Ministrinë e Mjedisit, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.7 pikë, gjë që i referohet nivelit të parë të vlerësimit e barabartë me 30 pikë. Komponenti “Menaxhimi i riskut” arrin në një nivel vlerësimi me 3 pikë, duke i korresponduar kështu nivelit të dytë të vlerësimit me 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Ndërsa për aktivitetet e kontrollit dhe Informimi dhe komunikimi kanë marrë 30 pikë maksimale pasi janë vlerësuar respektivisht me 4 pikë secila. Ashtu si komponentët e sipërpermendur, edhe Monitorimi është vlerësuar me 30 pikë pasi ka marrë mesatarisht 4 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Mjedisit** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. Kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2015, të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB nuk ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 15 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar 23 angazhime auditimi, në fakt ka kryer 20 angazhime auditimi, duhet të theksojmë se kjo NJAB ka lënë jashtë programimit të gjitha drejtoritë e aparatit të ministrisë duke audituar vetëm njësitë e

varësisë. NJAB ka një ndryshim të pa argumentuar të llojit të auditimeve të kryera (plan 5 A.Përputhshmërie/Fakt 2 Ndjekje Zbatim Rekomandimesh).

Kjo njësi nuk ka dërguar zyrtarisht kopje të raporteve finale të auditimit për monitorim nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Në lidhje me raportimin vjetor megjithëse i është përmbajtur strukturës së kërkuar dhe është bërë identifikimi i risqeve, kërkohet një vlerësim më i thelluar i sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 5 punonjës (1 drejtues dhe 4 specialistë), në fakt ka një vend të pa plotësuar të audituesit e brendshëm. (25 pikë)

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Kulturës për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Kulturës është vlerësuar me 485 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë jo shumë të mirë të kësaj ministrie dhe e renditur në vendin e gjashtë në rankimin e Ministrive të Vogla. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015, sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna, janë:

Tabela 28. Vlerësimi i indikatorëve të MK

Ministria e Kulturës	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	15	13.1%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	15	16.1%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga Thesari	30	1.2%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0.7%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	1.1%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	25	2.9%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	15	5.8%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	15	11%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	30	0%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4
12. Menaxhimi i Riskut	30	4
13. Aktivitetet e kontrollit	20	3
14. Informimi dhe komunikimi	20	3
15. Monitorimi	20	3
16. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
18. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15	
20. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	25	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikator i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë kjo ministri gjatë vitit 2015 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 13.1% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të kënaqshëm të realizimit të këtij indikator. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njërive publike për Ministrinë e Kulturës, është 15 pikë duke qenë se mosrealizimi i këtij indikator i përket nivelit të tretë të vlerësimit.
2. Anulimi i kontratave gjatë vitit është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2015, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 16.1%, çka flet për një nivel të mesatar të realizimit të këtij indikator, pra vlerësohet me 15 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, 1.2% e urdhër-shpenzimet të Ministrisë së Kulturës janë paraqitur në thesar në mënyrën jo të duhur. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikator i **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, ky institucion karakterizohet nga një performancë e kënaqshme pasi vetëm 0.7% e numrit të kontratave të dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me 30 pikë maksimale.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikator i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qenë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publik (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuara në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 1.1%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë shumë të mirë lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë maksimale.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit

1. Duke u bazuar në raportet tremujore të monitorimit, që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria e Kulturës i ka dorëzuar të katër raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.
2. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për vitin buxhetor. Gjatë vitit 2015, ky institucion ka realizuar 97.1% të planit të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është rreth 2.9%. Të shoqëruar dhe nga arsyet e mosrealizimit të këtyre shpenzimeve, vlerësimi i këtij

indikator sipas metodologjisë është 25 pikë, çka flet për një performancë të kënaqshme të këtij indikator.

3. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale**, është indikator që gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Ky indikator evidencon masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Kulturës ka realizuar këto shpenzime në masën 94.2% dhe ka një mosrealizim të këtyre shpenzimeve me 5.8%. Vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë së monitorimit është vlerësuar me 15 pikë çka flet për një nivel mesatar të këtij indikator.
4. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, **numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2015 ka qenë i lartë me 58 rialokime dhe shuma e shprehur në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qenë 165.745**. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në%) është 11%. Duke qenë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, vlerësimi në pikë për këtë institucion përsa i përket këtij indikator është 15 pikë, çka flet për një performancë mesatare të këtij indikator.
5. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikator i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Kulturës, gjatë vitit 2015 nuk janë krijuar detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar (0%). Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është maksimal, 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Ministrinë e Kulturës, mjedisi i kontrollit dhe menaxhimi i riskut janë vlerësuar mesatarisht me 3.6 dhe 3.5 pikë secila, gjë që i referohet nivelit të parë të vlerësimit e barabartë me 30 pikë. Këto janë dy indikatorët që janë vlerësuar me pikët maksimale. Aktivitetet e kontrollit, Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi kanë marrë përkatësisht nga 20 pikë pasi janë vlerësuar respektivisht me 3.4, 3 dhe 3.2 pikë secila.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Kulturës** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2015, të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor duhej dhënë arsyetim më i detajuar sipas përcaktimeve të metodologjisë. Ky arsyetim nuk është plotësuar dhe ky fakt ka ndikuar në vlerësimin e cilësisë së raportimit. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar 27 angazhime auditimi, në fakt ka kryer 29 angazhime auditimi, nga të cilat 11 angazhime për ndjekje dhe zbatim rekomandimesh, ky tregues ndikon në uljen e efektivitetit dhe rritjen e kostos së auditimit. Nga kjo njësi është shmangur auditimi i vetë institucionit, si njësi të rëndësishme shpenzuese të fondeve buxhetore, duke dobësuar rolin dhe misionin që i ngarkon ligji i auditimit.

Kjo njësi nuk ka dërguar zyrtarisht kopje të raporteve finale të auditimit për monitorim nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Në lidhje me raportimin vjetor megjithëse i është përmbajtur strukturës së kërkuar dhe është bërë identifikimi i risqeve, kërkohet një vlerësim më i thelluar i sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuar. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 5 punonjës (1 drejtues dhe 4 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm në detyrë janë të certifikuar dhe të trajnuar. Aktualisht ka një vend të pa plotësuar të audituesit të brendshëm. (25 pikë)

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Energjisë dhe Industrisë është vlerësuar me 481 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë jo të mirë të kësaj ministrie e cila është e renditur në vendin e shtatë. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë si në tabelën në vijim.

Tabela 29. Vlerësimi i indikatorëve të MEI

Ministria e Energjisë dhe Industrisë	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	15	7.7%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga Thesari	15	8%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	14%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	15	17%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	25	
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	25	3%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	25	3.24%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	15	17.6%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	30	0%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4
12. Menaxhimi i Riskut	30	4
13. Aktivitetet e kontrollit	30	4
14. Informimi dhe komunikimi	30	4
15. Monitorimi	30	4
16. Përgatitja e audituesve të brendshëm	21	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	25	
18. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15	
20. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuar	30	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë kjo ministri gjatë vitit 2015 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 7.7% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, është 15 pikë duke qenë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të tretë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2015, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të mirë të realizimit të këtij indikatori, pra vlerësohet maksimalisht me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, 8% e urdhër-shpenzimeve të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë janë paraqitur në thesar në mënyrën jo të duhur. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është 15 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë në nivel mesatar në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikatori i **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, ky institucion karakterizohet nga një performancë jo e kënaqshme pasi 14% e numrit të kontratave të dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me 15 pikë pasi ndodhet në nivelin e tretë të vlerësimit.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qenë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuara në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 17%. Kjo përbindje do të thotë që institucioni nuk ka një performancë të mirë lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 15 pikë.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit

1. Duke u bazuar në raportet tremujore të monitorimit, që ministrinë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Raportet e monitorimit të buxhetit duhet të plotësojnë kriterin e saktësisë dhe konsistencës, si edhe parashikohet në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin. Ministria e Energjisë dhe Industrisë është vlerësuar për këtë indikator me 25 pikë që i referohet një niveli të mirë të vlerësimit.
2. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për vitin buxhetor. Gjatë vitit 2015, ky institucion ka realizuar 97% të planit të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është rreth 3%. Të shoqëruar dhe nga arsyet e mosrealizimit të këtyre shpenzimeve, vlerësimi i këtij indikatori sipas metodologjisë është 25 pikë, çka flet për një performancë të mirë të këtij indikatori.

3. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale**, është indikator që gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Ky indikator evidencon masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka realizuar këto shpenzime në masën 96.76% dhe ka një mosrealizim të këtyre shpenzimeve me 3.24%. Vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë së monitorimit është vlerësuar me 25 pikë, çka flet për një nivel të mirë të këtij indikator.
4. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, **numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2015 ka qënë 16 dhe shuma e shprehur në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qënë 470.808 lekë**. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në%) është 17.6%. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, vlerësimi në pikë për këtë institucion përsa i përket këtij indikator është 15 pikë. Ndaj, si përfundim mund të themi që Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka një performancë mesatare për këtë indikator.
5. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikator i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, gjatë vitit 2015 nuk janë krijuar detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar (0%). Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është maksimal, 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.8 pikë, gjë që i referohet nivelit të parë të vlerësimit e barabartë me 30 pikë. Komponenti "Menaxhimi i riskut" arrin në një nivel vlerësimi me 3.8 pikë, duke i korresponduar kështu të njëjtit nivel vlerësimi me 30 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Ndërsa edhe aktivitetet e kontrollit dhe Informimi dhe komunikimi kanë marrë 30 pikë pasi janë vlerësuar respektivisht me 4 dhe 3.8 pikë secila. Ashtu si komponentët e sipërpermendur, edhe Monitorimi është vlerësuar me 30 pikë pasi ka marrë mesatarisht 3.8 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. Kjo NJAB është vlerësuar me 21 pikë sepse për vitin 2015, 2 nga audituesit e brendshëm janë të pa certifikuar kurse audituesit e tjerë janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB nuk ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 25 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetim i detajuar sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar 29 angazhime auditimi, në fakt ka kryer 30 angazhime auditimi, duhet të theksojmë se kjo NJAB megjithëse ka tejkallim plani ka një ndryshim të pa argumentuar të llojit të auditimeve të kryera si dhe megjithëse ka planifikuar një auditim të aparatit të ministrisë nuk e ka realizuar atë, duke

patur parasysh që kjo ministri është një institucion i rëndësishëm shpenzues i fondeve buxhetore.

Kjo njësi ka kryer auditime të mbivendosura me njësitë e auditimit të brendshëm në Albpetrol, OST dhe KESH. Kjo njësi nuk ka dërguar zyrtarisht kopje të raporteve finale të auditimit për monitorim në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Në lidhje me raportimin vjetor megjithëse i është përmbajtur strukturës së kërkuar dhe është bërë identifikimi i risqeve, por kërkohet një vlerësim më i thelluar i sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 7 punonjës (1 drejtues dhe 6 specialistë), ku 5 nga audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe të trajnuar, dy nga audituesit e brendshëm janë të pa certifikuar. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Ministrinë e Integritimit Evropian për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Ministria e Integritimit është vlerësuar me 475 pikë nga 600 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë jo të kënaqshme të kësaj ministrie, e cila është renditur në vendin e tetë në rankimin e Ministrive të Vogla. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 30. Vlerësimi i indikatorëve të MIE

Ministria e Integritimit Evropian	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	15	6.7%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara Thesari	25	3.3%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	10	28%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	10	28%
6. Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit	30	0%
7. Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente gjatë një viti	30	0%
8. Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale	10	27.4%
9. Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve	30	0.93%
10. Krijimi i detyrimeve të prapambetura	30	2%
11. Mjedisi i kontrollit	30	4
12. Menaxhimi i riskut	20	3
13. Aktivitetet e kontrollit	20	3
14. Informimi dhe komunikimi	30	4
15. Monitorimi	30	4
16. Përgatitja e audituesve të brendshëm	20	
17. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
18. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
19. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15	
20. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë ministri gjatë vitit 2015 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 6.7% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel jo të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë ministri, është 15 pikë duke qenë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të tretë.
2. Anulimi i kontratave gjatë vitit është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2015, për ministrinë në fjalë nuk kemi asnjë kontratë të anuluar, pra raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhërshpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhërshpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në Thesar është 3.3%, pra vetëm 3.3% e tyre nuk janë paraqitur në Thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 25 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, ky institucion karakterizohet nga një numër i konsiderueshëm i kontratave të paraqitura me vonesë në Thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në Thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 28%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e katërt të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 10 pikë. Këto pikë tregojnë për një performancë jo të kënaqshme si dhe theksojnë nevojën për marrjen e masave të menjëhershme në këtë drejtim.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qenë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 28%. Kjo përqindje do të thotë që një pjesë e madhe e urdhër-prokurimeve kanë qenë të paautorizuara kur janë paraqitur në APP. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 10 pikë.

Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit

6. Duke u bazuar në raportet tremujore të monitorimit, që ministritë dorëzojnë pranë Drejtorisë së Buxhetit, një nga indikatorët e marrë në analizë është **Saktësia dhe Konsistenca e Raportimeve** për një vit buxhetor. Ministria e Integritimit Evropian i ka dorëzuar të katër raportet në mënyrë të saktë dhe brenda afatit. Ndaj, vlerësimi i marrë për këtë indikator është 30 pikë, që i referohet nivelit maksimal të vlerësimit, duke identifikuar faktin që raportet e kësaj ministrie i përmbushin kriteret e konsistencës dhe

saktësisë në të njëjtën mënyrë që parashikohet dhe në Udhëzimin për monitorimin e buxhetit dhe raportimin.

7. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Raporti fakt/plan i shpenzimeve korrente**, i cili na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet korrente të planifikuara për një vit buxhetor. Gjatë vitit 2015, ky institucion ka realizuar 100% të shpenzimeve korrente, që do të thotë që niveli i mosrealizimit është 0%. Bazuar në këtë performancë të ministrisë përkatëse, vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë është 30 pikë, pra vlerësim me pikët maksimale të mundshme.
8. **Raporti fakt/plan i shpenzimeve kapitale**, ky indikator gjenerohet gjithashtu nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Indikatorin na evidenton masën në të cilën janë realizuar shpenzimet kapitale të planifikuara për vitin analizues. Ministria e Integritit ka realizuar rreth 72.6% të shpenzimeve kapitale të planifikuara, duke evidencuar në këtë mënyrë në një nivel shumë të lartë mosrealizimi të shpenzimeve kapitale (27.4%) krahasuar edhe me ato korrente (0%). Vlerësimi i këtij indikator sipas metodologjisë së monitorimit është 10 pikë, duke qënë se përqindja e mësipërme i përket intervalit të katërt të këtij sistemi vlerësimi.
9. Një indikator tjetër i rëndësishëm është **Deviacioni mesatar i fondeve të miratuara nga Kuvendi dhe numri i rialokimeve**. Për këtë institucion, numri i rialokimeve të bëra gjatë vitit 2015 ka qënë 4 dhe shuma në 000/lekë e këtyre rialokimeve ka qënë 2,290. Gjatë këtij viti, pesha që zë shuma e këtyre rialokimeve ndaj fondeve të miratuara nga Parlamenti (në%) është 0.93%. Duke qënë se vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës bëhet bazuar në përqindjen e mësipërme, pikët për këtë institucion përse i përket këtij indikator janë 30 pikë maksimale. Ndaj, si përfundim mund të themi që Ministria e Integritit ka një performancë shume të mirë për këtë indikator.
10. **Krijimi i detyrimeve të prapambetura** është indikatorin i fundit i analizuar, i cili gjenerohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Gjatë vitit buxhetor nuk duhet të krijohen detyrime të prapambetura dhe nëse ato krijohen, duhet të shlyhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Për Ministrinë e Integritit, gjatë vitit 2015, janë krijuar 2% detyrime të prapambetura ndaj planit të buxhetit të miratuar. Bazuar në këtë analizë, vlerësimi me pikë që ka marrë ky indikator është 30 pikë maksimale.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Ministrinë e Integritit, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.6 pikë, ndaj dhe ka marrë 30 pikë. Menaxhimi i riskut është vlerësuar mesatarisht 3.2 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Gjithashtu, aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar mesatarisht me 3.2 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë. Informimi dhe komunikimi si dhe Monitorimi kanë marrë mesatarisht 4 pikë, duke u vlerësuar me 30 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, kryesisht, në kuadër të përmirësimit të komponentit të Menaxhimit të riskut dhe Aktiviteteve të kontrollit, të cilët mesatarisht janë vlerësuar më pak në krahasim me të tjerët.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Ministrisë së Integritit** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Së pari, Njësia e Auditimit të Brendshëm të kësaj ministrie është ngritur në nivel sektori me emërtimin “Sektori i Kontrollit të Brendshëm”, emërtim i cili është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për auditimin.

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 20 pikë sepse për vitin 2015, dy nga audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe një i pacertifikuar dhe të gjithë

kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në aktet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsytim i zgjedhjes sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar dhe realizuar 6 angazhime auditimi.

Kjo njësi ka dërguar zyrtarisht kopje të raporteve finale të auditimit për monitorim nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Në lidhje me raportimin vjetor dhe me monitorimin e raporteve kërkohet një analizë më e thellë e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe trajtim i risqeve të identifikuara.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të paplotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë), ku 1 auditues i brendshëm është i pa certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimin e vijueshëm profesional të gjithë audituesit e brendshëm. Kjo njësi nuk ka pozicione aktuale të pa plotësuara. (30 pikë)

❖ Monitorimi i Performancës për Bashkitë Kryesore

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Durrës për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Durrës është vlerësuar me 425 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, e cila është e renditur në vendin e parë. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë si në tabelën në vijim.

Tabela 31. Vlerësimi i indikatorëve për Bashkinë Durrës

Bashkia Durrës	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	30	0.6%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga Thesari	30	1.5%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	30	4
8. Aktivitetet e kontrollit	30	4
9. Informimi dhe komunikimi	30	4
10. Monitorimi	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	25	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	25	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikator i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë kjo bashki gjatë vitit 2015 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 0.6% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të shumë të mirë të realizimit të këtij indikator. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për Bashkinë Durrës, është 30 pikë duke qenë se mosrealizimi i këtij indikator i përket nivelit të parë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2015, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të shkëlqyer të realizimit të këtij indikator, pra vlerësohet me 30 pikë maksimale.
1. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, 1.5% e urdhër-shpenzimet të Bashkisë Durrës janë paraqitur në Thesar në mënyrën jo të duhur. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është maksimal me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
2. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikator i **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, ky institucion karakterizohet nga një performancë e shkëlqyer pasi të gjitha kontratat e dorëzuara kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me 30 pikë maksimale.
3. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikator i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qenë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Kjo përbindje do të thotë që institucioni ka një performancë të shkëlqyer lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë maksimale.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Bashkinë Durrës, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.9 pikë, gjë që i referohet nivelit të parë të vlerësimit e barabartë me 30 pikë. Komponenti “Menaxhimi i riskut” dhe “Aktivitete e Kontrollit” arrijnë në të njëjtin nivel vlerësim me 3.8 dhe 3.7 pikë secila, duke i korresponduar kështu të njëjtit nivel vlerësimi me 30 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Gjithashtu edhe Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi kanë marrë 30 pikë pasi janë vlerësuar me 4 pikë secila. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele shumë të mira.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Durrës** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2015, audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB nuk ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 25 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar 17 angazhime auditimi dhe ka realizuar 16 angazhime auditimi, por duhet theksuar se ka ndryshuar llojin e auditimeve të realizuara, pa raportuar ndryshimet e planit në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Kjo njësi nuk ka dërguar zyrtarisht kopje të raporteve finale të auditimit për monitorim në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi nuk i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, nuk është bërë identifikimi i risqeve dhe kërkohet një analizë më e thelluar e situatës si dhe nuk është bërë vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuar. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 4 punonjës (1 drejtues dhe 3 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe të trajnuar. (25 pikë). Aktualisht është i pa plotësuar vendi i një specialisti të auditimit të brendshëm.

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Shkodër për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Shkodër është vlerësuar me 395 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të kënaqshme të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e dytë. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 32. Vlerësimi i indikatorëve për Bashkinë Shkodër

Bashkia Shkodër	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	30	0.1%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga Thesari	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	25	3%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	30	4
9. Informimi dhe komunikimi	30	4
10. Monitorimi	20	3
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	15	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuar	30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2015, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 0.01% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë ministri, është 30 pikë duke qenë se mosrealizimi shumë i ilët i këtij indikatori i përket nivelit të parë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2015, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, pra të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në Thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, ky institucion karakterizohet nga një numër i ulët i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në Thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 3%. Kjo përbindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e dytë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 25 pikë. Këto pikë tregojnë për një performancë të kënaqshme të bashkisë Shkodër në këtë drejtim.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qenë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Bashkinë Shkodër, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.6 pikë, ndaj dhe ka marrë 30 pikë. Menaxhimi i riskut është vlerësuar mesatarisht 2.8 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar mesatarisht me 3.6 pikë, duke marrë 30 pikë sipas metodologjisë. Informimi dhe komunikimi si dhe Monitorimi janë vlerësuar me 4 pikë dhe 3.25 pikë, duke grumbulluar respektivisht 30 pikë dhe 20 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, kryesisht, në kuadër të

përmirësimin të komponentit të Menaxhimit të riskut dhe Monitorimit, të cilët mesatarisht janë vlerësuar më pak në krahasim me të tjerët.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Shkodër** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2015, audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB nuk ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 15 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar 13 angazhime auditimi dhe ka realizuar 12 angazhime auditimi, por duhet theksuar se ka ndryshuar llojin e auditimeve të realizuara pa raportuar ndryshimet e planit në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Kjo njësi nuk ka dërguar zyrtarisht kopje të raporteve finale të auditimit për monitorim në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, por duhej të bënte më mirë identifikimin e risqeve dhe vlerësim më të thelluar të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektor, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe të trajnuar. (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Tiranë për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Tiranë është vlerësuar me 390 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë të kënaqshme të kësaj bashkie dhe e renditur në vendin e tretë. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela 33. Vlerësimi i indikatorëve për Bashkinë Tiranë

Bashkia Tiranë	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	30	1.55%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga Thesari	30	1.1%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	2.2%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	2.2%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	10	2
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3

10. Monitorimi	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	20	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	25	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2015, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 1.55% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për këtë bashki, është 30 pikë duke qenë se mosrealizimi shumë i ulët i këtij indikatori i përket nivelit të parë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2015, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 1.1%, pra pothuajse të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, ky institucion karakterizohet nga një numër i ulët i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar. Raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 2.2%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e parë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 30 pikë. Këto pikë tregojnë për një performancë shumë të kënaqshme të bashkisë Tiranë në këtë drejtim.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qenë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 2.2%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Bashkinë Tiranë, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.6 pikë, ndaj dhe ka marrë 30 pikë. Menaxhimi i riskut është vlerësuar mesatarisht 2 pikë, duke marrë 10 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar mesatarisht me 32.7 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë. Informimi dhe komunikimi si dhe Monitorimi janë vlerësuar me 3.1 pikë dhe 4 pikë, duke grumbulluar respektivisht 20 pikë dhe 30 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të mesatare, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, kryesisht, në kuadër të përmirësimit të komponentit të Menaxhimit të riskut, i cili ka marrë vlerësim shumë të ulët si dhe Aktivitete e kontrollit dhe Informimit dhe komunikimit, të cilët mesatarisht janë vlerësuar më pak në krahasim me të tjerët.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Tiranë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 20 pikë sepse për vitin 2015, një pjesë e audituesve të brendshëm nuk kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB nuk ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 25 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar 39 angazhime auditimi dhe ka realizuar 17 angazhime auditimi, por duhet theksuar se ka ndryshuar llojin e auditimeve të realizuara pa raportuar ndryshimet e planit në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Kjo njësi ka dërguar zyrtarisht kopje të raporteve finale të auditimit për monitorim në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, por duhej të thellohej më shumë në vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. Aktualisht NJAB në këtë institucion është e nivel drejtorie, e përbërë me 5 punonjës (1 drejtues dhe 4 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe të trajnuar (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Korçë për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Korçë është vlerësuar me 375 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, e cila është e renditur në vendin e katërt. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë si vijon.

Tabela 34. Vlerësimi i indikatorëve për Bashkinë Korçë

Bashkia Korçë	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	25	3.7%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	30	1.7%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga Thesari	25	2.9%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	25	5.4%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	15	8.9%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	30	4
10. Monitorimi	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	15	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	25	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	25	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

- Indikator i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë kjo bashki gjatë vitit 2015 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 3.7% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të kënaqshëm të realizimit të këtij indikator. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësisve publike për Bashkinë Korçë, është 25 pikë duke qenë se mosrealizimi i këtij indikator i përket nivelit të dytë të vlerësimit.
- Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2015, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 1.7%, çka flet për një nivel shumë të mirë të realizimit të këtij indikator, pra vlerësohet me 30 pikë maksimale.
- Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, 2.9% e urdhër-shpenzimet të Bashkisë Korçë janë paraqitur në Thesar në mënyrën jo të duhur. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 25 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë e kënaqshme në këtë drejtim.
- Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikator i **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, ky institucion karakterizohet nga një performancë e kënaqshme pasi të 5.4% e kontratat e dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me 25 pikë.

1. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikator i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 8.9%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë mesatare lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 15 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Bashkinë Korçë, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.5 pikë, gjë që i referohet nivelit të parë të vlerësimit e barabartë me 30 pikë. Komponenti “Menaxhimi i riskut” dhe “Aktivitete e Kontrollit” arrijnë në të njëjtin nivel vlerësim me 3.3 dhe 3.4 pikë secila, duke i korresponduar kështu të njëjtit nivel vlerësimi me 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Gjithashtu edhe Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi kanë marrë 30 pikë pasi janë vlerësuar me 4 pikë secila. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Korçë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 15 pikë sepse për vitin 2015, një nga audituesit e brendshëm nuk është certifikuar dhe nuk ka ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB nuk ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 25 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 25 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar dhe realizuar 5 angazhime auditimi, sipas fushave të planifikuara.

Kjo njësi ka dërguar zyrtarisht kopje të raporteve finale të auditimit për monitorim në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, por kërkohet një analizë më e thelluar e situatës si dhe një vlerësim më i mirë i sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuar. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë). Aktualisht Aktualisht është i pa plotësuar vendi i një specialisti të auditimit të brendshëm. (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Elbasan për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Elbasan është vlerësuar me 355 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë shumë të mirë të kësaj bashkie e cila është e renditur në vendin e pestë. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë si vijon.

Tabela 35. Vlerësimi i indikatorëve për Bashkinë Elbasan

Bashkia Elbasan	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	15	15.8%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga Thesari	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	8%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	15	10%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	30	4
10. Monitorimi	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	15	
13. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

- Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë kjo bashki gjatë vitit 2015 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 15.8% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të kënaqshëm të realizimit të këtij indikator. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njërive publike për Bashkinë Elbasan, është 15 pikë duke qenë se mosrealizimi i këtij indikator i përket nivelit të tretë të vlerësimit.
- Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2015, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të shkëlqyer të realizimit të këtij indikator, pra vlerësohet me 30 pikë maksimale.
- Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, 0% e urdhër-shpenzimet të Bashkisë Elbasan janë paraqitur në Thesar në mënyrën jo të duhur. Kjo tregon se të gjitha urdhër-shpenzimet janë paraqitur në thesar siç duhet. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë e shkëlqyer në këtë drejtim.
- Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikator i **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, ky

institucion karakterizohet nga një performancë mesatare pasi 8% e kontratave të dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me 15 pikë.

5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 10%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë jo shumë të kënaqshme lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 15 pikë.

Drejtorja e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Bashkinë Elbasan, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.5 pikë, gjë që i referohet nivelit të parë të vlerësimit e barabartë me 30 pikë. Komponenti “Menaxhimi i riskut” dhe “Aktivitete e Kontrollit” arrijnë në të njëjtin nivel vlerësim me 3.1 dhe 3.4 pikë secila, duke i korresponduar kështu të njëjtit nivel vlerësimi me 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Gjithashtu edhe Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi kanë marrë 30 pikë pasi janë vlerësuar me 4 pikë secila. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme.

Drejtorja e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Elbasan** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2015, audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB nuk ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 15 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor duhej dhënë arsytimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Ky arsyetim nuk është plotësuar. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar dhe realizuar 11 angazhime auditimi por duhet theksuar se ka ndryshuar llojin e auditimeve të realizuara pa raportuar ndryshimet e planit në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Kjo njësi nuk ka dërguar zyrtarisht kopje të raporteve finale të auditimit për monitorim në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi nuk i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit vjetor dhe formatit të miratuar të evidencave, si dhe kërkohet një analizë më e thelluar e situatës dhe vlerësim më i thelluar i sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe të trajnuar (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Kukës për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Kukës është vlerësuar me 355 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme dhe e renditur në vendin e pestë. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 36. Vlerësimi i indikatorëve për Bashkinë Kukës

Bashkia Kukës	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	30	1.2%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga Thesari	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3
10. Monitorimi	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	10	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
13. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	20	3
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	5	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikator i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë, kjo bashki gjatë vitit 2015 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 1.2% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel shumë të mirë të realizimit të këtij indikator. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësisve publike për Bashkinë Kukës, është 30 pikë duke qenë se mosrealizimi i këtij indikator i përket nivelit të parë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2015, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të shkëlqyer të realizimit të këtij indikator, pra vlerësohet me 30 pikë maksimale.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, të gjitha urdhër-shpenzimet të Bashkisë Kukës

janë paraqitur në Thesar në mënyrën e duhur. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë maksimale.

4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikator i **Dorëzimit në kohë të kontratave në thesar**. Gjatë vitit 2015, ky institucion karakterizohet nga një performancë e shkëlqyer pasi të gjitha kontratat e dorëzuara kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me 30 pikë maksimale.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikator i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë të shkëlqyer lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë maksimale.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Vlerësimi i performacës nga ana e kësaj drejtorie është bërë në bazë të pyetësorëve të vetëvlerësimit. Ky pyetësor përbëhet nga 39 pyetje, të shpërndara ndërmjet 5 komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Për çdo komponent janë llogaritur pikët mesatare të tij, të cilat përcaktohen duke konsideruar raportin e shumës së pikëve me të cilat institucioni ka vlerësuar çdo pyetje në përbërje të secilit komponent me numrin e pyetjeve respektive.

Për Bashkinë Kukës, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3 pikë, gjë që i referohet nivelit të dytë të vlerësimit e barabartë me 20 pikë. Edhe komponenti “Menaxhimi i riskut” arrin në një nivel vlerësim me 3.2 pikë duke i korresponduar kështu nivelit të dytë të vlerësimit me 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Aktivitetet e Kontrollit dhe Informimi dhe komunikimi janë vlerësuar me 20 pikë pasi secila ka marrë nga 3 dhe 3.3 pikë mesatarisht secila. Vetëm, Monitorimi ka marrë pikët maksimale duke u vlerësuar me 30 pikë pasi kanë një vlerësim mesatar me 3.5 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele jo të kënaqshme.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Kukës** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 10 pikë sepse për vitin 2015, tre nga audituesit e brendshëm janë të pa certifikuar por kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me (30 pikë).

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyeimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (20 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 5 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar 9 angazhime auditimi dhe ka realizuar 4 angazhime auditimi, si dhe ka ndryshuar llojin e auditimeve të realizuara pa raportuar ndryshimet e planit në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Kjo njësi nuk ka dërguar zyrtarisht kopje të raporteve finale të auditimit për monitorim në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi nuk i është përmbajtur formatit të evidencave, nuk është bërë identifikimi i risqeve dhe

kërkohej një analizë më e thelluar e situatës si dhe nuk është bërë vlerësimi i qartë sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 4 punonjës (1 drejtues dhe 3 specialistë), ku tre nga audituesit e brendshëm janë të pa certifikuar. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Vlorë për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Vlorë është vlerësuar me 350 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme, duke treguar për një performancë shumë të mirë të kësaj bashkie, e cila është e renditur në vendin e shtatë. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë paraqitur në vijim.

Tabela 37. Vlerësimi i indikatorëve për Bashkinë Vlorë

Bashkia Vlorë	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	30	0%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	5	51%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga Thesari	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	10.7%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	30	4
10. Monitorimi	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	20	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
13. Monitorimi i pyetesorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	10	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

- Indikator i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë kjo bashki gjatë vitit 2015 të gjitha faturat e dorëzuara në Thesar ka qënë brenda afatit 30 ditor të lejuar. Kjo tregon për një nivel të shkëlqyer të realizimit të këtij indikator. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike për Bashkinë Vlorë, është 30 pikë maksimale duke qënë se mosrealizimi i këtij indikator i përket nivelit të parë të vlerësimit.
- Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2015, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është

51%, çka flet për një nivel të dobët të realizimit të këtij indikator, pra vlerësohet me 5 pikë.

2. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, 0% e urdhër-shpenzimet të Bashkisë Vlo0072ë janë paraqitur në Thesar në mënyrën jo të duhur. Kjo tregon se të gjitha urdhër-shpenzimet janë paraqitur në thesar siç duhet. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë e shkëlqyer në këtë drejtim.
3. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikator i **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, ky institucion karakterizohet nga një performancë e jo shumë e mirë pasi të 10.7% e kontratat e dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me 15 pikë.
4. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikator i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Kjo përbindje do të thotë që institucioni ka një performancë të shkëlqyer lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë maksimale.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Bashkinë Elbasan, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.3 pikë, gjë që i referohet nivelit të dytë të vlerësimit e barabartë me 20 pikë. Edhe komponenti “Menaxhimi i riskut” dhe “Aktivitete e Kontrollit” arrijnë në të njëjtin nivel vlerësim me 3 dhe 3.1 pikë secila, duke i korresponduar kështu të njëjtit niveli vlerësimi me 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi kanë marrë 30 pikë pasi janë vlerësuar me 3.6 dhe 3.7 pikë secila. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele jo të kënaqshme.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Vlorë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 20 pikë sepse për vitin 2015, një nga audituesit e brendshëm nuk ka ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me (30 pikë).

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 10 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar 12 angazhime auditimi dhe ka realizuar 8 angazhime auditimi, por duhet theksuar se ka ndryshuar llojin e auditimeve të realizuara pa raportuar ndryshimet e planit në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Kjo njësi nuk ka dërguar zyrtarisht kopje të raporteve finale të auditimit për monitorim në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi

nuk i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, si dhe nuk është bërë vlerësim i thelluar i sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe të trajnuar. (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Gjirokastrë për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Gjirokastrë është vlerësuar me 350 pikë nga 450 duke u renditur në vendin e shtatë. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë si më poshtë.

Tabela 38. Vlerësimi i indikatorëve për Bashkinë Gjirokastrë

Bashkia Gjirokastrë	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	15	7.32%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	5	72%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga Thesari	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	1.3%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	30	4
7. Menaxhimi i Riskut	10	2
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	30	4
10. Monitorimi	30	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	30	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	20	3
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	10	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikator i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2015, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 7.32% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikator. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njërive publike për këtë bashki, është 15 pikë duke qenë se mosrealizimi i këtij indikator i përket nivelit të tretë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2015, për Bashkinë e Gjirokastrës, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 72%, çka flet për një nivel shumë të ulët të realizimit të këtij indikator, ndaj dhe vlerësohet me 5 pikë.

3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, pra të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në Thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në Thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 1.3%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e parë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë maksimale 30 pikë. Këto pikë tregojnë për një performancë shumë të kënaqshme të bashkisë Gjirokastër në këtë drejtim.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikatori i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Bashkinë Gjirokastër, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 3.5 pikë, ndaj dhe ka marrë 30 pikë. Menaxhimi i riskut është vlerësuar mesatarisht 2 pikë, duke marrë 10 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar mesatarisht me 3.1 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë. Informimi dhe komunikimi si dhe Monitorimi janë vlerësuar me 3.7 pikë dhe 4 pikë, duke grumbulluar respektivisht 30 pikë secili. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të kënaqshme, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, kryesisht, në kuadër të përmirësimit të komponentit të Menaxhimit të riskut dhe aktivitetet e kontrollit, të cilat janë vlerësuar më dobët në krahasim me komponentët e tjerë.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Gjirokastër** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2015, audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB nuk ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 30 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (20 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 10 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar 15 angazhime auditimi dhe ka realizuar 11 angazhime auditimi, si dhe ka ndryshuar llojin e

auditimeve të realizuara, pa raportuar ndryshimet e planit në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Kjo njësi nuk ka dërguar zyrtarisht kopje të raporteve finale të auditimit për monitorim në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi nuk i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, nuk është bërë identifikimi i risqeve dhe duhej bërë vlerësim më i thelluar sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel zyre, e përbërë me 1 punonjës (1 drejtues), ku audituesi i brendshëm është i certifikuar dhe i trajnuar. (30 pikë). Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me aktet nënligjore në fuqi.

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Berat për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Berat është vlerësuar me 335 pikë nga 450 duke u renditur në vendin e nëntë. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë si në tabelën në vijim.

Tabela 39. Vlerësimi i indikatorëve për Bashkinë Berat

Bashkia Berat	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	15	15.8%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga Thesari	30	0%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	15	8.3%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	20	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3
10. Monitorimi	20	3
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	15	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	30	4
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	10	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

- Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2015, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 15.8% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikator. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njërive publike për këtë bashki, është 15 pikë duke qenë se mosrealizimi i këtij indikator i përket nivelit të tretë.
- Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në

vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2015, për bashkinë në fjalë, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të kënaqshëm të realizimit të këtij indikator, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.

2. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në thesar është 0%, pra të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në Thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
3. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në Thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 8.3%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e tretë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë 15 pikë. Këto pikë tregojnë për një performancë jo shumë të kënaqshme të bashkisë Berat në këtë drejtim.
4. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikator i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qënë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Bashkinë Berat, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 2.6 pikë, ndaj dhe ka marrë 20 pikë. Menaxhimi i riskut është vlerësuar mesatarisht 2.8 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar mesatarisht me 3 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë. Informimi dhe komunikimi si dhe Monitorimi janë vlerësuar me 3.3 pikë dhe 2.75 pikë, duke grumbulluar respektivisht 20 pikë secili. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele të mesatare, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave kryesisht, në kuadër të përmirësimit të komponentit të Mjedisit të kontrollit, i cili ka marrë vlerësim më të ulët në krahasim me komponentët e tjerë.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Berat** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2015, të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB nuk ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 15 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor duhej dhënë arsytimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Ky arsyetim nuk është plotësuar. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (30 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 10 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar dhe realizuar 15 angazhime auditimi, por duhet theksuar se ka ndryshuar llojin e auditimeve të realizuara.

Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi nuk i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, nuk është bërë identifikimi i risqeve dhe kërkohet një analizë më e thelluar e situatës si dhe vlerësim i sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuar. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe të trajnuar. (30 pikë)

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Fier për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Fier është vlerësuar me 330 pikë nga 450 duke u renditur në vendin e dhjetë. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë si në tabelën më poshtë.

Tabela 40. Vlerësimi i indikatorëve për Bashkinë Fier

Bashkia Fier	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	25	3%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga Thesari	30	2%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	30	0%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	15	25%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	10	2
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	20	3
10. Monitorimi	20	3
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	15	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	20	3
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	15	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuar	30	

Më poshtë, po paraqesim një analizë më të detajuar për çdo indikator të monitorimit sipas drejtorive përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikatori i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë bashki, gjatë vitit 2015, ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 3% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel të mirë të realizimit të këtij indikatori. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njërive publike për këtë bashki, është 25 pikë duke qenë se mosrealizimi i këtij indikatori i përket nivelit të dytë.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e tyre në të ardhmen. Për vitin 2015, për Bashkinë e Fierit, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel shumë të mirë të realizimit të këtij indikatori, ndaj dhe vlerësohet me 30 pikë.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhër-shpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhër-shpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqëson një tregues më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, raporti ndërmjet urdhër shpenzimeve të refuzuara me urdhër shpenzimet totale të dërguara në Thesar është 2%, pra të gjitha urdhër shpenzimet janë paraqitur në thesar në mënyrën e duhur, me dokumentacionin mbështetës përkatës si dhe me kodet e duhura. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 30 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë shumë e mirë në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, ne kemi analizuar indikatorin e **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, raporti i kontratave të paraqitura me vonesë në Thesar me numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara është 0%. Kjo përqindje e kontratave që nuk kanë respektuar afatin maksimal 3 ditor, ndodhet në intervalin e parë të vlerësimit sipas metodologjisë së monitorimit të performancës, ndaj pikët e marra janë maksimale 30 pikë. Këto pikë tregojnë për një performancë shumë të kënaqshme të bashkisë Fier në këtë drejtim.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikator i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qenë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në Agjencinë e Prokurimit Publike (APP), me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 25%. Në këtë aspekt, bazuar në arritjet e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 15 pikë.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Bashkinë Fier, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 2.75 pikë, ndaj dhe ka marrë 20 pikë. Menaxhimi i riskut është vlerësuar mesatarisht 2.3 pikë, duke marrë 10 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Aktivitetet e kontrollit janë vlerësuar mesatarisht me 3 pikë, duke marrë 20 pikë sipas metodologjisë. Informimi dhe komunikimi si dhe Monitorimi janë vlerësuar me 3 pikë dhe 2.5 pikë, duke grumbulluar respektivisht 20 pikë secili. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele mesatare, duke theksuar gjithashtu dhe nevojën për marrjen e masave, kryesisht, në kuadër të përmirësimit të komponentit të Menaxhimit të riskut i cili është vlerësuar më dobët në krahasim me komponentët e tjerë.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Fier** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm. kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2015, audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB nuk ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 15 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsyetimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (20 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar dhe ka realizuar 7 angazhime auditimi, sipas fushave të planifikuara.

Kjo njësi nuk ka dërguar zyrtarisht kopje të raporteve finale të auditimit për monitorim në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, por duhej bërë vlerësimi më i thelluar i sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel drejtorie, e përbërë me 3 punonjës (1 drejtues dhe 2 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe të trajnuar. (30 pikë).

Monitorimi i Performancës për Bashkinë Bulqizë për vitin 2015

Në bazë të analizës së indikatorëve, Bashkia Bulqizë është vlerësuar me 290 pikë nga 450 pikë maksimale të mundshme dhe e renditur në vendin e njëmbëdhjetë. Konkretisht, indikatorët e vlerësuar për vitin 2015 sipas strukturave përkatëse që kanë raportuar këto të dhëna janë:

Tabela 41. Vlerësimi i indikatorëve për Bashkinë Bulqizë

Bashkia Bulqizë	Pikët	Vlerësimi/ nga Drejtoria përkatëse
1. Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e Thesarit	15	5.6%
2. Numri i kontratave të anuluar gjatë vitit buxhetor	30	0%
3. Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga Thesari	15	5.9%
4. Dorëzimi në kohë i kontratave në Thesar	5	63.6%
5. Urdhër prokurimet e paautorizuara	30	0%
6. Mjedisi i kontrollit	20	3
7. Menaxhimi i Riskut	10	3
8. Aktivitetet e kontrollit	20	3
9. Informimi dhe komunikimi	30	4
10. Monitorimi	20	4
11. Përgatitja e audituesve të brendshëm	30	
12. Raportimi në kohë i Audituesve	5	
13. Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të audituesve të brendshëm	20	3
14. Cilësia e raportimit të audituesve të brendshëm	10	
15. Pozicione aktuale të auditimit të brendshëm të paplotësuara	30	

Analiza e detajuar për çdo indikator të monitorimit paraqitet si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

1. Indikator i parë i analizuar është **Dërgimi i faturave për pagesë në Thesar**. Për këtë, kjo bashki gjatë vitit 2015 ka një mosrespektim të afatit maksimal prej 30 ditësh për dorëzimin e faturave në Thesar në masën 5.6% të totalit të faturave të regjistruara në Thesar. Kjo tregon për një nivel mesatar të realizimit të këtij indikator. Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit të performancës së njësisve publike për Bashkinë Bulqizë, është 15 pikë duke qenë se mosrealizimi i këtij indikator i përket nivelit të tretë të vlerësimit.
2. **Anulimi i kontratave gjatë vitit** është një tjetër indikator që derivon nga Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit. Shpesh herë njësitë publike anulojnë kontrata, pavarësisht se ato janë në vazhdim e sipër, ndaj dhe ky indikator identifikon këto lloj kontratash. Krahas numrit të këtyre kontratave, duhet të shpjegohen dhe arsyet e anulimit të tyre, për të marrë masa për shmangien e anulimeve të kontratave në të ardhmen. Për vitin 2015, raporti i kontratave të anuluar me totalin e kontratave të nënshkruara është 0%, çka flet për një nivel të shkëlqyer të realizimit të këtij indikator, pra vlerësohet me 30 pikë maksimale.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë së përditshme të tyre, institucionet paraqesin urdhërshpenzime pranë degëve të Thesarit. Këto urdhërshpenzime duhet të dorëzohen në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit për Zbatimin e Buxhetit, sepse në të kundërt ato refuzohen. **Urdhër Shpenzimet e refuzuara nga Thesari** përfaqësojnë një indikator më vete në këtë analizë. Gjatë vitit 2015, 5.9% e urdhërshpenzimet të Bashkisë Bulqizë janë paraqitur në Thesar në mënyrën jo të duhur. Ndaj, vlerësimi për këtë indikator është me 15 pikë, duke u karakterizuar nga një performancë mesatare në këtë drejtim.
4. Njësitë publike kanë detyrimin të paraqesin kontratat e reja në degët e Thesarit brenda 3 ditësh nga data e firmosjes së tyre. Për të vlerësuar institucionet në këtë aspekt, është analizuar indikator i **Dorëzimit në kohë të kontratave në Thesar**. Gjatë vitit 2015, ky institucion karakterizohet nga një performancë e dobët pasi të 63.6% e kontratat e dorëzuara nuk kanë respektuar afatin ligjor ndaj dhe është vlerësuar me 5 pikë.
5. **Urdhër prokurimet e paautorizuara** është indikator i fundit i gjeneruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, i cili është marrë në analizë, duke qenë se njësitë publike kanë detyrimin për të paraqitur urdhër-prokurimet në APP, me autorizimin e Thesarit. Për vitin 2015, raporti i urdhër-prokurimeve të dorëzuar në APP të paautorizuara me numrin e përgjithshëm të urdhër-prokurimeve është 0%. Kjo përqindje do të thotë që institucioni ka një performancë të shkëlqyer lidhur me këtë indikator. Vlerësimi sipas metodologjisë së monitorimit është 30 pikë maksimale.

Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Për Bashkinë Bulqizë, mjedisi i kontrollit është vlerësuar mesatarisht me 2.9 pikë, gjë që i referohet nivelit të dytë të vlerësimit e barabartë me 20 pikë. Komponenti “Menaxhimi i riskut” arrin në një nivel vlerësim me 1.5 pikë duke i korresponduar kështu nivelit të tretë të vlerësimit me 10 pikë sipas metodologjisë së monitorimit. Aktivitetet e Kontrollit dhe Monitorimi janë vlerësuar me 20 pikë pasi kanë një vlerësim mesatar me 2.7 pikë secila. Informimi dhe komunikimi ka marrë 30 pikë pasi është vlerësuar me 3.5 pikë. Pra, sipas këtij vetëvlerësimi, gjendja e sistemeve të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivele jo të kënaqshme.

Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

Bazuar në metodologjinë e sipërcituar, Njësia e Auditimit të Brendshëm pranë **Bashkisë Bulqizë** paraqet indikatorët e mëposhtëm:

Përgatitja e Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB është vlerësuar me 30 pikë sepse për vitin 2015, audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe kanë ndjekur trajnimet e vijueshme profesionale të organizuara nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Raportimi në kohë i Audituesve të Brendshëm, kjo NJAB nuk ka respektuar afatet e vendosura në akatet nënligjore në lidhje me raportimin vjetor dhe për këtë është vlerësuar me 5 pikë.

Monitorimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të Audituesve të Brendshëm, për çdo rezultat në këtë pyetësor është dhënë arsytimi i zgjedhjes së pikëve sipas përcaktimeve të metodologjisë. Pikëzimi i këtij aneksi bëhet nga njësia. (20 pikë)

Cilësia e Raportimit të audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 10 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2015 ka programuar 11 angazhime auditimi dhe ka realizuar 15 angazhime auditimi, por duhet theksuar se ka ndryshuar llojin e auditimeve të realizuara.

Kjo njësi nuk ka dërguar zyrtarisht kopje të raporteve finale të auditimit për monitorim në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Në lidhje me raportimin vjetor, kjo njësi nuk i është përmbajtur strukturës së kërkuar të raportit, nuk është bërë identifikimi i risqeve dhe kërkohet një analizë më e thelluar e situatës si dhe nuk është bërë vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Pozicione aktuale të Auditimit të Brendshëm të pa plotësuara. NJAB në këtë institucion është e krijuar në nivel sektori, e përbërë me 2 punonjës (1 drejtues dhe 1 specialistë), ku të gjithë audituesit e brendshëm janë të certifikuar dhe të trajnuar. (30 pikë). Kjo njësi e auditimit të brendshëm funksionon në kundërshtim me kriteret e akteve nënligjore në fuqi.

ANEKSI 3: KUADRI LIGJOR DHE NËNLIGJOR I KBFP

- Baza ligjore në fushën e MFK është ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, me ligjin 110/2015, datë 15.10.2015.
 - Urdhri i Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010 “Për Miratimin e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”;
 - Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike”, i ndryshuar;
 - Udhëzimi nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”;
 - Urdhri i Ministrit të Financave nr. 89, datë 28.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për monitorimin e performancës së njësive publike”;
 - Udhëzimi nr. 33, datë 28.12.2015, “Për mbylljen e llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2015”.
- Baza e veprimtarisë në fushën e auditimit të brendshëm është Ligji nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 195, datë 13.11.2015. Ai përcakton rregullat kryesore për realizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm në Shqipëri. Akte të tjera nënligjore, të cilat janë pjesë e paketës ligjore për rregullimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm janë si më poshtë:
 - Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.908, datë 17.12.2014 “Për miratimin e Strategjisë së Financave Publike për vitet 2014-2020”, që konsiderohet si dokumenti bazë për menaxhimin të financave për vitet 2014-2020”;
 - Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.212, datë 30.03.2012 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” botuar në Fletoren Zyrtare nr.44, datë 29.04.2012;
 - Urdhri i Ministrit të Financave nr.69, datë 29.09.2010 “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”;
 - Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.12, datë 05.06.2012 “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”;
 - Urdhri i Ministrit të financave nr.71, datë 26.12.2012 “Për miratimin e kuadrit rregullator të procesit të kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar.

Krahas kuadrit të mësipërm, baza ligjore e rregullatore për MFK dhe AB plotësohet me standardet COSO dhe paketën profesionale ndërkombëtare të AB dhe Praktikave Profesionale të publikuara nga IIA, si dhe materiale e rekomandime nga Komisioni Europian, për të dyja fushat.

ANEKSI 4: PYETËSORI I VETËVLERËSIMIT TË MFK DHE AB

Pyetësoni i vetëvlërësimit të MFK

	Njësia Publike		
	Kodi buxhetor i Njesisë në Sistemin e Thesarit		
	Emri, Mbiemri i Titullarit të Njesisë Publike dhe adresa e-mailit		
	Data e plotësimit (sipas protokollit)		
	Përshkrimi i pyetjeve të pyetësonit sipas komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (neni 19, i Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010), i ndryshuar.		
Nr.	Kriteri	Rezultati	Justifikimi/arsyetimi për zgjedhjen e 1, 2, 3, 4
		1-4	
MJEDISI I KONTROLLIT			
Vendosja e objektivit			
1	Ka një deklaratë të miratuar të misionit në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor.		
2	Ka një strategji të miratuar me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor.		
3	Objektivat e planit të mëparshëm operacional të institucionit janë arritur dhe janë matur.		
4	Menaxherët/drejtesit/punonjësit e njesisë publike janë informuar mbi përmbajtjen e Deklaratës së Misionit, objektivat, strategjitë dhe planin e veprimit. Jepni arsyetimin mbi mënyrën e shpërndarjes së dokumentacionit dhe kohën, për shembull në formë elektronike, me shkrim, nëpërmjet takimeve.		
Etika personale dhe profesionale			
5	Monitorohet pajtueshmëria e punonjësve me rregulloren/legjislacionin për etikën personale dhe profesionale.		
6	Raportohen shkeljet e ligjit të etikës dhe shkeljet e raportuara trajtohen në mënyrën e duhur.		
Struktura organizative duhet të jetë në përputhje me objektivat e njesisë			
7	Struktura organizative është në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e njesisë.		
8	Detyrat dhe përgjegjësitë e departamenteve drejtorive/vektorëve janë të përcaktuara qartësisht (në një rregullore të brendshme ose hartë procesesh) dhe nuk ka mbivendosje.		
Stili i punës së drejtuesve			
9	Çdo shkelje e rregulloreve, kodit të etikës, rregullave të procedurave trajtohet në mënyrën e duhur.		

10	Delegimi i detyrave dhe përgjegjësive dokumentohet sipas ligjit nr.10296/2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), të ndryshuar me ligjin nr.110/2015.		
11	Çdo manaxher kryen detyrat e tij/të saj në përputhje me rregullat e delegimit dhe përgjegjësive.		
12	Detyrat e drejtuesve janë të përcaktuara qartë në procedurën e brendshme? (procedura të brendshme të përcaktuara qartë garantojnë një mbikqyrje të stafit nga drejtuesit).		
13	Çështjet e MFK diskutohen rregullisht gjatë takimeve të Grupit të Menaxhimit Strategjik.		
Politikat dhe praktikat e burimeve njerëzore			
14	Ekziston përshkrimi i punës dhe ai rishikohet në mënyrë periodike nga drejtuesit në lidhje me detyrat që duhet të kryhen, kërkesat për kualifikimet e nevojshme dhe linjat e raportimit.		
15	Kryhen vlerësime periodike të punonjësve në institucion tuaj, lidhur me detyrat që ata kryejnë si pjesë e përgjegjësive të tyre. (Jepni arsyetimin në lidhje me shpeshhtësinë që kryhen këto vlerësime, kush është përgjegjës për këtë proces dhe si informohen punonjësit për rezultatet e vlerësimit).		
16	Politika dhe praktika e burimeve njerëzore garantojnë mirëmbajtjen dhe përmirësimin e aftësive profesionale të stafit ?		
	Totali i pikëve të seksionit "Mjedisi i Kontrollit"		
MENAXHIMI I RISKUT			
17	Në rast të delegimit të detyrave të koordinatorit të riskut, detyrat i delegohen një punonjësi në strukturën e financës.		
18	Ka një strategji risku të miratuar në përputhje me nenin 21, të ligjit nr. 10296/2010, të ndryshuar.		
19	Ka një regjistër risku të shkruar që përfshin risqet më të rëndësishme të lidhura me objektivat e njësisë.		
20	A diskuton GMS në takimet e tij çështje të lidhura me risqet që mund të pengojnë përmbushjen e objektivave të njësisë.		
21	Drejtuesit e të gjitha niveleve përfshihen në hartimin e regjistrit të riskut.		
22	Ka nevojë për trajnim të mëtejshëm të drejtuesve në fushën e menaxhimit të riskut.		
	Totali i pikëve të seksionit "Menaxhimi i Riskut"		
AKTIVITETET E KONTROLLIT			

23	Ka manual procesesh për proceset kryesore operacionale dhe financiare i cili specifikon qarkullimin e dokumentacionit.		
24	Ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person.		
25	Të gjitha angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ (sistemi i dy firmave).		
26	Shpenzimet iniciohen nga drejtuesi i programit buxhetor/departamentet/drejtoritë përkatëse.		
27	Aktivet e rëndësishme (me vlerë) dhe aktivet afatgjata (përfshirë të dhënat personale) ruhen nga përdorimi i paautorizuar me anë të një procedurë të shkruar.		
28	Ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit të IT. (p.sh. Ndryshohen fjalëkalimet rregullisht, fireëall-et, hyrje e kufizuar në të dhënat IT, etj.)		
29	Institucioni ka një sistem rezervë (back-up) IT të përshtatshëm, plan rekuperimi nga fatkeqësitë të testuar në praktikë.		
	Totali i pikëve të seksionit "Aktivitetet e Kontrollit"		
INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI			
30	Çdo drejtues/strukturë varësie është në dijeni të buxhetit të caktuar për aktivitetin/grupin e aktiviteteve për të cilat ai/ajo është përgjegjës.		
31	Ka një sistem informacioni që u siguron drejtuesve informacion rregullisht mbi arritjen e objektivave të njësisë.		
32	Ka një rregullore të brendshme të shkruar në lidhje me komunikimin brenda njësisë publike (të shkruar, elektronik dhe verbal).		
33	Titullari i institucionit dhe drejtuesit informohen për shpenzimet buxhetore krahasuar me totalin e planifikuar në buxhet për çdo program që ai/ajo ka përgjegjësi dhe ka një strukturë për dhënien e këtij informacioni.		
34	Punonjësit dinë si dhe ku t'i raportojnë parregullsitë/problemet.		
35	Ka një komunikim të rregullt me institucionet e tjera jashtë institucionit.		
	Totali i pikëve të seksionit "Informimi dhe komunikimi"		
MONITORIMI			
35	Titullari i institucionit merr raporte periodike mbi aktivitetet e çdo departamenti/drejtorie.		

37	Aktiviteti i njësisë së auditimit të brendshëm përmbush pritshmëritë e drejtuesve të njësisë publike.		
38	Progresi drejt arritjes së objektivave monitorohet rregullisht dhe analizohen shkaqet që mund të çojnë në dështim.		
39	Opinionet e drejtuesve (të dokumentuara) merren në konsideratë gjatë përgatitjes së planeve të punës.		
	Totali i pikëve të seksionit "Monitorimi"		
	MESATARJA E PËRGJITHSHME E PIKËVE		

- 1 - njësia nuk i plotëson kriteret
- 2 - njësia i plotëson kriteret pjesërisht
- 3 - njësia i plotëson kriteret por ka ende nevojë për përmirësime
- 4 - njësia i plotëson kriteret

Pyetësi i vetëvlerësimit të AB

Njësia Publike:						
Emri, Mbiemri i Drejtuesit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB) dhe adresa e e-mail:						
Data e plotësimit (sipas protokollit):						
Përshkrimi i pyetjeve të pyetësit sipas ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi për auditimin e brendshëm.						
Jo	Kriteri	Rezultati				Arsyetime i zgjedhjes 1, 2, 3, 4
		1	2	3	4	
Kërkesat kyçe për AB						
1	NjAB është ngritur në përputhje me kërkesat e ligjit për auditimin e brendshëm dhe aktet nënligjore.					
2	NjAB kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e e ligjit për auditimin e brendshëm dhe Manualin e Auditit të Brendshëm (MAB).					
3	Karta e Auditit të Brendshëm është hartuar dhe miratuar dhe plotëson kërkesat e MAB.					
4	Aktet specifike për fusha të veçanta të auditimit të brendshëm janë zhvilluar dhe miratuar sipas ligjit.					
5	NjAB është e pavarur nga ana funksionale dhe raporton drejtpërdrejt tek Titullari i Njësisë Publike.					
6	Fusha e mbulimit të Auditimit të Brendshëm përfshin të gjitha aktivitetet e Njësisë Publike.					
	Totali i pikëve të seksionit "Kërkesat kyçe për auditimin e brendshëm"					
Struktura organizative e NjAB, punonjësit, kualifikimet dhe aftësitë profesionale të audituesve të brendshëm						
7	Struktura e NjAB respekton kërkesat e minimumit ligjor (minimumi 1 Drejtues dhe 2 specialistë të auditimit të brendshëm).					
8	Audituesit e Brendshëm plotësojnë kriteret e punësimit					
9	NjAB përmbush kërkesat vjetore për trajnimin e vijueshëm profesional.					

10	Veprimtaria e audituesve të NjAB është në përputhje me Kodin e etikës së Audituesve të Brendshëm, të miratuar nga Ministri i Financave.					
	Totali i pikëve të seksionit "Struktura organizative e NjAB, punonjësit, kualifikimet dhe aftësitë profesionale të audituesve të brendshëm"					
Planifikimi dhe raportimi i veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm						
11	Planifikimi Strategjik dhe Vjetor i NjAB përmbush kërkesat dhe miratohet nga Drejtuesi i Njesisë Publike.					
12	Procesi i hartimit dhe miratimit të planit Strategjik dhe Vjetor kryhet brenda afateve të përcaktuara.					
13	Objektivat e Planit Strategjik dhe Vjetor të NjAB janë të përcaktuara qartësisht dhe në përputhje me objektivat e Njesisë Publike.					
14	Procesi i identifikimit dhe vlerësimit të riskut mbulon të gjithë fushat e auditimit.					
15	Risqet që lidhen me objektivat e NjAB janë identifikuar dhe vlerësuar drejt.					
16	Plani Strategjik dhe Vjetor pasqyron rezultatin e procesit të identifikimit dhe vlerësimit të riskut.					
17	Burimet e nevojshme përlogariten dhe shpërndahen në mbështetje të objektivave.					
18	Ndryshimet e bëra gjatë zbatimit të planit janë pjesë e dosjes së planit dhe argumentohen me shkrim.					
	Totali i pikëve të seksionit "Planifikimi dhe raportimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm"					
Përmbushja e standardeve gjatë kryerjes së veprimtarisë audituese						
19	Angazhimet e auditimit përmbushen sipas aktiviteteve të parashikuara në Planin Vjetor.					
20	Programi i çdo angazhimi respekton formën dhe përmbajtjen sipas kërkesave të MAB.					
21	Programi miratohet nga Drejtuesi i NjAB.					
22	Çdo angazhim auditimi kryhet sipas kërkesave të MAB.					
23	Formati standard për vlerësimin e kontrollit të brendshëm, nivelit të riskut dhe komponentëve të tjerë plotësohen dhe përmbajnë informacion cilësor.					
24	Përcaktimi i numrit dhe llojit të testeve dhe rezultatet e tyre janë të dokumentuara qartë dhe të përfshira në dosje.					
25	Procedurat për përgatitjen dhe dërgimin e raportit tëauditimit zhvillohen në përputhje me kërkesat e MAB (fazat e raportimit).					
24	Vërejtjet e subjektit të audituar janë pjesë e dosjes dhe raportit final.					
26	Në çdo rast Plani i Veprimit i hartuar nga pala e audituar, diskutohet dhe miratohet nga Titullari i njesisë publike dhe i dërgohet për informacion NjAB-së					
27	Çdo rekomandim i pasqyruar në raport është i lidhur me gjetjet.					
28	Zbatimi i rekomandimeve monitorohet.					
	Totali i pikëve të seksionit "Përmbushja e					

	standarteve gjatë kryerjes së veprimtarisë audituese”					
Rishikim i brendshëm i cilësisë së veprimtarisë audituese						
29	Rishikimi i brendshëm i cilësisë përfshin të gjitha fazat e auditimit (planifikimin, punën në subjekt dhe raportimin) dhe dokumentohet.					
30	Rishikimi i brendshëm i cilësisë kryhet nga Drejtuesi i NjAB-së ose nga një person i autorizuar prej tij/saj.					
31	Komentet/vlerësimet e procesit të rishikimit të brendshëm të cilësisë janë pjesë e dosjes së auditimit.					
	Totali i pikëve të seksionit “Rishikimi i brendshëm i cilësisë së veprimtarisë audituese”					
Dokumentimi i punës audituese						
32	Dosjet e përhershme/të përkohshme plotësojnë kërkesat e MAB dhe arkivohen sipas legjislacionit në fuqi.					
	Totali i pikëve të seksionit “Dokumentimi i punës audituese”					
MESATARJA E PËRGJITHSHME E PIKËVE						

- 1 - NjAB nuk e përmbush kriterin
- 2 - NjAB përmbush kriterin pjesërisht
- 3 - NjAB e përmbush kriterin por ka vend për përmirësime
- 4 - NjAB përmbush kriterin